



UBT NEWS

Gazetë e studentëve të UBT-së | Dhjetor 2015

POLITICS • ECONOMY • BUSINESS • TECHNOLOGY • EDUCATION • SCIENCE • CULTURE

**EDITORIAL: UBT –
SINONIM I CILËSISË NË
REPUBLIKËN E KOSOVËS**



Faqe 2

**REKTORI I UBT-SË
PËRFAQËSOI KOSOVËN
NË ASAMBLENË E
PËRGJITHSHME TË
ORGANIZATËS EVROPIANE
PËR CILËSI NË VARSHAVË**

Faqe 3

**UBT PËRFITUES I
SHUMË PROJEKTEVE
NDËRKOMBËTARE, MUNDËSI
TË MËDHA PËR STUDENTËT**

Faqe 3

**MIQTË AUSTRIAKË TË
UBT-SË NISIN FUSHATËN
“YES TO KOSOVO”**

Faqe 4

**AMBASADORI I MBRETËRISË
SË BASHKUAR, RUAIRI
O’CONNELL QËNDROI NË UBT**

Faqe 6

**UBT NËNSHKROI
MARRËVESHJE
BASHKËPUNIMI ME
SHUMË UNIVERSITETE
NDËRKOMBËTARE**

Faqe 7

**UBT FILLOI VITIN E
RI AKADEMIK ME
PRITJEN SOLEMNE TË
STUDENTËVE TË RINJ**

Faqe 9

**DR. FATMIR SEJDIU NË
KONFERENCËN E UBT-SË,
FLET PËR TRASHËGIMINË
KULTURORE DHE
HISTORIKE TË KOSOVËS**

Faqe 10

**UBT DHE SHOQATA
AUSTRIAKE-KOSOVARE
ORGANIZUAN NJË
VARG KONFERENCASH
TË PËRBASHKËTA**

Faqe 20



**MBI 300 PJESËMARRRËS DHE
220 PREZANTIME NË KONFERENCËN
NDËRKOMBËTARE TË UBT-SË PËR
BIZNES, TEKNOLOGJI DHE INOVACION**

Faqe 12



**ULRIKE LUNAÇEK
VIZITOI UBT-NË**

Faqe 8

Editorial

Edmond Hajrizi

UBT – sinonim i cilësisë në Republikën e Kosovës

UBT po e përmbyll vitin kalendarik me një varg të arriturash në të gjitha fushat. Me më shumë studentë, më shumë profesorë, më shumë programe studimi, më shumë hapësirë për ligjërata e ushtrime, më shumë laboratorë. Më shumë marrëveshje ndërkombëtare të bashkëpunimit, shumë më shumë konferenca shkencore ndërkombëtare, më shumë institute e qendra hulumtimi, më shumë studentë të diplomuar dhe të punësuar...

Që nga nisma e punës së tij UBT zgjodhi rrugën, për të zhvilluar programe akademike dhe të gjitha aktivitetet e tjera që kanë cilësinë si një emërues të përbashkët. Dhe në respektim të këtij parimi askush në UBT, as menaxhmenti, as mësimdhënësit, as studentët nuk bënë asnjëherë kompromis.

E ky parim nuk mbeti i pavërejtur nga bashkëpunëtorët ndërkombëtarë, institucione prestigjioze akademike evropiane e botërore, që zgjodhën gjithnjë UBT-në si partner bashkëpunimi për projektet e tyre akademike në Kosovë e në rajon. Kjo u vërejt dhe u përkrah fuqishëm edhe nga organizata të Bashkimit Evropian, që e bënë UBT-në pjesë të shumë programeve të tyre të përkrahjes së institucioneve akademike. U vërejt nga profesorë e profesionistë eminentë botërorë që zgjodhën UBT-në për të bartur dijen dhe përvojën e tyre në vendin tonë. U vlerësua shumë nga të rinjtë nga Kosova e vendet në rajon, të cilët përgatitjen e tyre në nivelin akademik ia besuan pikërisht UBT-së, duke bërë që numri i studentëve, në të gjitha drejtimit, të rritet nga viti në vit.

U vlerësua fuqishëm edhe nga Organizata Evropiane për Ekselencë, e cila e vlerësoi UBT me Çmimin e Ekselencës, një dëshmi e përkushtimit të vazhdueshëm, por edhe një obligim shumë i madh për të gjithë Ne – për ta ruajtur këtë nivel, për ta dëshmuar në vazhdimësi se e merituar dhe do ta mbajmë për një kohë të gjatë.

Këtë muaj unë mora pjesë në takimin e Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës Evropiane për Cilësi, e cila i zhvilloi punimet në Varshavë të Polonisë. Përfaqësorja UBT-në, por në radhë të parë përfaqësorja Republikën e Kosovës, shtetin në emër të të cilit po hyjmë fuqishëm në radhën e institucioneve më të rëndësishme evropiane. Aty ku nuk hyhet po nuk pate emër, përvojë, rezultate kulminante, mbi të gjitha, cilësi në të gjitha fushat.

Në këtë takim, dhe në shumë takime të tjera të nivelit të lartë, dëshmuam se vendi ynë ka potenciale për të qenë pjesë e institucioneve dhe të gjitha nismave të kohës, të nxitura nga zhvillimi i gjithëmbarshtëm, në radhë të parë nga ndryshimet e ndikuara nga zhvillimi i teknologjisë, fushë në të cilën UBT është prijatë jo vetëm në vend, por edhe në rajon. Prandaj, na takon ne si institucion që, pos të dëshmojmë nivelet tona të zhvillimit, të sjellim në vendin tonë të gjitha përvojat pozitive, evropiane e amerikane. Këtë e kemi bërë që nga dita e parë e

punës së UBT-së, po e bëjmë fuqishëm sot dhe do ta bëjmë gjithsesi edhe në të ardhmen.

E, për të sjellë këtë përvojë, UBT, pos aktiviteve të vazhdueshme akademike, kujdes shumë të madh i ka kushtuar nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione akademike, të cilat mundësojnë sjelljen e programeve të reja në vend. Vetëm këtë vit kemi nënshkruar dhjetëra marrëveshje të tilla, synimi parësor i të cilave është përfitimet që marrin prej tyre studentët e UBT-së. Ata janë caku ynë dhe me këto marrëveshje e të tjera që do të nënshkruajmë në të ardhmen, ne synojmë që ky student të jetë i barabartë me të gjithë kolegët e tij që studiojnë kudo në botë. Këtë tashmë e kemi arritur dhe kjo nuk është pak.

Përveç kësaj, sidomos gjatë këtij viti kalendarik, UBT ka qenë shumë aktive në organizimin e konferencave ndërkombëtare, me tema shumë interesante dhe jetike për një varg fushash të funksionimit të shtetit tonë.

Bashkë me Shoqatën Austriake-Kosovare, UBT organizoi një varg konferencash që trajtuan tema shumë të rëndësishme. Sollëm në Prishtinë emra të rëndësishëm të politikës evropiane, përfaqësues të institucioneve shtetërore nga shumë vende të Evropës dhe nga vendet e rajonit, shkencëtarë e profesionistë nga më të zgjedhurit, ministra e drejtues institucioneve të Republikës së Kosovës. Dëgjua përvojat e tyre të vëra, i diskutuam ato dhe dhamë rekomandime të rëndësishme për modelin e zgjidhjes së shumë problemeve të pranishme aktualisht në vendin tonë.

Dhamë po kështu kontributin tonë në shumë nisma me interes shtetëror. Miqtë e UBT-së u bënë lobues të palodhshëm në shumë procese, që nga fushata për anëtarësim në UNESCO e në shumë institucione të tjera.

Së fundi, u ndjemë shumë krenarë kur pamë të shpërndahen gjithandej Evropës mesazhe të figura më të rëndësishme politike të Austrisë, miq të institucionit tonë, të cilët ndërmorën një fushatë për sensibilizimin e opinionit dhe institucioneve vendimmarrësve evropiane që qytetarëve të Kosovës t'u mundësohet lëvizja e lirë pa viza në Evropë. Kur sheh emrin e UlrikeLunaçek, ErhardBusek e të tjerë, në një poster me logon e UBT-së dhe me porosinë "Yes to Kosovo", sigurisht që ndihesh krenar.

Ndaj, themi me arsye se UBT po përmbyll një vit shumë të suksesshëm dhe po nis një vit në cilin, qysh tash e dimë, se do të bëjmë edhe shumë më shumë punë të mira për studentin dhe për shtetin.

Gëzuar 2016!



14 YEARS

LEADERSHIP and INNOVATION

Education • Research • Training • Consulting
2001/2015

IMPRESUM

UBT News – gazetë e studentëve

Botues: Edmond Hajrizi

Bashkëpunëtorë: Albina Zeneli, Besart Troshupa, Drin Jakurti, Fatbardha Kiqina, Edona Jerliu, Marigona Kqiku, Sherife Sokoli, Ulpiana Emra

Adresa: www.ubt-uni.net / Tel: 038 541 400, 044 541 400

Përgatitje grafike: ELV Studio

Shtypi: "Roto Print"

AKTIVITETE NDËRKOMBËTARE

REKTORI I UBT-SË PËRFAQËSOI KOSOVËN NË ASAMBLENË E PËRGJITHSHME TË ORGANIZATËS EVROPIANE PËR CILËSI NË VARSHAVË



4 dhjetor 2015. - Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi mori pjesë në takimin e Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës Evropiane për Cilësi, e cila i zhvilloi punimet në Varshavë të Polonisë, duke e përfaqësuar Republikën e Kosovës, në njërën ndër organizatat më të rëndësishme evropiane. Gjatë fjalimit të mbajtur në samit, rektori Hajrizi theksoi se Republika e Kosovës ka nevojë

për krijimin e një infrastrukture moderne të cilësisë, të bazuar në praktikat më të mira evropiane dhe amerikane.

Kjo krijon mundësinë e zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe ndërlidhjen me kompanitë e mëdha ndërkombëtare, e rrit aftësinë konkurruese si dhe ndihmon në procesin e integritit të Kosovës në Bashkimin Evropian.

Në këtë drejtim, tha ai, përmes aktiviteteve të UBT-së, por edhe të asociacionit “Quality Kosova”, të krijuar po për këtë qëllim, po u jepet ndihmesë institucioneve dhe bizneseve e asociacioneve të ndryshme në fushën e cilësisë.

Ai tha se anëtarësimi i Kosovës në mekanizmat si Organizata Evropiane për Cilësi është shumë i rëndësishëm për t’u

ndërlidhur me këtopraktika dhe me institucionet më relevante në vendet e Bashkimit Evropian, por edhe më gjerë. Rektori i UBT-së tha se duke e përfaqësuar Kosovën në Organizatën Evropiane për Cilësi, institucioni që ai drejton po hap rrugët e bashkëpunimit me organizatat e rëndësishme evropiane dhe po i siguron Kosovës përvojë dhe ekspertizë, në fushën e cilësisë, një lëmi me rëndësi të veçantë në ditët e sotme, për të gjithë qytetarët dhe të gjitha institucionet e shtetit.

Drejtues të Organizatës Evropiane për Cilësi theksuan rëndësinë e përfaqësimit të Kosovës në këtë institucion dhe shprehën interesimin e tyre për ta ndihmuar Republikën e Kosovës, në

nismat e ndryshme për sigurimin e cilësisë në të gjitha fushat e jetës.

Kosova është pjesë e Organizatës Evropiane për Cilësi, përmes “Quality Kosova”, e drejtuar nga dr. Edmond Hajrizi, që nga dhjetori i viti 2013, kur është pranuar, në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm të kësaj organizate, mbajtur në Stamboll të Turqisë. “Quality Kosova” është asociacion që merret me çështjen e kualitetit, standardeve, certifikimeve dhe konfirmimit.

Ai promovon cilësinë në Kosovë, në bazë të standardeve evropiane dhe ndërkombëtare, merret me certifikimin e sistemeve e produkteve sipas standardeve ndërkombëtare, si ISO 9001 e të tjerë.

UBT PËRFITONE DHE NGA NJË PROJEKT I KOMISIONIT EVROPIAN

28 gusht. - Në vazhden e përfitimit të projekteve ndërkombëtare, të cilat sigurojnë mundësi bursash, mobiliteti dhe shkëmbim e transfer të dijes për studentët dhe stafin, UBT është shpallur fitues edhe në një projekt të Komisionit Evropian “Erasmus+ Programme - Capacitybuilding in higher education”.

Qëllimi i këtij projekti është zhvillimi i një kurikule të përbashkët dhe ofrimi i studimeve Master (MA) në fushën e Shkencave Politike.

Projekti që financohet nga Komisioni Evropian koordinohet nga partneri strategjik i UBT-së në Austri, Paris-Lodron Universitat Salzburg. Me të njëjtin institucion, UBT ka qenë partner edhe në disa projekte të tjera të Komisionit Evropian, duke përfshirë edhe ERASMUS-MUNDUS SIGMA Agile.

UBT pret ditëve në vijim të konfirmojë edhe përfitimet nga projekte të tjera të Komisionit Evropian me universiteti dhe institucione të respektuara Evropiane.

UBT PËRFITUES I PROJEKTIT TË KOMISIONIT EVROPIAN, ERASMUS+ PROGRAMME MOBILITY GRANTS

23 shtator. - Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi po qëndron për një vizitë pune në Universitetin Corvinus në Budapest të Hungarisë.

Gjatë një takimi me drejtues të këtij universiteti u konfirmua se UBT, në bashkëpunim me Universitetin Corvinus, është përfitues i një projekti të ri të Komisionit Evropian, i emërtuar Erasmus+ Programme Mobility Grants.

Ky projekt ofron mundësi të shkëlqyera për studentët dhe

stafin akademik të UBT-së, duke krijuar kanale institucionale dhe të qëndrueshme të bashkëpunimit. Më konkretisht, ky projekt ofron mundësinë e shkëmbimit të studentëve dhe stafit në mes të UBT dhe Universitetit Corvinus dhe garanton transferin e ECTS-ve, që nënkupton që programet tona janë të barasvlershme dhe të pranuar nga universitete evropiane.

Përveç kësaj marrëveshjeje, tashmë të mbështetur nga Komisioni Evropian, UBT javë më parë

ka përfituar edhe nga një projekt i ngjashëm i koordinuar nga Salzburg University, me të cilën do të mundësohet krijimi i një programi të ri dhe të përbashkët në fushën e Shkencave Politike.

UBT dhe Universiteti Corvinus kanë të nënshkruar një Memorandum bashkëpunimi në shumë fusha, i cili ofron shkëmbim e studentëve dhe të mësimdhënësve, ofrimin e studimeve të doktoratës, bashkëpunimin në fushën e hulumtimeve e një varg fushash të tjera të bashkëpunimit.

UBT PËRFITUES I SHUMË PROJEKTEVE NDËRKOMBËTARE, MUNDËSI TË MËDHA PËR STUDENTËT

12 tetor 2015. - Vetëm gjatë muajit shtator dhe tetor UBT ka përfituar edhe nga një varg projekte të rëndësishme në kuadër të programeve ndërkombëtare të përkrahjes, nga të cilat përfitojnë në të gjitha fushat studentët dhe stafi i UBT-së, të cilëve u mundësohet praktikë profesionale (internship), vazhdim i studimeve, shkëmbim i stafit dhe përparësi të tjera.

Kështu, në vazhden e përfitimit të projekteve ndërkombëtare, të cilat sigurojnë mundësi bursash, mobiliteti dhe shkëmbim e transfer të dijes për studentët dhe stafin, UBT është shpallur fitues edhe në një projekt të Komisionit Evropian “Erasmus+ Programme - Capacitybuilding in higher education”.

Projekti që financohet nga Komisioni Evropian koordinohet nga partneri strategjik i UBT-së në Austri, Paris-Lodron Universitat Salzburg. Me të njëjtin institucion, UBT ka qenë partner edhe në disa projekte të tjera të

Komisionit Evropian, duke përfshirë edhe ERASMUS-MUNDUS SIGMA Agile.

UBT gjithashtu u bë përfitues i projektit të Komisionit Evropian, Erasmus+ Programme Mobility Grants. Ky projekt ofron mundësi të shkëlqyera për studentët dhe stafin akademik të UBT-së, duke krijuar kanale institucionale dhe të qëndrueshme të bashkëpunimit. Më konkretisht, ky projekt ofron mundësinë e shkëmbimit të studentëve dhe stafit në mes të UBT dhe Universitetit Corvinus në Hungari dhe garanton transferin e ECTS-ve, që nënkupton që programet tona janë të barasvlershme dhe të pranuar nga universitete evropiane.

Gjithashtu, UBT është akredituar si Partner Akademik i vetëm në rajon i ofruesit më të madh të certifikimeve në fushën e Teknologjisë së Informacionit CompTIA. Nga ky certifikim studentët e UBT-së dhe të tjerët do të kenë mundësinë të përfitojnë certifikime dhe trajnime të njohura

ndërkombëtarisht në fushën e TI-së. CompTIA si ofrues kryesor i provimeve dhe certifikimeve në fushën e TI-së, ofron trajnimet dhe certifikimet në Përkrahje Teknike për PC, Rrjete Kompjuterike, Serverë, Linux, Siguri të Sistemeve etj.

Gjatë kësaj periudhe, UBT, në bashkëpunim me Shoqatën Austriake-Kosovare dhe institucione të Republikës së Kosovës, ka organizuar një varg konferencash, me tema mjaft të rëndësishme, në të cilat kanë marrë pjesë ministra dhe zyrtarë të tjerë të lartë të institucioneve shtetërore, përfaqësues kompanish e organizatash joqeveritare, ekspertë e të interesuar të tjerë. Konferenca kanë trajtuar tema nga Industria, Shëndetësia, të Drejtat Pronësore, Turizmi e tema të tjera.

Gjatë kësaj periudhe, UBT ka zhvilluar një varg aktivitete të tjera, në nivel vendor e ndërkombëtar.

Kështu, UBT është institucioni i vetëm i autorizuar për trajnimin

dhe certifikimin e administratorëve të ndërtesave në bashkëpronësi, në një projekt të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, mbështetur në zbatimin e ligjit 04/L0134.

UBT gjithashtu nënshkroi memorandum mirëkuptimi me Ministrinë e Integritit Evropian, që përfshin një varg fushash bashkëpunimi me shumë interes.

Drejtues të UBT-së ishin të pranishëm në konferencën prezantuese të ofertës së universiteteve gjermane në kuadër të Projektit Erasmus +, organizuar nga DAAD (German Academic Exchange Service), në fokus të së cilës ishte prezantimi i projekteve të universiteteve gjermane dhe mundësia e lidhjes-rrjetëzimit me universitetet e Ballkanit Perëndimor. Po kështu, drejtues të UBT-së morën pjesë në konferencën “TECIS 2015, 16th IFAC Conference on Technology, Culture and International Stability”, që i zhvilloi punimet në Sozopol të Bullgarisë. Në kuadër të bashkëpunimeve

ndërkombëtare, Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi vizitoi edhe Universitetin Semmelweis, që është universiteti më i madh i shkencave të mjekësisë në Hungari.


Po në Budapest të Hungarisë, Rektori Hajrizi dhe drejtues të Universitetit Corvinus nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi në fushën e inxhinierisë së ushqimit dhe sigurisë së ushqimit, gjatë nënshkrimit të së cilës ishte i pranishëm edhe ministri i Bujqësisë dhe i Zhvillimit Rural në Qeverinë e Republikës së Kosovës, Memli Krasniqi.

Drejtues të UBT-së vizituan edhe Panairin Ndërkombëtar të produkteve ushqimore dhe të agrikulturës në Budapest, qëllim i të cilit ishte promovimi dhe zhvillimi e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Gjatë një takimi me përfaqësuesin e kompanisë “Persecutor”, Richard Pimper, u diskutuan një varg temash me interes, mes të tjerash edhe krijimi i Qendrës së përpunimit të të dhënave në UBT.



PERSONALITETE TË SHQUARA AUSTRIAKE FILLOJNË FUSHATËN "YES TO KOSOVO"

E kanë mbështetur Kosovën në forma të ndryshme në të shkuarën. Por, tani kur vendi ynë gjendet para vendimit të madh për të marrë rekomandime pozitive për liberalizimin e vizave, disa personalitete të shquara austriake kanë lansuar fushatën "Yes to Kosovo".




Në këtë fushatë ata bëjnë thirrje që kosovarët më në fund të gëzojnë liberalizimin e vizave, që Kosova të anëtarësohet në Këshillin e Evropës, në Organizatën Ndërkombëtare të Shëndetësisë dhe të pranohet nga Qipro. Shumica e tyre kanë mbështetur Kosovën edhe në të shkuarën në procese të ndryshme të shtetndërtimit. Një pjesë e tyre janë edhe euro-deputetë.



Edhe nënkryetaria e Parlamentit Evropian, Ulrike Lunacek, në panon e saj ka vendosur sloganin "Yes to Kosovo" dhe ka shkruar "Është koha për liberalizimin e vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës", transmeton Republika.info. Të njëjtën përmbajtje e kanë vendosur edhe Erhard Busek, Dr. Matias



Stolz, NEOS Austria. Ndërsa, thirrje që Kosova të anëtarësohet në Organizatën Ndërkombëtare të Shëndetësisë kanë bërë Dr. Marianne Graf, kryetare e shoqatës Shqipëri-Austri.



Disa personalitete tjera kanë bërë thirrje që Kosova të pranohet edhe nga Greqia, disa të tjerë nga Organizata Ndërkombëtare e Tregtisë. Kjo fushatë është lansuar nga Sho-



qata Austriake-Kosovare dhe është mbështetur nga disa institucione të tjera. /Republika.info/

NË KOLEGJIN UBT, MË 10 E 11 DHJETOR, QËNDROI MARK MARKU

KOMUNIKIMI - THELBI I PROFESIONIT TË GAZETARISË

Për studentët e vitit të parë të Fakultetit Medie e Komunikim në Kolegjin UBT u organizua një ligjëratë tematike, të cilën e mbajti Prof. Asoc. Dr. Mark Marku nga Departamenti i Gazetarisë në Fakultetin Histori & Filologji të Universitetit të Tiranës.

Mark Marku, pedagog në Departamentin e gazetarisë në Uni-

versitetin e Tiranës, për dy ditë radhazi në UBT mbajti një cikël leksionesh nga lënda "zhanret e gazetarisë". Në ditën e parë foli për llojet dhe kanalet e komunikimit, duke përkufizuar komunikimin, si njërin ndër tiparin kryesor, që e dallon njeriun nga gjallesat tjera. "Çdo bisedë përbën një akt komunikimi dhe se nuk do të mund të shndërroheshim në komunikues të mirë masiv, po që se nuk do të komu-

nikonim si duhet në përditshmëri" tha profesor Marku, për të vazhduar më tutje, se, thelbi i profesionit të gazetarisë është pikërisht komunikimi, nëpërmjet të cilit bëhet bartja e informacioneve e mesazheve.

Duke u ndalur pak edhe te përdorimi i internetit, ai tha: "interneti është bërë një përmbledhës i mediave, madje edhe media në vete, ngase aty edhe një qytetar i thjeshtë mund ta shohë një informacion dhe ta shpërndajë me publikun e gjerë". Në këtë rast, sipas Markut, automatikisht krijohet 'Gazetaria Qytetare' ku çdo person mund të bëhet bartës i informatës (lajmit). "Mjafton të ketë një telefon dhe ta udhëheq situatën"- theksoi ai, e për të vazhduar: "në ditët e sotme, secili është aktor komunikimi, e shkollat

e gazetarisë po zhduken, prandaj qëllimi i universiteteve është që të krijojnë profesionistë në punën e tyre", tha Marku, duke u bazuar në zhvillimin teknologjik, që po ndodh tani.

Në ditën e dytë të ligjëratës tematike, profesor Marku u thellua akoma më tepër në profesionin e gazetarisë, duke i sqaruar në mënyrë të detajuar të gjitha zhanret gazetareske, e duke i zëbërthyer ngjashmëritë e dallimet thelbësore në mes tyre. Një pjesë e madhe e ligjëratës iu kushtua lajmit, si forma më e rëndësishme e llojit të gazetarisë informative, apo lloji, që përdoret më së shumti. Lajmin, Marku e përkufizoi si një informacion të ri dhe të jashtëzakonshëm, duke radhitur disa nga kriteret, që ai informacion duhet t'i plotësojë

për t'u quajtur lajm. Ndër veçoritë tjera, që i ka lajmi, tha ai "janë edhe rëndësia që ka, personat që janë të përfshirë aty, ndikimi që ka në publik, por edhe pasojat që mund t'i sjell ai lajm"- theksoi ai.

Marku nuk harroi të fliste edhe për intervistën si pjesë e zhanrit informativ, e cila, sipas tij, bazohet në pyetje të shkurtra e përgjigje të gjata, që kanë kuptim, e që mund të marrin feedback e të kuptojmë shumë gjëra.

Ajo çka i bëri të veçantë këto leksione nga ligjëratat e tij tematike, ishte mënyra se si çdo njohuri të tij, profesori e ilustronte me shembuj nga përditshmëria e jetës.

FATBARDHË KIQINA



REKTORI EDMOND HAJRIZI MORI PJESË NË FORUMIN E 25-TË EKONOMIK NË POLONI

17 shtator. - Rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi mori pjesë në punimet e Forumit të 25-të Ekonomik, i cili i zhvilloi punimet në Poloni, me ftesë të drejtuesve të këtij forumi.

Forumi Ekonomik është një nga ngjarjet më të rëndësishme ekonomike në Evropën Qendrore, që për 25 vjet ka qenë një vend diskutimi i krerëve më të lartë shtetërorë të Evropës dhe më gjerë.

Forumi i 25-të, që i zhvilloi punimet në qytetin Krynica, mbledhi liderë botërorë, presidentë e kryeministra shtetesh, ministra e drejtues kompanish e institucionesh të tjera prestigjioze nga e gjithë bota.

Në paraqitjen e tij para pjesëmarrësve të Forumit, rektori Hajrizi foli në temën "Kontributi i inovacionit në zhvillimin afatgjatë dhe të qëndrueshëm", në të cilën, përveç të tjerash, paraqiti përvojat dhe kontributin që jep UBT në Kosovë dhe në rajon, si



një institucion prijatar në fushën e hulumtimit dhe inovacionit.

Në forum mori pjesë edhe Ardian Emini, drejtor për çështje akademike në UBT.

Tema e forumit të sivjetmë ishte "Drejt një Evrope të qëndrueshme. Strategjitë për të ardhmen", gjatë trajtimit të së cilës pjesëmarrësit paraqitën qëndrimet dhe idetë

lidhur me çështjet ekonomike, politike e sociale, përmes diskutimit, raporteve dhe debatit.

Në margjina të forumit, Rektori Hajrizi zhvilloi një varg takimesh

me drejtues institucionesh evropiane, me të cilët diskutoi për tema me interes të dyanshëm.



Rektori Hajrizi mori pjesë në konferencën "Dilemat 2015" në Suedi

17 shtator. - Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi ka zhvilluar një vizitë në disa vende të Evropës, si në Suedi, në Gjermani e në Austri, ku ka takuar drejtues institucionesh akademike, me të cilët ka diskutuar për bashkëpunimin në fusha të ndryshme, me interes për studentët dhe stafin e UBT-së.

Ai ka marrë pjesë në konferencën "Dilemat 2015", organizuar në Universitetin Linnaeus në Suedi, ku paraqitur një prezantim, së bashku me prof. dr. Kozeta Sevrani nga Universiteti i Tiranës.

Në këtë konferencë, ku UBT u përfaqësua me dy punime shkencore, morën pjesë edhe ligjëruesit e UBT-se, PhD Ardian Emini dhe can. PhD Krenare Pireva.

Rektori Hajrizi, gjithashtu, ka zhvilluar një takim me drejtuesit e këtij universiteti, me të cilin UBT ka një bashkëpunim të frytshëm tashmë disave vjetra.

Gjatë takimit u diskutua për bashkëpunimin e deritashëm dhe për zgjerimin e këtij bashkëpunimi në shumë fusha, përfshirë mobilitetin e stafit dhe të studentëve, projektet e përbashkëta hulumtuese, ngritjen e kapaciteteve, organizimin e shkollave verore e fusha të tjera.

Rektori Hajrizi në konferencën e "Erasmus +" në Grac të Austrisë

20 tetor 2015. - Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi po qëndron në Grac të Austrisë, ku, si i ftuar nga organizatorët, po merr pjesë në një konferencë organizuar nga autoritetet austriake dhe Programi Erasmus +, temë e

së cilës është bashkëpunimi ndërkombëtar dhe diplomat e përbashkëta.

Gjatë punimeve të ditës së parë të konferencës dyditore, rektori Hajrizi, në cilësinë e ekspertit të reformave të arsimit të lartë në Kosovë, prezantoi zhvillimin dhe të arriturat në arsimin e lartë në Kosovë dhe mundësitë që ofron Kosova në bashkëpunimin ndërkombëtar.

Gjatë punimeve të konferencës, rektori Hajrizi ka takuar një numër të madh drejtuesish të universiteteve të ndryshme evropiane, të cilët kanë shprehur interes për bashkëpunim me Kosovën me theks të veçantë për bashkëpunim me UBT-së.

Rektori Hajrizi në takimin e Projektit Erasmus Mundus Green TECH në Lubjanë

23 nëntor. - Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi po qëndron për vizitë në Slloveni, gjatë së cilës ai ka qëndruar edhe në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Lubjanës.

Ai mori pjesë në takimin e Projektit Erasmus Mundus Green TECH, për të prezantuar përvojën e UBT-së në fushën e mobilitetit dhe arsimit të lartë në Kosovë.

Gjithashtu, rektori Hajrizi zhvilloi takime me përfaqësues të shumë universiteteve evropiane, si nga Gjermania, Spanja, Portugalia, Bullgaria, Sllovenia, si dhe nga vendet e regjionit, me të cilët diskutoi për projekte bashkëpunimi në mobilitet dhe projekte të përbashkëta, nga të cilat do të përfitojnë stafi

dhe studentët, duke përfituar bursa dhe mundësi vazhdimi të studimeve jashtë vendit.

Rektori Hajrizi vizitoi Universitetin Semmelweis në Hungari



26 shtator – Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, gjatë vizitës në Hungari, vizitoi edhe Universitetin Semmelweis, që është universiteti më i madh i shkencave të mjekësisë në këtë shtet. Gjatë një takimi me dekanin e Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë, dr.Zoltan Zsot Nagy, z.Hajrizi diskutoi për mundësitë e bashkëpunimit në fushën e shëndetësisë, me theks të veçantë në fushën e infirmierisë.

Rektori Hajrizi në shënimin e 20-vjetorit të programit master në menaxhimin inxhinierik në Universitetin e Vjenës

22 tetor 2015. - Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi mori pjesë në ceremoninë e shënimit të 20-vjetorit të programit master në menaxhimin inxhinierik në Universitetin e Vjenës për Teknologji, program që është ofruar

në bashkëpunim me Universitetin Oakland nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

I njëjti program nga Vjena, duke filluar nga 2002, është ofruar edhe në UBT në Prishtinë me emrin International Engineering Management.

Një numër i madh i studentëve që kanë studiuar në këtë program sot janë liderë në udhëheqjen e kompanive më të suksesshme në Kosovë dhe më gjerë.

Drejtues të UBT-së vizituan Panairin Ndërkombëtar të produkteve ushqimore dhe të agrikulturës në Budapest

23 shtator – Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi dhe drejtori për çështje akademike në UBT, dr.Ardian Emini, vizituan sot Panairin Ndërkombëtar të produkteve ushqimore dhe të agrikulturës, që po mbahet në Budapest të Hungarisë.

Në panair po merr pjesë edhe ministri i Bujqësisë dhe i Zhvillimit Rural në Qeverinë e Republikës së Kosovës, Memli Krasniqi. Gjithashtu, janë të pranishëm edhe shumë ministra dhe zyrtarë të tjerë të lartë të vendeve të rajonit.

Qëllimi i panairit është promovimi dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Në këtë vazhdë, përfaqësuesit e UBT-së zhvilluan një varg takimet me përfaqësues të kompanive të ndryshme, të pranishme në panair.

AMBASADORI I MBRETËRISË SË BASHKUAR, RUAIRI O'CONNELL QËNDROI NË UBT



11 nëntor 2015. - Ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë, Ruairi O'Connell qëndroi për një vizitë në UBT, ku nga rektori prof. dr. Edmond Hajrizi u njoftua për punën e këtij institucioni.

Gjithashtu, ambasadori O'Connell përcolli prezantimin skenarit mbi gjendjen dhe zhvillimet në fushën energjetike në Kosovë deri në vitin 2050, të prezantuar nga ATRC. Me këtë rast, ai tha se Kosova,

sikur edhe e gjithë bota, duhet të ketë kujdes për një zhvillim të qëndrueshëm në fushën e energjisë, duke shtuar se me energji të qëndrueshme krijohet stabilitet në secilin vend.

DREJTUES TË UBT-SË MORËN PJESË NË KONFERENCËN E IFAC NË BULLGARI



27 shtator – Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi mori pjesë në konferencën “TECIS 2015, 16th IFAC Conference on Technology, Culture and International Stability”, që i zhvilloi punimet në Sozopol të Bullgarisë.

Në konferencë po marrin pjesë edhe dekani i Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë në UBT, dr. Muzafer Shala dhe ligjëruesi Valmir Hoxha.

UBT u prezantua në këtë konferencë me tri punime shkencore, të cilat u pritën me mjaft interes nga të pranishmit.

Gjithashtu, ata zhvilluan një varg takimesh me interes me përfaqësues të universiteteve të ndryshme nga rajoni dhe bota, pjesëmarrës në konferencë.

Konferenca e radhës e IFAC, vitin e ardhshëm, do të organizohet në UBT në Prishtinë.

Rektori Hajrizi mori pjesë në punimet e Forumit Evropian të Alpbachut

7 shtator. - Rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi ka marrë pjesë në punimet e Forumit Evropian të Alpbachut në Austri.

Në kuadër të aktiviteteve të shumta që zhvillohen në kuadër të Forumit Evropian të Alpbachut. Rektori Hajrizi ka zhvilluar një varg takimesh të rëndësishme me përfaqësues të universiteteve të rëndësishme botërore dhe përfaqësues të tjerë nga e gjithë bota, të mbledhur në këtë forum tradicional, ndër më të rëndësishmit nga forumet me karakter ndërkombëtar.

Pjesëmarrës në aktivitetet që zhvillohen në kuadër të Forumit të Alpbachut ishin edhe disa studentë të UBT-së, dy prej të cilëve me bursë të ofruar nga “Alpbach Kosova”.

Forumi Alpbach organizohet në Austri çdo vit dhe në të shtrohen për diskutim çështje të rëndësishme nga të gjitha fushat, ndërsa pjesëmarrës në të janë udhëheqës shtetesh, udhëheqës institucionesh të rëndësishme ndërkombëtare, përfaqësues universitetesh prestigjioze e mysafirë të tjerë, ndër ta një numër i madh studentësh nga e gjithë bota.

UBT nënshkroi memorandum mirëkuptimi me Ministrinë e Integrimit Evropian



17 shtator. - Në vazhden e bashkëpunimit dhe ofrimit të përkrahjes institucioneve të Republikës së Kosovës, UBT ka nënshkruar një memorandum mirëkuptimi me Ministrinë e Integrimit Evropian.

Marrëveshja përfshin një varg fushash bashkëpunimi, si bashkëpunimi për organizimin e konferencës akademike me temën “Shoqëria e hapur

kërkon kufij të hapur”, që i dedikohet integritetit evropian të Kosovës; bashkëpunimi lidhur me promovimin e progresit në Kosovë në procesin e integritetit evropian në institute dhe ngjarje akademike në vende të ndryshme të Evropës; bashkëpunimi për të mbështetur procesin e përkthimit të legjislacionit të Bashkimit Evropian nga gjuha angleze në gjuhën shqipe në bashkëpunim me Divizionin për Përkthim dhe Terminologji të Acquis të Ministrisë së Integrimit Evropian; si dhe bashkëpunimi për të shkëmbyer përvojat profesionale lidhur me përdorimin e sistemeve softuerike për përkthim të legjislacionit të Bashkimit Evropian.

Përveç kësaj, UBT dhe MIE u pajtuan që një numër i studentëve nga fusha të ndryshme të kenë mundësinë e realizimit të praktikës profesionale (internshipit). Rrjedhimisht, ky memorandum mirëkuptimi mundëson që UBT dhe institucionet qeveritare të bashkërendojnë hapat në arritjen e qëllimeve të përbashkëta në të mirë të komunitetit.

UBT vazhdon bashkëpunimin me Ministrinë e FSK-së për zhvillimin e kuadrove të kësaj force

28 korrik. - Rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi priti në një takim pune Sekretarin e përgjithshëm në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Shkëlzen Sylaj me bashkëpunëtorë.

UBT dhe Ministria e FSK-së kanë një bashkëpunim shumëvjeçar, rrjedha e të cilit është diskutuar në takimin e rektorit Hajrizi me sekretarin Sylaj.

Sekretari Sylaj konfirmoi vazhdimin e bashkëpunimit për ngritjen e kuadrove në nivel akademik edhe për vitin 2015/2016.

Ndërsa Rektori konfirmoi ofrimin e bursave për këto kuadro edhe për këtë vit, siç ka qenë edhe në të kaluarën.

Ata gjithashtu diskutuan për një varg projektesh në të cilat ky bashkëpunim do të zhvillohet në të ardhmen.

HORIZON 2020 – MUNDËSI E MADHE PËR FUSHËN E HULUMTIMIT DHE TË INOVACIONIT

24 korrik. - Rektori i UBT-së, prof. Dr. Edmond Hajrizi ka prezantuar sot mundësitë që për kompanitë e teknologjisë informative dhe institucionet e tjera në Kosovë ofron Programi Kornizë i Bashkimit Evropian për Kërkime dhe Inovacion “Horizon 2020” Ky program përkrah sektorin e teknologjive të reja dhe

të së ardhmes dhe Teknologjinë e Informimit dhe Komunikimit (TIK). Me vendim të ministrit të Arsimit të Republikës së Kosovës, rektori Hajrizi është i emëruar si Pikë Kombëtare e Kontaktit (PKK) për Programin “Horizon 2020” në Kosovë.

Rektori Hajrizi theksoi se në fushën e hulumtimit dhe të

inovacionit, Programi “Horizon 2020”, për periudhën 2014-2020 ka vënë në dispozicion 80 miliardë euro.

Ai gjithashtu theksoi se tri prioritet në këtë fushë janë: Excellent science, Industrial leadership dhe Societal Challenger.



BASHKËPUNIMI ME UNIVERSITETET PARTNERE

UBT dhe Universiteti Corvinus nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi në fushën e inxhinierisë së ushqimit dhe sigurisë së ushqimit

25 shtator – Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi dhe drejtues të Universitetit Corvinus në Budapest, nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi në fushën e inxhinierisë së ushqimit dhe sigurisë së ushqimit.

Prezent me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes ishte edhe ministri i Bujqësisë dhe i Zhvillimit Rural në Qeverinë e Republikës së Kosovës, Memli Krasniqi.

Marrëveshja përfshin realizimin e një varg projektesh të përbashkëta në fushën e inxhinierisë së ushqimit dhe sidomos të sigurisë së ushqimit, një fushë në të cilën UBT mund të ndihmojë në masë të madhe në vendin tonë.

UBT nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me universitetin e njohur nga Hungaria, Pazmany Peter University

22 tetor 2015. - Në vazhden e marrëveshjeve ndërkombëtare, UBT ka nënshkruar sot edhe një marrëveshje ndërkombëtare të bashkëpunimit, këtë herë me universitetin e njohur nga Hungaria, Pazmany Peter University.

Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi dhe presidenti i Pazmany Peter University, dr. Szurómi Szabolcs, nënshkruan sot marrëveshjen e bashkëpunimit, e cila përfshin, ndër të tjera, shkëmbimin e stafit dhe të studentëve, bashkëpunim në projekte ndërkombëtare, publikime të përbashkëta, punëtori në tema të ndryshme e fusha të tjera me interes për të dy palët.

UBT dhe Universiteti Corvinus i Budapestit me projekte konkrete në vitin 2015/2016

Prof. Dr. Zoltan Lakner nga Universiteti Corvinus i Hungarisë qëndroi për një vizitë në UBT, ku u prit nga rektori, prof. dr. Edmond Hajrizi.

Qëllimi i vizitës ishte krijimi i një plani pune për projektet që do të zhvillohen së bashku në vitin akademik 2015/2016.

Dr. Lakner, gjatë qëndrimit në UBT, mbajti edhe një ligjëratë.

UBT dhe Universiteti Corvinus kanë nënshkruar një Memorandum bashkëpunimi, i cili krijon mundësi për shkëmbimin e studentëve dhe të mësimit, ofrimin e studimeve të doktoratës, bashkëpunimin në fushën e hulumtimeve e një varg fushash të tjera të bashkëpunimit.



UBT zgjeron bashkëpunimin me universitetet në Hungari

2 nëntor – UBT po vazhdon të shtojë numrin e universiteteve partnere dhe të zgjerojë bashkëpunimin me një varg universitetesh evropiane, në fusha të ndryshme të bashkëpunimit, me interes të ndërsjellë.

Kështu, gjatë këtyre ditëve, rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, ka vizituar Universitetin Semmelweis, që është universiteti më i madh i shkencave të mjekësisë në Hungari.

Me këtë rast, me dekanin e Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë, dr. Zoltan Zsot Nagy, z. Hajrizi nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi midis dy institucioneve, e cila siguron mundësinë e shkëmbimit të stafit dhe të studentëve, njohjen e ndërsjellë të diplomave, realizimin e projekteve të përbashkëta dhe një varg mundësish të tjera.

Theks i veçantë iu kushtua bashkëpunimit në fushën e infermierisë.

Gjatë qëndrimit në Budapest, gjithashtu, rektori Hajrizi vizitoi universitetin e njohur nga Hungaria, Pazmany Peter University dhe u njoh me punën e këtij institucioni dhe mundësitë që ofron ai për studentët dhe stafin e UBT-së.

Siç dihet, UBT dhe Universiteti Pazmany Peter University tashmë kanë një marrëveshje bashkëpunimi, e cila është nënshkruar javën e kaluar nga rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi dhe presidenti i Pazmany Peter University, dr. Szurómi Szabolcs.

Po kështu, rektori Hajrizi vizitoi edhe Universitetin Corvinus në Budapest, një universitet partner i UBT-së, me të cilin ka marrëveshje bashkëpunimi në fushën e inxhi-

nierisë së ushqimit dhe sigurisë së ushqimit.

UBT dhe universitetet hungareze kanë realizuar dhe do të vazhdojnë të realizojnë një varg projektesh të bashkëpunimit, përfshirë edhe angazhimin e përbashkët në disa projekte nga Komisioni Evropian, në kuadër të projekteve “Erasmus +”.

Diskutohet krijimi i Qendrës së përpunimit të të dhënave në UBT

23 shtator – Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, i cili



qëndroi për vizitë në Budapest, ka zhvilluar një varg aktiviteteve dhe takimesh, me qëllim të vendosjes dhe zgjerimit të bashkëpunimit me institucione dhe kompani të ndryshme.

Në takime po merr pjesë edhe Ardian Emini, drejtor për çështje akademike në UBT.

Kështu, rektori Hajrizi është takuar me përfaqësuesin e kompanisë “Persecutor”, Richard Pimper, me të cilin diskutuan mundësitë e bashkëpunimit të dy institucioneve, në fusha të interesit të përbashkët.

Kompania “Persecutor”, me seli në Budapest, është një kompani me shumë peshë në fushën e teknologjisë së informacionit. Fushat në të cilat do të shtrihet bashkëpunimi i UBT-së me këtë kompani janë energjia, përpunimi i të dhënave, siguria e të dhënave e

të tjera, në të cilat do të zhvillohen projekte të përbashkëta.

Theks i veçantë në takim iu kushtua krijimit të Qendrës së përpunimit të të dhënave në UBT.

UBT vazhdon bashkëpunimin me Universitetin Teknik të Freibergut në Gjermani



28 korrik. - Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, në kuadër të akademisë verore për shkencat e materialeve në Tiranë, ka takuar Profesorin Thomas Bier, udhëheqës i Departamentit në Universitetin e Freibergut, me bashkëpunëtorë, me të cilin harmonizuan veprimet për bashkëpunimin ndërmjet dy institucioneve në vazhdim.

UBT me projekte të përbashkëta me Universitetin Sllovak për Teknologji

STU

SLOVAK UNIVERSITY OF TECHNOLOGY IN BRATISLAVA

3 dhjetor 2015. - Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, gjatë vizitës së tij në Sllovakë, ka zhvilluar

një varg takimesh me përfaqësues institucioneve akademike, me qëllim vendosjen e bashkëpunimit.

Kështu, ai është takuar me drejtuesit e Universitetit Sllovak për Teknologji, me seli në Bratislavë, me të cilët ka diskutuar për realizimin e projekteve të përbashkëta hulumtuese, në mobilitet dhe në zhvillim. Këto projekte dhe ky bashkëpunim, i mbështetur në kuadër të Programit CEEPUS, pjesë e të cilit janë të dy institucionet akademike, do të shtrihen gjerësisht në një varg angazhimesh të përbashkëta, nga të cilat do të përfitojnë studentët dhe stafi i UBT-së.

Përfaqësuesi i FMN-së, z. Ruud Vermeulen mbajti ligjëratë tematike në UBT

20 nëntor 2015. - Përfaqësuesi i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) në Republikën e Kosovës, z. Ruud Vermeulen mbajti një ligjëratë tematike para studentëve të UBT-së, në kuadër të ligjëratave tematike që zhvillohen në këtë institucion të arsimit të lartë.

Z. Vermeulen shpalosi para studentëve aspekte të punës së FMN-së, institucionit prestigjioz ndërkombëtar, anëtar i të cilit është Republika e Kosovës.

Me theks të veçantë, ai foli për rolin dhe kontributin që jep FMN në ndihmë institucioneve të vendit tonë në fushën e ekonomisë, duke qenë në të shumtën e rasteve një rregullator pozitiv për politikat dhe projektet kosovare në fushën e ekonomisë dhe të financave.

Pas ligjëratës u zhvillua një debat i frytshëm, në të cilin morën pjesë studentët dhe profesorët të UBT-së.

ZËVENDËSPRESIDENTJA E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE RAPORTUESJA PËR KOSOVËN E KËTIJ INSTITUCIONI QËNDROI NË UBT

ULRIKE LUNAÇEK VIZITOI UBT-NË, THA SE NË QEVERINË E KOSOVËS DUHET TË KETË MË SHUMË GRA

Zonja Lunaçek e vuri theksin te nevoja që gratë të kenë pavarësi ekonomike, në mënyrë që, bashkë me burrat të përparojnë bashkë në shoqëri. Ajo tha se kemi nevojë për kuota në universitet, në ekonomi, në qeveri, që nuk i kanë shumë vende. Edhe gruaja ka arsimim, edhe ajo është e aftë të mbajë një punë dhe ta kryejë atë me sukses. Diskriminimi tani më nuk pranohet, mund të thuhet se edhe dënohet

10 nëntor. - Në Qeverinë e Kosovës duhet të ketë më shumë gra dhe burrat duhet të mësohen me praninë e tyre në qeveri dhe në pozicione udhëheqëse. Kështu u shpreh sot zëvendëspresidentja e Parlamentit Evropian dhe raportuesja për Kosovën e këtij institucioni, zonja Ulrike Lunaçek, gjatë një fjalimi në konferencën "Aspektet gjinore dhe Ekonomia", organizuar në UBT.

Në fillim të konferencës, e cila mbledhi përfaqësues nga Zyra e Presidentes së Kosovës, Qeveria e Kosovës dhe institucione të tjera vendore e ndërkombëtare, rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi përshëndeti pjesëmarrjen e zonjës Lunaçek në konferencë dhe vizitën e saj në UBT, për t'u njohur me zhvillimin e këtij institucioni të arsimit të lartë.

Duke folur për temën e shtruar për trajtim në konferencë, rektori Hajrizi theksoi se në aspektin gjinor shohim shumë potencial për të gjeneruar kompetencë e inovacion dhe shtoi se barazia gjinore në ekonomi do të ndihmojë në përmirësimin e çështjeve gjinore në përgjithësi.

Ai tha se ka shumë potencial, sidomos në arsim, duke përmendur se në UBT rreth 50 për qind e stafit akademik janë femra. Ai shtoi se UBT do të bëjë gjithnjë e më shumë për të përkrahur ndërmarrësinë e grave.

UBT, tha Hajrizi, është një nga shkollat më të mëdha në vend dhe në rajon dhe fokusi ynë në të ardhmen do të jetë gratë në epokën e digjitalizimit.

Ne një fjalim më të gjatë, konferencës iu drejtuar zëvendëspresidentja e Parlamentit Evropian dhe raportuesja për Kosovën e këtij institucioni, zonja Ulrike Lunaçek. E çmoi shumë faktin që kjo konferencë po zhvillohet këtu. Ajo është e fokusuar në rolin e burrave dhe grave në ekonomi, si dhe perspektivën e shoqërisë, për shkak se ekonomia është një nga bazat se si funksionojnë shoqëritë dhe nëse nuk kemi gratë dhe burrat që i ndajnë detyrat bashkërisht në jetën private dhe në jetën publike, madje edhe në jetën ekonomike, atëherë shoqëritë janë të pabalancuara, tha Lunaçek.

Ajo tha se është shumë e rëndësishme që çështjet gjinore të jenë



si fokus edhe në ekonomi. Sa gra i shohim në pozita udhëheqëse në ekonomi dhe në industri. Ende është ai rregulli i pashkruar që burrat udhëheqin biznesin dhe kjo gjë duhet të ndalet një ditë dhe të sigurohemi se gratë kanë pjesëmarrje të barabartë në jetën publike.

Nuk ka as burrë as grua në këtë botë që lind me gjithçka të parashkruar për jetën e tij. Sigurisht që mësojmë vetë, mësojmë nga të tjerët, na ndihmon nëse prindërit tanë kanë gjendje të mirë financiare, nuk ka luftëra, ka qeverisje të mirë. Gjithçka ndihmon në përmirësimin e jetës së grave dhe të burrave. Mirë, në thelb, varet çka ne dëshirojmë të bëjmë dhe ajo është arsimimi, shtoi ajo.

Shkollimi është një nga fundamentet e shoqërisë. Pa shkollim nuk mund të shkon askund. Ar-

simi ka rol kyç në jetën e njeriut e sidomos te gratë. Është më rëndësi që gratë të shkollohen mirë, sepse shumë vende të botës kanë ligje të mira, madje edhe Kosova ka ligje të mira për pjesëmarrjen e grave, madje edhe për të drejtat pronësore, për trashëgiminë. Këto ligje ekzistojnë, mirëpo çka nëse gratë nuk i dinë të drejtat e tyre, nuk janë të arsimuara, nuk kanë njohuri për të drejtat e tyre, tha ajo, për të shtuar se duhet të shkollohemi që t'i dimë të drejtat tona, të dimë si t'i fitojmë ato të drejta, të dimë nëse diskriminohemi apo diçka tjetër.

Kur jemi te ekonomia, Lunaçek tha se duhet të mësojmë pse shoqëritë funksionojnë në këtë mënyrë që ende funksionojnë. Kjo ka të bëjë me ndarjen e roleve shoqërore në gjini. Vajzat nuk thonë shpesh: Unë

e dëshiroj këtë! Ka shumë vajza që e thonë këtë, por ato shumë shpesh shohin çfarë thonë të tjerët, çfarë duhet të bëjnë për dikë tjetër, duke e vendosur veten në nivel të dytë. Kemi nevojë për më shumë balancim, që djemtë të mos e vendosin gjithmonë veten në qendër. Tradicionalisht, jo vetëm në Kosovë, është burri që punon dhe gruaja në shtëpi që kujdeset për familjet. Por, fatmirësisht gjërat kanë filluar të ndryshojnë.

Zonja Lunaçek e vuri theksin te nevoja që gratë të kenë pavarësi ekonomike, në mënyrë që, bashkë me burrat të përparojnë bashkë në shoqëri. Ajo tha se kemi nevojë për kuota në universitet, në ekonomi, në qeveri, që nuk i kanë shumë vende. Edhe gruaja ka arsimim, edhe ajo është e aftë të mbajë një punë dhe ta kryejë atë me sukses. Diskriminimi tani më nuk pranohet, mund të thuhet se edhe dënohet.

Duhet patjetër me ligj të jenë të barabartë të gjithë dhe që gratë një jetë më të mirë. Pse jo edhe gratë të jenë ministre? Kemi nevojë për më shumë gra në qeverinë e Kosovës. Edhe burrat duhet të mësojnë që të kenë afër tyre edhe gratë, tha Lunaçek.

Në fund, porosia e saj për gratë ishte që ato të pasurohen, të mësojnë, të përfitojnë.

Si gra dhe si femra arrini qëllimet e juaja ngase askush nuk ka të drejtë t'ju mohojë këtë, përfundoi Lunaçek.

KONFERENCA "ASPEKTET GJINORE DHE EKONOMIA"

U THEMELUA QENDRA E UBT-SË PËR EKONOMI DHE BARAZI GJINORE

10 nëntor. - Konferencën "Aspektet gjinore dhe Ekonomia", e organizuar nga UBT dhe Shoqata Austriake-Kosovare, ka trajtuar sot një varg çështjesh me interes dhe ka mbledhur figura të rëndësishme, duke filluar nga zëvendëspresidentja e Parlamentit Evropian dhe raportuesja për Kosovën e këtij institucioni, zonja Ulrike Lunaçek, zëvendësmministria në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik të Kosovës, Besa Zogaj, këshilltarja e Presidentes së Republikës së Kosovës, Jeta Krasniqi e folës të tjerë.

Me këtë rast, gjithashtu u lansua themelimi i Qendrës së UBT-së për Ekonomi dhe Barazi Gjinore.

Kryetari i Shoqatës Austriake-Kosovare, drejtues i konferencës, Gunther Fehlinger theksoi se Qendra e UBT-së për Ekonomi dhe Barazi Gjinore do të japë kontributin e saj profesional në trajtimin e një varg çështjesh që ngrihen në shoqërinë tonë lidhur me barazinë gjinore në shumë sfera, me theks të veçantë në ekonomi. Pas fjalimit shterues të zonjës Lunaçek, që u

prit me shumë interes nga të pranishmit, konferenca i vazhdoi punimet me prezantimet dhe debatet për aspektet gjinore në ekonomi.

Besa Zogaj, zëvendësmministre në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik së Kosovës, tha ndër të tjera se pavarësisht faktit se Qeveria e Kosovës ka ndërmarrë iniciativë të ndryshme për përfshirjen e grave në tregun e punës, ende ka sektorë ku pjesëmarrja e grave është e ulët, si në fushën e energjetikës, minierave dhe teknologjisë.

"Dyzet e gjashtë për qind e popullsisë është e aftë për punë, mirëpo nuk janë në marrëdhënie pune. Këtu përfshihet edhe një numër i madh i gjinisë femërore. Përveç kësaj, në disa sektorë nuk ka asnjë grua të punësuar, e në disa pjesëmarrja e tyre është shumë e ulët si në miniera, teknologji informative e energjetikë", tha Zogaj. Këshilltarja e Presidentes së Republikës së Kosovës, Jeta Krasniqi, tha se fuqizimi ekonomik është pjesë kyçe për zhvillimin dhe vetëdijësimin e grave në tregun konkurrent të punës.

"Investimi në fuqizimin ekonomik, përcjellë me përkrahje të plotë nga faktorë të tjerë, është element që ndikon për zhvillimin e punësimin ose avancimin e gruas në tregun aktual të punës", tha Krasniqi.

Ndërkohë Merita Limani, specialiste e të drejtës së pronës, ka folur për programin e hartuar nga USAID-i mbi të drejtat e pronës. Ajo tha se ky program ka të bëjë pikërisht me fuqizimin e të drejtave të grave në këtë drejtim.

Limani shtoi se Kosova ka ligje që rregullojnë këtë problem, mirëpo legjislacioni sipas saj është i dobët, sepse këto ligje nuk po respektohen.

"Afër 70 për qind e pronave nuk kanë titullar personat përgjegjës, që paraqet indikacion, sepse nëse mund të ndodhë ndonjë divorc, gruaja nuk mund të trashëgojë asgjë nga burri i saj. Ka ligje që e rregullojnë këtë sistem në Kosovë, por legjislacioni është treguar i dobët ngaqë të tilla si ligje nuk po respektohen", tha ndër të tjera Limani.

Erëza Vela-Berisha, menaxhere e projektit WEE, ish-studente e UBT-së, theksoi se në shoqërinë kosovare femrat hasin në disa barrierë si trashëgimia familjare, ku në të shumtën e rasteve pasuria i takon gjinisë mashkullore, pastaj zgjedhja e profesionit, ku zakonisht femrave u imponohet të zgjedhin profesione të lehta, si edukatore, mjeke, etj.

Gjatë gjithë kohës gratë përbalen edhe me barrierë nga shoqëria, mirëpo është koha që të fokusohemi në tregun e punës, në profesionet si në teknologji, politikë, e të tjera, tha Berisha.

Në vijim, dr. Vjollca Krasniqi, profesreshë e Psikologjisë, tha se ekonomia femërore po rritet në shumë vende, ndërkohë që ajo më herët ka qenë një disiplinë mashkullore dhe vendimmarrja e femrave ka qenë e rrallë.

Ajo theksoi se të drejtat duhen të jenë të barabarta si në familje edhe në ekonomi e çdo kund tjetër.

Çështjet gjinore në ekonomi, llogariten si lokale, mirëpo ato duhet

të jenë globale, tha dr. Krasniqi, duke shtuar se është e rëndësishme që femrat të përfshihen në politikat makroekonomike.

Hulumtuesja Nicole Farnsworth theksoi se ekzistojnë të punësuarit, të papunësuarit dhe të qëndrueshmit ekonomikisht, ndërsa shtoi se femrat duan të jenë në këtë grupin e tretë.

Ajo tha se femrat në Kosovë duan të jenë të zonjat, përndryshe ne nuk do të ishim fare këtu.

Ne duhem të punojmë, sepse askush përpos nesh nuk merret me këtë punë. Nëse ne nuk ngritemi për vete, do të qëndrojmë në shtëpi, do të punojmë si amvise dhe do të merremi vetëm me fëmijë, tha ajo.

Pas përfundimit të prezantimeve nga të ftuarat, u bë një debat interaktiv nga to dhe audienca. U shpjeguan disa ide dhe disa mundësi biznesi për njerëzit të cilët do ta bënin një punësim gjinor 50 për qind femra e 50 për qind meshkuj.

EDONA JERLIU, DRIN JAKURTI

NË NISMË TË VITIT TË RI AKADEMIK 2015/2016

UBT FILLOI VITIN E RI AKADEMIK ME PRITJEN SOLEMNE TË STUDENTËVE TË RINJ

9 tetor 2015. - Studentët e rinj, që kanë zgjedhur për të studiuar në UBT, në vendin ku zgjedhin të studiojnë më të mirë dhe më të suksesshmit, janë pritur sot solemnisht, në nismë të vitit të ri akademik 2015/2016.

Në ceremoni të ndara, mirëseardhje u është dëshiruar studentëve të fakulteteve të Arkiteturës dhe të Ndërtimtarisë, pastaj atyre të Menaxhmentit, Biznesit dhe Ekonomisë, atyre që do të studiojnë Sistemet e Informacionit, Politikat Publike dhe Menaxhimin. Më tej u mirëpritën studentët e rinj që kanë zgjedhur të studiojnë Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, Menaxhim të Mekatronikës dhe Inxhinieri të Energjisë, si dhe studentëve të rinj të Shkencave Politike, të Juridikut dhe të Mediave dhe Komunikimit.

Rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi u dëshiroi mirëseardhje duke i uruar studentët dhe stafin për fillimin e vitit të ri akademik. Ai e konsideroi këtë fillim një ngjarje të rëndësishme ngase për studentët e rinj fillimi i studimeve në një institucion të arsimit të lartë është moment i paharrueshëm.

Ky është viti i 14-të që UBT punon dhe mirëpret studentët nga Kosova dhe vendet e rajonit.

Rektori Hajrizi tha se UBT ka arritur të integrohet në të gjitha strukturat dhe në programet e ndryshme botërore.

“UBT është pjesë e shkollave evropiane që ju ofron studentëve mësim të mirë dhe kushte për zhvillimin e praktikave”, tha dr.Hajrizi, duke shtuar se UBT është lider në aspektin e involvimit të teknologjisë në praktika profesionale, që i ndihmojnë studentëve në zhvillimin e tyre.

“Teknologjia e avancuar që gjendet në UBT, komunikimi, gjenerimi i ideve të reja, interaktiviteti janë këto gjëra që ne i ofrojmë, duke pasur për qëllim që studenti të ndahet i kënaqur nga ne, sepse duam që suksesi të jetë i garantuar”, u shpreh ai.

Rektori Hajrizi foli në vijim për vizitat studimore, një nga elementet dalluese të UBT-së, të cilat u ndihmojnë studentëve të ndërlidhin teorinë me praktikën, si dhe të njihen me kultura të reja dhe praktika të studimeve në universitete prestigjioze në botë.

“Kemi mbi 100 vende partnere që na ndihmojnë në promovimin e vlerave tona dhe studentëve i japim mundësi për të studiuar jashtë vendit me të njëjtat cilësi të studimeve dhe programeve”, tha në vijim rektori Hajrizi, duke shtuar se “së bashku me ju ne provojmë të ndërtojmë një elitë të studentëve të suksesshëm në çdo sferë profesionale”.

Ai theksoi në vijim se në UBT janë arritur suksese të mëdha, falë stafit profesional, ligjëratarave të nivelit të lartë dhe studentëve të përkushtuar.



“Do të vazhdojmë me të njëjtin ritëm të standardeve ndërkombëtare. Jorastësisht UBT përfaqëson Kosovën nëpër gara ndërkombëtare edhe në arsimin e lartë edhe në cilësi edhe në shumë pika të tjera dhe falë bashkëpunimit kemi arritur të jemi të parët”, theksoi dr.Hajrizi.

Ai theksoi se infrastruktura, hapësira moderne për punë që ofron UBT i ndihmon studentëve zhvillim të gjithanshëm, me kushte dhe nivele të universiteteve botërore, ku studenti do të jetë në vazhdimësi i përcjellë dhe i ndihmuar, si në nxënien e dijes ashtu edhe në realizimin e projekteve dhe ideve të tij.

Dr.Hajrizi gjithashtu theksoi se UBT u jep bursa studentëve të mirë dhe ka një lidhshmëri sa i përket projekteve dhe granteve, që studentëve u mundësojnë të kalojnë një semestër ose një vit akademik në universitetet e huaja.

Para studentëve të rinj dhe familjarëve të tyre folën edhe dekanët e të gjitha fakulteteve, duke i njoftuar më në detaje me programet e studimeve, si dhe përfaqësues të Alumnit, që paraqitën përvojat e tyre të studimeve

në UBT dhe rrugëtimin e tyre të suksesshëm pas studimeve në ndërtimin e karrierës.

Ambiente të reja për studim e hulumtim në UBT

21 gusht. - Krahas angazhimit të përditshëm për t’iu përgjigjur interesimit të të rinjve për regjistrim në të gjitha drejtimitet e studimeve në UBT, po vazhdojnë pandalshëm punët si në objektin e UBT-së në Prishtinë ashtu edhe në kampus për zgjerimin e hapësirave për studime dhe hulumtime.

Parë nga numri i të rinjve që çdo ditë mësojnë UBT-në për të marrë më shumë informata për programet dhe mundësitë e ofruara, është shumë e qartë se UBT vazhdon të jetë institucioni më tërheqës dhe më atraktiv për studentët e ardhshëm. Programet e veçanta të studimit, laboratorët, qasja e stafit dhe e mësimdhënësve, bashkëpunimet ndërkombëtare dhe mundësitë e mëdha për bursa studimi që UBT i ofron falë bashkëpunimit me institucionet më prestigjioze akademike ndërkombëtare, shkalla shumë e lartë

e punësimit të të diplomuarve, mundësitë e mëdha për internship, programet e universiteteve ndërkombëtare të ofruara në UBT e shumë elemente të tjera e bëjnë këtë më të kërkuar në ndër të rinjtë kosovarë dhe nga vendet e rajonit.

Ndaj UBT, që shquhet për infrastrukturë moderne, hapësira të mjaftueshme, kampus inovativ e shumë mundësi të tjera, po

punon pandalshëm që të shtojë edhe më shumë elemente infrastrukturorë, hapësira mësimi e hulumtimi, laboratorë e mjete të tjera pune, që studentët aktualë e sidomos studentët e ardhshëm të kenë një ambient të kompletuar, t’i kenë të gjitha në një vend. E gjithë kjo – për të ecur pandalshëm në rrugën e dijes. Për t’u bërë më të mirët!



PAS SHPALLJES FITUES NË «PEOPLE’S CHOICE AWARD» TË NASA SPACE APPS CHALLENGE 2015

STUDENTËT E UBT-SË DHE TË UP-SË ARRITËN NË STACIONIN HAPËSINOR TË NASA-S NË FLORIDA

4 dhjetor. - Muhamed Retkoceri, Rinor Maloku dhe Taulant Mehmeti, student të UBT-së, së bashku me kolegët e tyre nga Universiteti i Prishtinës, kanë arritur në stacionin hapësinor të NASA-s në Florida të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Tre studentët e UBT-së, së bashku me kolegët e tyre nga UP-ja janë pjesë e projektit “Natev Explorer”, që u shpall fitues i «People’s Choice Award» të NASA Space Apps Challenge 2015.

Agjencia e lajmeve “Telegrafi”, në një lajm për këtë ngjarje, thekson se fotografia e postuar nga grupi i të rinjve, tregon se ata kanë marrë me vete flamurin e Kosovës dhe atë të Shqipërisë.

“Ëndrra u realizua! #NatEv dhe ICK pushtojnë NASA-n. Falënderim i veçantë të gjithëve për përkrahjen!”, shkruajnë ata, sipas “Telegrafit”.



KONFERENCA "DITA E TRASHËGIMISË KULTURORE DHE HISTORIKE TË KOSOVËS"

Dr. Fatmir Sejdiu në konferencën e UBT-së, flet për trashëgiminë kulturore dhe historike të Kosovës

"Marrëdhëniet e shqiptarëve me Austrinë dhe popullin e saj, pavarësisht periudhat historike, qofshin ato të hershme, apo këto të mëvonshmet, janë ndërtuar mbi bazë të një miqësie të thellë. Kjo në radhë të parë vjen si rezultat i të bëmave të shumta pozitive që shprehen me mbështetje të rëndësishme për shqiptarët dhe që i gjejmë si veprime të pazëvendësueshme atëherë kur bëhej historia", tha Prof. Dr. Fatmir Sejdiu, president i Republikës së Kosovës në periudhën 2006 -2010

26 nëntor 2015. - Konferenca "Dita e Trashëgimisë Kulturore dhe Historike të Kosovës", e organizuar nga Shoqata Austriako-Kosovare dhe UBT, ka mbledhur sot në Prishtinë pjesëmarrës të shumtë, përfshirë ish-Presidentin e Republikës së Kosovës, dr.Fatmir Sejdiu, ish-ambasadorin e Republikës së Shqipërisë në Kosovë, Islam Lauka, drejtorin e Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Alban Bakija, Sali Shoshin nga "Trashëgimia Kulturore pa Kufij", Gjejlane Hoxha Belegun nga Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore, Baton Haxhiun nga TV Klan, dr.Lulzim Beqirin, dekan i Fakultetit të Arkitekturës në UBT e profesionistë të tjerë.

Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, në hapje të konferencës, ka theksuar rëndësinë e trashëgimisë kulturore dhe historike të Kosovës dhe angazhimit të UBT-së për të dhënë kontributin e tij edhe në këtë fushë, sikur në shumë fusha me interes për vendin dhe për shoqërinë kosovare.

Prof. Dr. Fatmir Sejdiu, president i Republikës së Kosovës në periudhën 2006 -2010, fillimisht i bëri një pasqyrë raporteve Austriako-Kosovë.

"Marrëdhëniet e shqiptarëve me Austrinë dhe popullin e saj, pavarësisht periudhat historike, qofshin ato të hershme, apo këto të mëvonshmet, janë ndërtuar mbi bazë të një miqësie të thellë. Kjo në radhë të parë vjen si rezultat i të bëmave të shumta pozitive që shprehen me mbështetje të rëndësishme për shqiptarët dhe që i gjejmë si veprime të pazëvendësueshme atëherë kur bëhej historia", tha ai.

Më tej ai vuri theksin te zhvillimet rreth anëtarësimit të Kosovës në UNESCO. "Vendimi i para



pak ditësh për mospranimin e Kosovës në atë sesion të vendeve anëtare të OKB-së, për sa ishte jo i lehtë për Kosovën, për aq mendoj se duhet kuptuar si një sinjal për njerëzit e Kosovës dhe në veçanti përgjegjësit në institucione se duhet ndërruar shumë çka në qasjen e tyre të përgjithshme, si në udhëheqje me vendin dhe po kështu edhe në punën për promovimin e vlerave reale kulturore - historike që i ka ky vend", tha dr.Sejdiu, duke shtuar se angazhimi i Serbisë dhe i gjithë rrjetit të saj diplomatik për të penguar Kosovën për anëtarësim të kësaj institucioni të rëndësishme se posaçme ndërkombëtare, nuk ka se si të kuptohet ndryshe, pos si një përpjekje minuese e saj për të penguar shtetin e ri duke e dëshiruar dështimin e qëndrueshmërisë së tij si shtet i pavarur.

Ai tha se çështja e mbrojtjes së trashëgimisë së përgjithshme kulturore dhe historike të vendit ka qenë një temë e rëndësishme në bisedimet për statusin final të Kosovës.

"Duke qenë dëshmitarë, por edhe pjesëmarrës në procese të rëndësishme që i ka kaluar vendi në rrugën e tij drejt pavarësisht, dua të nënvizoj faktin se veçanërisht në bisedimet e Vjenës për statusin të udhëhequr nga Marti Ahtisaari dhe në ato 120 ditë të tjera të shtesës e që ishin jashtëzakonisht të ndjeshme, njëra nga temat e rëndësishme, përveç çështjes së statusit, ka qenë çështja e mbrojtjes së trashëgimisë së përgjithshme kulturore dhe historike të vendit, për të cilën pala serbe

ka pretenduar se është trashëgimi e saj, duke dashur kështu të manipulojë faktet historike. Edhe atëherë e, edhe sot është dhënë dhe besoj se edhe sot jepet përgjigjja; e gjithë kjo trashëgimi është e Kosovës dhe e njerëzve të saj dhe se si e tillë duhet mbrojtur dhe kultivuar. Ajo trashëgimi është e bollshme, duke filluar nga më e hershmitja e deri te ajo e ditëve të sotme", tha Sejdiu.

Duke vënë theksin te veprimet që duhet të bëhen tash dhe në të ardhmen, ish-Presidenti Sejdiu theksoi se Kosovës, tani dhe në vazhdimësi i nevojitet një stabilitet i qëndrueshëm politik i cili në situatën e krijuar kërkon veprime të urta dhe shumë racionale që nënkupton një ujdj nacionale-shtetërore për të gjitha temat e mëdha e të ndjeshme që i ka para vetës.

Ai tha se stabiliteti i qëndrueshëm i vendit nuk mund të supozohet vetëm me forcën e numrave, por edhe me kualitetin e veprimeve.

Z.Sejdiu tha se nevojitet një ridizajnim i strategjisë së veprimit për punën e gjithë mekanizmave institucionalë të vendit, duke filluar nga vetë puna e institucioneve të qeverisjes në nivel lokal dhe veçanërisht të atyre që merren me mbrojtjen, zhvillimin dhe kultivimin e vlerave kulturore e historike të vendit, duke u siguruar mbështetje shtesë dhe shumëdimensionale për punët që i presin;

Sipas tij, duhet të bëhet konceptimi dhe promovimi i politikave shtesë për punën e institucio-

neve përgjegjëse dhe respektive, sidomos në fushën e arsimimit, edukimit, shkencës dhe kulturës, mbrojtjes së mjedisit etj., si dhe harmonizimi i këtyre politikave dhe veprimi i koordinuar i institucioneve përgjegjëse, përkatësisht ministrive si në hapësirën brenda vendit, ashtu edhe jashtë tij, dhe bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe organizmat e tjerë që merren me këto problem. Ai përmendi edhe investimin në projekte faktografike dhe publikime të reja, të cilat japin një pasqyrë edhe më të bollshme të kësaj trashëgimie, mundësisht në shumë gjuhë, pra edhe në gjuhën e popujve numerikisht edhe më të paktë në numër sesa Kosova, sepse vota e tyre është e barabartë;

Ai theksoi edhe një varg veprimesh, si organizimi i ngjarjeve me peshë të veçantë nga fusha respektive, prezantimi më i gjithanshëm i vlerave të pakontestueshme kulturore dhe humaniste që reflektojnë bashkëpunimin dhe tolerancën ndërfaqetare të besimeve dhe konfesioneve të ndryshme brenda një etnie, apo midis etnive të ndryshme, prezantimi i respektit real të qytetarëve të Kosovës për monumentet e kultit, konceptimi i një strategjie shtesë për kontakte diplomatike, angazhimi për sigurimin e mbështetjes së vazhdueshme lobuese të vendeve që deri tani kanë dhënë kontribut të rëndësishëm mbështetës në shtimin e njohjeve për Kosovën e që kjo të vazhdojë si e tillë e veprime të tjera.

Drejtori i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Alban Bakija theksoi ndër të tjera se mospranimi i Kosovës në UNESCO është vendim jo i drejtë.

Ai e konsideroi të rëndësishëm faktin se çdo popull duhet t'i dijë vlerat e tij kulturore, trashëgiminë si dhe monumentet.

Sipas Gjejlane Hoxha Belegut nga Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore saj, Kosovës i duhet ndihmë nga vendet e huaja për të krijuar standarde të mira e të reja. Ajo tha se monumentet e trashëgimisë kulturore janë të bollshme për ne që i dimë dhe i vizitojmë. Por, të shikohet nga ana tjetër e mediave të huaja, ata gabojnë ngase mendojnë se as nuk ka monumente e lëre më që të respektohen.

Ajo po ashtu e ka përmendur UNESCO-n, duke e konsideruar se ishte një zhgënjim total mosanëtarësimi i Kosovës. "Misioni i Kosovës dhe i UNESCO-s është mbrojtja e trashëgimive dhe monumenteve kulturore", u shpreh Gjejlane Hoxha, duke shpresuar se viti 2017 do ta gjejë Kosovën më të përgatitur që ta kalojë këtë sfidë.

"Nëse nuk jemi pranuar këtë vit nuk do të thotë që UNESCO na ka harruar", theksoi ajo.

"Të gjithë duhet t'i përmbushim punët dhe përgjegjësitë që brezat pasardhës të kenë më shumë interesim për ruajtjen e monumenteve kulturore dhe për mbështetjen në këtë mision", tha ndër të tjera ajo.

Islam Lauka, ish-ambasador i Republikës së Shqipërisë në Kosovë, ndër të tjera theksoi se Kosova nuk mund të shkojë në UNESCO vetëm me ndihmën e një individi ose disa individëve ose edhe grupeve të caktuara por me të gjithë. Dhe nëse bëhet kjo, atëherë anëtarësimi është i sigurt.

Kur kemi mbrojtje të trashëgimisë kulturore dhe traditave tona atëherë edhe mekanizmat ndërkombëtarë do të na mbështesin", tha z.Lauka.

Trashëgimia kulturore duhet mbrojtur jo vetëm e Kosovës por e të gjithëve, jo sepse duan serbët, as turqit, as askush por duhet mbrojtur për nder të Kosovës, tha Lauka.

Ai gjithashtu përmendi kontributin e Austrisë për zgjimin kulturor të shqiptarëve dhe afirmimin politik të tyre.

Sali Shoshi, Udhëheqës i Organizatës "Trashëgimia Pa kufij", i kushtoi rëndësi menaxhimi me lokalitetet. Ai tha se duhet të ekzistojë një faqe zyrtare për këtë sektor që të mund të njoftohen qytetarët për këtë temë.

KONFERENCA PËR VETËQEVERISJEN LOKALE

PA DEFINIM TË PRONËS NUK DO TË KETË ZHVILLIM NË KOSOVË

“Për Republikën e Kosovës përvojat nga Austria do të ishin të shkëlqyeshme. Dera e madhe për Kosovën po të hapet vetëm atëherë kur të hyjmë në derën e vogël të mësimave që mund të nxjerrim nga përvojat austriake”, tha Besnik Tahiri, drejtor ekzekutiv i Institutit të Kosovës për Qeverisje Lokale

13 nëntor. - “Pa definim të pronës, të çështjeve që ndërliken me pronën, atë komunale, atë private, nuk do të ketë zhvillim në Kosovë”, theksoi Besnik Tahiri, drejtor ekzekutiv i Institutit të Kosovës për Qeverisje Lokale.

“Për Republikën e Kosovës përvojat nga Austria do të ishin të shkëlqyeshme. Dera e madhe për Kosovën po të hapet vetëm atëherë kur të hyjmë në derën e vogël të mësimave që mund të nxjerrim nga përvojat austriake”, tha z.Tahiri.

Zoti Tahiri i bëri komente në kuadër të konferencës për vetëqeverisjen lokale, ku u diskutua për pronën si shtyllë të përparimit në Kosovë, specifikat e çështjes së pronës në Kosovë, përvojat në vendet e rajonit dhe, me theks të veçantë, përvojat në Austri.

Konferenca u organizua nga Shoqata Austriake-Kosovare, UBT dhe Instituti i Kosovës për Qeverisje Lokale.

Ambasadorja e Zvicrës në vendin tonë, Krystyna Marty-Lang, në një fjalim më të gjatë theksoi përvojat zvicerane dhe specifikat e çështjes së pronës në Kosovë.

Shteti zviceran është përkrahësi më i madh i institucioneve të Kosovës në çështjet e pronës. Ajo theksoi se shteti zviceran përkrah ministrinë përkatëse dhe asociacionet që merren me problemet e pronës në nivel vendi, si dhe një numër komunash në vend.

Gjithashtu, zonja Krystyna Marty-Lang theksoi se udhëhe-



qësit dhe kryetarët e komunave duhet të kujdesen që të gjitha ndërtimet të jenë sipas planit dhe që, sidomos, të kihet kujdes që, me rastin e ndërtimeve të reja, të mos ketë asnjë problem sa i përket pronës.

Përfaqësuesi i Asociacionit të Komunave të Austrisë dhe kryetar i komunës Lasse në këtë shtet, Karl Grammantisch, foli në detaje për mënyrën se si është e rregulluar çështja e pronës komunale dhe pronës private në Austri.

Ai theksoi ndërliken e pronës me zhvillimin ekonomik të rajonit të caktuar, si dhe aspektet e tjera, siç është edhe aspekti i transportit, me qëllim të krijimit të kushteve më të mira për qytetarët.

Z. Grammantisch dha një varg detajesh për planifikimin në të gjitha nivelet, duke pasur gjithmonë parasysh ruajtjen e ambientit, llojet e ndryshme të tokave, zonat e mbrojtura, planet për ndërtime dhe, sidomos,

involvimin e publikut në vendim-marrje.

Sazan Ibrahim, drejtor i Asociacionit të Kosovës, paraqiti para të pranishmëve një historik të zhvillimit dhe punës së këtij asociacioni, karakterin dhe organizimin e tij, si dhe theksoi faktin se është shteti zviceran ai që jep ndihmën më të madhe në funksionimin e këtij asociacioni, i cili mbledh në strukturën e tij organizative 33 nga 38 komuna sa ka Kosova.

Rекторi i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, duke folur në konferencë, ka theksuar problemet prezente në vendin tonë në lidhje me çështjen e pronës, si dhe faktin se UBT, me ekspertët e saj, ka dhënë një ndihmesë shumë të madhe për një varg komunash të Kosovës për hartimin e planeve të tyre zhvillimore afatgjate, ku prona zë një vend të veçantë, duke qenë një pikë shumë problematike në vendin tonë.

Edhe folës të tjerë, ekspertë të kësaj fushe, kanë theksuar pro-

blemet në këtë fushë dhe mënyrën për zgjidhjen e tyre.

Studentët të UBT-së dhe të interesuar të tjerë e kanë përcjellë konferencën dhe kanë marrë pjesë në debatin e gjerë të zhvilluar gjatë dhe pas diskutimeve.

Përfaqësues nga Austria njihen me zhvillimet në komunën e Obiliqit dhe të Podujevës

13 nëntor. - Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, së bashku me kryetarin e Shoqatës Austriake-Kosovare, Gunther Fehlinger, si dhe përfaqësuesit nga Austria, z.Karl Grammantisch, kryetar i komunës Lasse në Austri dhe përfaqësuesi i Asociacionit të Komunave të Austrisë, si dhe z.Wolfgang Grosssruck, ish-kryetar i Grieskrichen-it në Austri dhe ish-kryetar i Asamblesë së OSBE-së, vizituan dhe dy komuna të Kosovës, Kastriotin dhe Podujevën. Në takim me drejtuesit e komunave të Obiliqit dhe të Podujevës, ata u njoftuan me organizimin e tyre, me theks të veçantë me rregullimin e çështjes së pronës, që është një çështje ende problematike në vendin tonë.

Në komunën e Obiliqit, ata u pritën nga kryetari i komunës, z.Xhafer Gashi, i cili i njoftoi për zhvillimin e komunës dhe problemet me të cilën përballen banorët e saj.

Kryetari Gashi me këtë rast ftoi bizneset dhe Odën Ekonomike Austriake për investime në

Komunën e Obiliqit, ndërsa para të pranishmëve shpalosi edhe planin konkret për zonën e lirë ekonomike në Obiliq.

Po ashtu si teme e veçantë ishte edhe mundësia e binjakëzimit mes komunave, ku do të ishte mundësi e mirë e shkëmbit të përvojave mes komunës së Obiliqit dhe asaj austriake, Lasse.

Në Podujevë, delegacioni u prit nga nënkryetari i komunës, z. Nexhmi Rudari, i cili i njoftoi nga afër me rezultatet e qeverisjes komunale në Podujevë dhe projektet zhvillimore. Gjatë takimit të nënkryetarit Rudari, me delegacionin austriak u bisedua edhe për mundësinë e bashkëpunimit të komunës së Podujevës me komunat austriake. Në takim gjithashtu u bisedua për rolin e komunës në zhvillimin ekonomik lokal dhe bashkëpunimin me akterët lokalë. U theksua se takimet si ky do të shërbejnë për një fokusim të ri në bashkëpunimin e ndërsjellë në zhvillimin ekonomik dhe social. Në takim ishte i pranishëm edhe z.Besnik Tahiri, drejtor ekzekutiv i Institutit Kosovar për Qeverisje Lokale dhe z. Gunther Fehlinger, kryetar i Odës Ekonomike Austriake në Kosovë. Z.Karl Grammantisch dhe z.Wolfgang Grosssruck morën pjesë gjatë ditës së sotme në konferencën e organizuar në UBT që trajtoi çështjen e pronës dhe dhanë një kontribut të çmuar, duke përcjellë përvojat austriake në këtë fushë.

UBT DHE SHOQATA “MIQTË E AMERIKËS”

Shënohet 69-vjetori i lindjes së Presidentit Bill Klinton

Dita e lindjes e Presidentit Klinton është një ditë në të cilën ne takohemi dhe përkujtojmë me falënderim gjithë atë që SHBA ka bërë për Kosovën. Do të jemi mirënjohës për kohën paraprake dhe për lirinë e kontributin e tij për zhvillimin e Kosovës

19 gusht. - Në një ceremoni të organizuar sot nga UBT dhe Shoqata “Miq të Amerikës”, u shënuar 69-vjetori i lindjes së Presidentit të SHBA-së, Bill Klinton.

Rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi theksoi fillimisht se shënimi i ditëlindjes së Presidentit Bill Klinton është një shenjë falënderimi dhe respekti për punën e tij, lidhshimin e tij politik, në aspektin e paqes ndërkombëtare, por në veçanti për atë që Klintoni por edhe SHBA kanë bërë për Kosovën. Kjo na ka mundësuar që sot të kemi institucione të arsimit të lartë dhe të zhvillohemi edhe më tutje. Falë një kontributi shumë të madh, një vendosmërie që Presidenti Klinton e ka pasur në kohët më të vështira për ne.

Dita e lindjes e Presidentit Klinton është një ditë në të cilën

ne takohemi dhe përkujtojmë me falënderim gjithë atë që SHBA ka bërë për Kosovën, tha ai, për të shtuar se do të jemi mirënjohës për kohën paraprake dhe për lirinë e kontributin e tij për zhvillimin e Kosovës.

Më tej rektori Hajrizi se edhe UBT është ndihmuar nga SHBA-ja. “Na kanë ndihmuar në shumë raste për zhvillimin e programeve të reja, në ndërtimin e qendrave të ndryshme. Sivjet kemi pasur shumë përkrahje sidomos në ndërtimin e inkubatorit virtual të Kosovës, që është risi, në ndërtimin dhe Librarisë më të madhe të arsimit të lartë në Kosovë, e shumë e shumë raste të tjera, falë bashkëpunimit dhe kontributit të popullit të SHBA-ve”, tha prof. dr. Hajrizi.

Në vazhdim, Agim Rexhepi, kryetar i Shoqatës “Miq të Ame-



rikës” falënderoi rektorin Hajrizi dhe UBT-në për përkrahjen e vazhdueshme të nismave të kësaj shoqate dhe sidomos për përkrahjen pa hezitim të manifestimit të shënimit të ditëlindjes së 69-të të Presidentit Klinton.

“Këtë vit kemi dashur që ta thejmë klisenë duke e organizuar

këtë takim në një institucion si UBT-ja, pasi që vite me radhë kjo ditë është shënuar në rrugë, nëpër komuna të caktuara, me institucione komunale, ndërsa tani radhën e ka institucioni arsimor, sepse e ardhmja e këtij vendi është rinia, e ardhmja është arsimimi. Me këtë rast kemi gjetur shumë përkrahje

nga Edmond Hajrizi dhe këtu kemi gjetur shumë mirëkuptim dhe suksese në UBT, me sukseset në gara kombëtare dhe ndërkombëtare”, theksoi z.Rexhepi.

Z.Rexhepi përmendi edhe faktin se me ndërmjetësimin e shoqatës që ai drejton po ndërtohet një shtëpi për një familje në fshatin Konjuh, e cila do të jetë së shpejti e gatshme për familjarët.

“Do të isha ndalur te një fjalë e Presidentit Bill Clinton, i cili thotë se gjatë tërë jetës time do të punoj për Kosovën. Presidenti është shumë mirënjohës për të arriturat e Kosovës dhe ai e thekson se ardhmëria e Kosovës është rinia. Ne do t'i dërgojmë urime dhe fotografi duke dashur që t'i tregojmë se edhe ne jemi falënderues. Ai ka qenë i njoftuar për këtë ngjarje”, theksoi në fund z.Rexhepi.

KONFERENCA VJETORE NË DURRËS, ME PJESËMARRJE TË GJERË NDËRKOMBËTARE



MBI 300 PJESËMARRËS DHE 220 PREZANTIME NË KONFERENCËN NDËRKOMBËTARE TË UBT-SË PËR BIZNES, TEKNOLOGJI DHE INOVACION

Në konferencë morën pjesë përfaqësues nga shumë universitete nga Shqipëria, Universiteti i Tiranës, Universiteti i Vlorës, Universiteti i Shkodrës e institucione të tjera akademike, pastaj përfaqësues nga universitetet partnere, Universiteti i Vjenës për Teknologji, Universiteti Corvinus i Budapestit dhe përfaqësues të universiteteve të tjera nga ky shtet

6 nëntor. - Mbi 300 pjesëmarrës nga 15 shtete po marrin pjesë në Konferencën e Katërt Ndërkombëtare për Biznes, Teknologji dhe Inovacion, e cila organizohet nga Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë i UBT-së, në bashkëpunim me partnerët, Universitetin e Tiranës dhe Universitetin e Vlorës, si dhe një varg institucionesh të tjera, partnerë të tjerë profesionalë, si EUROSIM, Asociacioni i Kosovës për Kontroll, Automatizëm dhe Sistem Inxhinierik (KA-CASE), Asociacioni Kosovar për Modelim dhe Simulim (KA-SIM), Quality Kosova dhe Asociacioni Kosovar për Menaxhim.

Gjatë dy ditëve të konferencës do të prezantohen 220 punimet, në dhjetë konferenca, në katër sesione paralele, në të cilat do të paraqiten hulumtime shkencore dhe do të zhvillohen debate në një varg temash: Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri e Komunikimit, Eficiencia e Energjisë, Menaxhim, Biznes dhe Ekonomi, Mekatronikë, Inxhinieri e Sistemit dhe Robotikë, Sisteme të Informacionit dhe Siguri, Arkitekturë – Planifikim

hapësinor dhe inxhinieri civile, Inxhinieri, infrastruktura dhe mjedis, Drejtësi, Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare, Media dhe Komunikim, si dhe një varg temash të tjera.

Në ceremoninë e hapjes së Konferencës morën pjesë përfaqësues nga shumë universitete nga Shqipëria, Universiteti i Tiranës, Universiteti i Vlorës, Universiteti i Shkodrës e institucione të tjera akademike, pastaj përfaqësues nga universitetet partnere, Universiteti i Vjenës për Teknologji, Universiteti Corvinus i Budapestit dhe përfaqësues të universiteteve të tjera nga ky shtet. Disa prej tyre i janë drejtuar pjesëmarrësve të konferencës, duke çmuar rëndësinë e saj, si një ndër konferencat më të mëdha në rajon në fushën e Biznesit, Teknologjisë dhe Inovacionit, dhe kontributin që japin në këto fusha autorët që do të prezantohen gjatë dy ditëve të punimeve të saj.

Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, si nikoqir i konferencës, theksoi rëndësinë shumë të madhe të kësaj konfe-

rence, e cila organizohet për të katërtin vit me radhë. Ai tha se këto konferenca kanë njohur rritje të pjesëmarrësve, të prezantimeve dhe zgjerim të rrjetit të bashkëpunësorëve ndërkombëtarë.

Përveç Universitetit të Tiranës, atij të Vlorës dhe të Shkodrës, në Shqipëri, rektori Hajrizi theksoi bashkëpunimin e ngushtë me Universitetin e Vjenës dhe universitetet e tjera të shumta partnere.

Në ditën e parë të konferencës u paraqitën një varg prezantimesh në sesionet e Biznesit dhe Ekonomisë, Shkencave Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare, Energjisë Eficiente, Arkitekturës dhe Ndërtimtarisë.

Konferenca e Katërt Ndërkombëtare për Biznes, Teknologji dhe Inovacion ka zgjuar interesim shumë të madh të profesionistëve të fushave të shtruar për diskutim, ndërkohë që e gjithë konferenca po përcillet me debate mes prezantuesve, pjesëmarrësve dhe studentëve të UBT-së dhe të universiteteve të tjera, pjesëmarrës në konferencë.

Pjesëmarrje e madhe dhe debate interesante në konferencën e Shkodrës



UBT DHE UNIVERSITETIT "LUIGJ GURAKUQI" ORGANIZUAN KONFERENCËN SHKENCORE NDËRKOMBËTARE

Konferenca i zhvilloi punimet në disa sesione, në formë të ligjëratave nga ekspertë të fushave respektive, ndërsa u zhvillua debat i gjerë, me pjesëmarrje aktive edhe të studentëve të UBT-së dhe të Universitetit "Luigj Gurakuqi"

29 tetor. - Në ambientet e Universitetit "Luigj Gurakuqi" në Shkodër i zhvilloi punimet konferenca shkencore ndërkombëtare "Kërkimi dhe edukimi – sfidat drejt së ardhmes" ICRAE 2015. (Research and education-challenges towards the future), e organizuar nga UBT nga Prishtina dhe Fakulteti i Shkencave të Edukimit, Fakulteti i Shkencave Shoqërore në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi". Gjatë dy ditëve sa i zhvilloi punimet kjo konferencë, u diskutuan një varg temash nga fusha e albanologjisë, artit, ekonomisë, kulturës, arsimit të lartë, TIK-ut (teknologjisë së informimit dhe të komunikimit), medias e komunikimit, filologjisë, sporteve, shkencave shoqërore, kërkimit shkencor e tema të tjera.

Në konferencë morën pjesë përfaqësues nga universitete të njohura nga Shqipëria, Kosova, Bosnja e Hercegovina, nga Universiteti i Denverit në SHBA e ekspertë fushash të caktuara nga vende të ndryshme.

Konferenca i zhvilloi punimet në disa sesione, në formë të ligjëratave nga ekspertë të fushave respektive, ndërsa u zhvillua debat i gjerë, me pjesëmarrje aktive edhe të studentëve të UBT-së dhe të Universitetit "Luigj Gurakuqi".

Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, në një ligjëratë që zgjoi interesim mjaft të madh të pjesëmarrësve, foli në detaje për zhvillimin e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës, me theks të veçantë për rezultatet e arritura, sidomos në fushën e hulumtimit

dhe të inovacionit, por edhe të bashkëpunimit ndërkombëtar, në të cilat UBT është prijatë në vendin tonë, por edhe në rajon.

Në sesione të ndryshme të konferencës morën pjesë edhe profesorë të tjerë të UBT-së, të cilët dhanë kontributin e tyre në ligjëratë dhe debate të zhvilluara në kuadër të konferencës.

Në margjina të konferencës, rektori Hajrizi u takua me rektorë dhe përfaqësues të universiteteve të ndryshme, pjesëmarrës në konferencë, të cilët shprehën interesim për lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit me UBT-në, në fushën e shkëmbimit të stafit dhe të studentëve, zhvillimit të projekteve të përbashkëta në inovacion dhe hulumtim dhe në fusha të tjera.

Në përmbyllje të konferencës, drejtuesit e universiteteve pjesëmarrësve, përfshirë edhe përfaqësuesit e UBT-së u pritën në një takim nga kryetarja e Bashkisë së Shkodrës, zonja Voltana Ademi, e cila i përgëzoi për organizimin e suksesshëm të konferencës dhe shprehu interesimin e saj dhe të bashkisë që drejton për bashkëpunime të tjera, sidomos mes UBT-së dhe Universitetit "Luigj Gurakuqi", të cilat kanë zhvilluar një varg aktiviteteve të përbashkëta deri tash dhe kanë një varg projektsh për t'i realizuar në të ardhmen.

Pjesëmarrësit e konferencës zhvilluan edhe një vizitë në ambiente të ndryshme të qytetit të Shkodrës, përfshirë fonotekën "Marubi", muzeun dhe një varg monumentesh në qytet e rrethinë.

AKADEMITË VERORE, NJË MUNDËSI SHITESË PËR STUDENTËT DHE PROFESORËT



Akademia verore e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, Infrastrukturës dhe Mjedisit

14 korrik . – Në UBT i ka zhvilluar punimet akademia verore e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, Infrastrukturës dhe Mjedisit. Në ceremoninë përmbyllëse u bë dorëzimi i certifikatave të studentëve pjesëmarrës në akademi, gjithsej 62, si dhe u dorëzuan edhe certifikatat e 13 ligjëruesve në këtë akademi. Certifikatat i dorëzoi dekani i fakultetit, Dr.Muhamet Ahmeti, ndërsa me një fjalë rasti të pranishmit i përshëndeti edhe profesori, Dr.Binak Beqaj.

Gjate akademisë u mbajtën ligjërata me tematika të ndryshme, me shumë rëndësi për studentët e Fakultetit të Ndërtimit dhe fakultetet e tjera: Kontrolli i Cilësisë në kantierin e ndërtimit të strukturave betonarme, sipas standardit evropian EN 13670; Recepturat e përgatitjes së asfaltit për konstruksionet e rrugëve; Sistemet e reja të gjeodezisë (prezantimi i teknikës së fundit në matjet gjeodezike); Humbjet e ujit dhe menaxhimi inteligjent i rrjetit distributor në qytetin e Prishtinës; Aftësia vetëshëruese e kompozitave të çimentos; Menaxhimi i punishtës; Ndërtimi i hapësirave publike; Prezantimi i KNAUFIT, Zë izolimi, parimet dhe aplikimi në godinat rezidenciale; Rehabili-

timi strukturor i strukturave sipas Eurocodeve - Rasti Studimor: Ish hoteli Iliria – tani Swisssdiamond hoteli në Prishtinë e të tjera. Pas ligjëratave është organizuar debat me pyetje dhe përgjigje.

Është vlerësim i përgjithshëm se akademia e ka arritur qëllimin dhe objektivat e veta, si dhe çdo herë e më shumë sjell profesorë dhe profesionistë të ndryshëm të ndërtimtarisë, mirëpo edhe numri i pjesëmarrësve është në rritje.

Akademia verore e Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë

Akademia verore e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë në UBT i ka zhvilluar punimet me një varg aktiviteteve dhe projektet të paraqitura.

Në ceremoninë përmbyllëse u bë dorëzimi i certifikatave të studentëve pjesëmarrës në akademi, gjithsej 149 pjesëmarrësve nga fakultete nga Kosova dhe të vendeve të ndryshme si Shqipëri, Maqedoni, Norvegji, Qipro, Greqi etj., si dhe u dorëzuan edhe mirënjohjet e pjesës së 21 ligjëruesve dhe organizuesve në këtë akademi. Certifikatat i dorëzoi dekani dhe prodekanja e Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë.

Gjate akademisë 10 ditore u mbajtën ligjërata me tematika të ndryshme, me shumë rëndësi për studentët nga Kujtim Gashi - Drejtor i Shoqërisë së Informacionit, Arben Gjukaj – Drejtor i KEK-ut, Gazmend Krasniqi – nënkolonel, Gazmend Krasniqi – drejtor i Drejtorisë së Teknologjisë Informative dhe Komunikimit të PK-së, Fisnik Ismaili – bashkëthemelues dhe drejtor kreative i “Karrotës”, Bahtijar Vogli – Profesor i asocuar në Universitetin e LUND-it e të tjerë.

Në kuadër të kësaj akademie, pjesëmarrësit patën rastin të realizojnë vizita të ndryshme studimore në sektorin e ICT, duke filluar nga kompania telekomunikuese IPKO, kompania kreative “Rrota” etj.

Akademia verore ndërkombëtare „Citizen's Diplomacy”

27 korrik. - Në kuadër të organizimeve verore të akademive në fusha të ndryshme studimore, UBT në bashkëpunim me FES, në vitin e dytë të bashkëpunimit, kanë organizuar Akademinë verore ndërkombëtare „Citizens' Diplomacy“. Interesimi për pjesëmarrje ishte i madh, duke pasur pjesëmarrës edhe nga Serbia, Shqipëria, Bosnja e Hercegovina, Shtetet e Bashkuara të Amerikës etj. Mbi 70 të rinj ishin pjesë aktive e Akademisë verore, në të cilën kanë ligjëruar profesionistë nga vendi dhe nga bota, ndër to, profesorë eminentë nga Kosova dhe Shqipëria, Ambasadorë, diplomatë kosovarë, politikëbërës etj. Përveç pjesës përmbytësore atë të ligjëratave dhe workshopeve, aktiviteti kishte edhe një dimension të larmishëm kulturor, ku pjesëmarrësit patën rastin të njihen më nga afër me dy qytetet kryesore të Kosovës, Prishtinën dhe Prizrenin.

Gjatë aktivitetit janë trajtuar tema me rëndësi që përfshijnë këtë nënfushë të diplomacisë, e cila daton qysh nga koha e filimit të Luftës së Ftohtë. Nga të pranishmit dolën këto përfundime: kjo lloj diplomacie është e nevojshme për të mbajtur lidhjet mes vendeve dhe popujve përtej dimensionit bilateral mes shteteve; proceset e pajtimit dhe paqes bëhen më të plota me angazhimin e qytetarëve në diplomaci; efekti i globalizimit e bën të domosdoshme këtë lloj diplomacie; rajoni ynë ka nevojë që, përtej komunikimit mes qeverive, të shtrijë edhe dimensionin e qytetarëve, për të bërë më të qëndrueshëm stabilitetin rajonal, në procesin aktual të dialogut Kosovë-Serbi, duhet përfshirë edhe qytetarët me qëllim që marrëveshjet e arritura të kenë mbështetje më të gjerë popullore.

Kjo akademi verore do të shndërrohet në platformë rajonale për diplomacinë qytetare ku do të trajtohen temat e ndryshme të diplomacisë, pajtimi, paqja dhe

do këtë një fokus të madh edhe në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm fetar. Partnerët e këtij aktiviteti, UBT dhe FES do ta zgjerojnë bashkëpunimin, për të ndërtuar një projekt më të madh atë të South Eastern Europe Citizens' Diplomacy Program, që do të shërbejë si mekanizëm kyç për të rritur bashkëpunimin mes të rinjve dhe qytetarëve në Evropën Juglindore.

Me rastin e përfundimit të Akademisë, organizatorët duan të falënderojnë edhe mediat e pranishme në aktivitet, të cilat kanë mbuluar këtë ngjarje, duke i dhënë vlerë të shtuar këtij bashkëpunimi. Njëherit në ditët në vazhdim do të përgatitet edhe një material më i plotë lidhur me gjithë Akademinë verore ndërkombëtare „Citizens' Diplomacy“, e cila do të shpërndahet për gjithë të interesuarit.

Konferenca Verore e Shkencave Kompjuterike dhe Menaxhimi të Mekatronikës solli punime shumë profesionale

Në kampusin e UBT-së, në dy sesione paralele, është organizuar Konferenca Verore e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë dhe Fakultetit Menaxhim i Mekatronikës në UBT. Në këtë konferencë verore një ditore, që është bërë traditë e UBT-së, u prezantuan projektet më të mira të dy fakulteteve, më shumë se 40 projekte, në të cilat ishin të angazhuar rreth 120 studentë. Projektet e prezantuara ishin të punuara shumë mirë profesionalisht. Disa prej tyre, që u vlerësuan për kreativitet dhe inovacion ishin: “FitnesApp”, e implementuar nga studentët Diorit Bajrami, Vlonjat Gashi, At dhe Mahmuti e Ardit Azemi; “Autoshkolla” e implementuar nga studentët Arianit Berisha, Muhamet Behrami e Gëzim Rexhepi; “ISP - AMA Speed” e implementuar nga studentet Arbresha Sejfiqaj, Argenita Selmanaj e Majlindë Jahiu; “Roboti Kamerier”, e implementuar nga studentët - Labinot Kumnova, Uran Çabra, Afrim Hajradini, Florian Piraj e Qëndrim Haxhijaj.

Në ceremoninë përmbyllëse u bë dorëzimi i certifikatave të studentëve pjesëmarrës të konferencës verore.



U ZHVILLUA AKADEMIA VERORE 2015 NË FAKULTETIN E SISTEMEVE TË INFORMACIONIT NË UBT

SISTEMET E INFORMACIONIT SJELLIN NJOHURITË REJA



27 korrik. – Në fakultetin e Sistemeve të Informacionit (SI) në UBT u mbajt Akademia Verore SI 2015 ku morën pjesë studentë nga ky fakultet dhe studentë tjerë të interesuar.

Akademikë verore e hapi dekan, Dr. Ylber Limani, duke i përshëndetur studentët pjesëmarrës dhe profesorët si dhe folësit mysafirë.

Sistemet e Informacionit janë bërë nevojë e secilit biznes, e secilit institucion, e secilit komunitet, e secilit vend, duke marrë parasysh se vet informacioni është bërë nyja më e rëndësishme e rrjetit global të komunikimit në biznes dhe në politikë. Kjo na bën të ndihemi mirë që ne jemi pjesë e botës së sistemeve të informacionit, pjesë e së ardhmes, por edhe na obligon që të jemi

njohës të denjë të koncepteve, të dukurive dhe të rrjedhave të përgjithshme nga bota e SI, theksoi dekan Limani. Kjo akademi, shtoi ai, ndër të tjera, kishte për qëllim prurjen e njohurive të reja, njohjen me konceptet më bashkëkohore dhe më të ndryshme nga bota e menaxhimit të sistemeve të informacionit.

Në këtë akademi u diskutuan tema nga fushat aktuale të SI, siç

janë GIS (Geo-Information Systems), E-Health, Siguria e të dhënave, Siguria Kibernetike, Modellet e Ndërmarrjes në SI, Standardet e Sigurisë në SI, etj. Të gjitha këto tema paraqesin format dhe modellet e kërkesave të reja nga bota e biznesit, e ekonomisë, e arsimit, e sigurisë, e shëndetësisë dhe e politikës. Prandaj, pasurimi i studentit me njohjen e definimeve, të praktikave dhe të aplikacioneve

të ndryshme nga fusha e fushat e ndryshme të SI, ishte synim strategjik dhe arritje kulminante e akademisë. Ligjëruesit ishin ekspertë nga fushat e ndryshme të SI, nga Industritë dhe Institucionet e ndryshme si dhe profesorë të Fakultetit. Nuk mungoi edhe interaktiviteti i studentëve duke prezantuar projekte të ndryshme aplikative nga fusha të ndryshme të SI.

JONIDA XHEMA: KONFERENCA VERORE STUDENTORE MBE 2015 MOTIVACION PËR TË ARDHMEN TONË AKADEMIKE E SHKENCORE

27 korrik. - Me përfundimin e vitit akademik, në UBT nuk bie ritmi i punës dhe aktiviteteve të mësimdhënësve dhe të studentëve. Akademikë verore, konferencat verore të studentëve, ekspozitat e aktivitete të tjera që zhvillohen u shërbejnë studentëve për të marrë dije e njohuri të reja. Për të më shumë, edhe për të paraqitur idetë e tyre risistare, që në UBT gjithmonë mirëpritën dhe përkrahen.

Studentja e vitit të dytë në Fakultetin e Menaxhmentit, Biznesit dhe Ekonomisë në UBT, Jonida Xhema ka qenë pjesëmarrëse aktive në këto aktivitete. Ajo paraqet përshtypjet e saj nga Konferenca Verore Studentore MBE 2015.

Ka shumë gjëra për të thënë nëse flitet për Konferencën Studentore Verore në MBE 2015. Edhe pse kjo ngjarje është organizuar për herë të parë në këtë format në MBE, rezultati ishte shumë i kënaqshëm. Konferenca ka qenë e mbushur me njerëz shumë punëtorë dhe kreativë. Ishte një ngjarje që do të mbahet mend, duke filluar nga studentët pjesëmarrës që kishin qëndrim sikur prezantonin me dekada të

tëra, e duke vazhduar tek stafi vlerësues i profesorëve, të cilët vlerësonin anë të pozitive dhe negative të çdo prezantimi me qëllim që pjesëmarrësit të përmirësoheshin vazhdimisht. Pjesëmarrësit kanë mësuar shumë nga folësit, temat e ndryshme si dhe nga stafi vlerësues duke ndarë eksperiencat të ndryshme së bashku. Ka qenë një ngjarje të cilën nuk e kam imagjinuar më parë si dhe jam mjaft e lumtur që kam qenë pjesëmarrëse dhe njëkohësisht organizatore e kësaj Konferencë Studentore Verore.

Së pari, ajo që më pëlqeu më shumë nga kjo ngjarje ishte se prezantimet ishin të shtrira në lëmi të ndryshme. Kishte lidhshmëri në mes të Biznesit, Menaxhmentit, Ekonomisë, Operacioneve, Marketingut, Të folurit Publik dhe Afarist, si dhe fusha të tjera të lidhura me dije dhe me inovacion. Kjo u mundësoi shumë studentëve njohuri të reja në fusha të cilat disa ende nuk i kishin studiuar. Po ashtu kjo shtrirje e gjerë e temave bëri që pjesëmarrësit të jenë mjaft të interesuar për atë që flitej. Diçka shumë e rëndësishme që studen-

tët absorbuan ishte se duhet të kemi njohuri të përgjithshme në lëmi të ndryshme të cilat do të na ndihmojnë në drejtimin të cilin e kemi zgjedhur. Pra, kishte aq shumë pasuri të informacionit që na rrethonte në këtë Konferencë Verore me anë të një bashkëpunimi të shkëlqyer dhe studimit që ndodhte në një orë të thjeshtë.

Së dyti, diçka shumë e rëndësishme nga kjo Konferencë Verore ishte që studentët pjesëmarrës ishin të gjeneratave të ndryshme, gjë që mundësoi që secili të transmetojë përvojën e tij në mënyrë të ndryshme. Duke marrë parasysh profilet e ndryshme të studentëve, mund të themi se u krijuan rrjete të reja të shoqërisë, u zhvilluan aftësitë në komunikim, si dhe përmirësua aftësitë ndërpersonale. Përvojat e ndryshme të shprehura me anë të komunikimit mundësuan që të krijohet një atmosferë e familjarizuar, e kjo bëri që studentët të prezantonin lirshëm. Pjesëmarrësit dukej sikur kishin shumë kohë që prezantonin por në fakt kjo ishte Konferenca e parë Verore

Studentore. Pra, kishte shumë informacion për t'u pranuar nga studentët dhe vlerësuar nga profesorët, por profilet dhe përvojat e ndryshme të shprehura në një mënyrë të thjeshtë e bëri këtë Konferencë Verore një ambient mjaft të familjarizuar.

Së treti, nuk duhet harruar stafin vlerësues të profesorëve të cilët vazhdimisht procesonin informatat që studentët prezantonin duke u munduar që vlerësimet të jenë në një mënyrë sa më efektive. Vlerësimet fillonin nga anë të pozitive të prezantimeve e duke vazhduar tek sugjerimet e ndryshme që mundësonin që pjesëmarrësit të përmirësoheshin në të ardhmen. Po ashtu nuk duhet harruar se profesorët kishin kriteret e vlerësimit të cilat i ndiqnin vazhdimisht në mënyrë që vlerësimet të ishin sa më të drejta dhe më të sakta. Diçka e rëndësishme ishte mënyra se si stafi vlerësues dëgjonte dhe analizonte çdo detaj të prezantimeve. Gjithashtu mënyra se si sugjerimet ofroeshin në një mënyrë profesionale dhe njëkohësisht shumë të afërt, bëri që qëllimi i vlerësimeve si dhe këshillat e ndryshme të kup-

tohen dhe pranohen mjaft mirë nga studentët. Kishte shumë informacion për t'u procesuar por stafi vlerësues kishin një qasje mjaft të afërt me studentët që bëri që kjo Konferencë Verore të përfundojë me shumë efikasitet si dhe të transmetojë mesazhin e saj në mënyrë më të mirë të mundshme. Përfundimisht, mund të themi se Konferenca Studentore Verore në MBE 2015 kishte për qëllim krijimin, procesimin si dhe vlerësimin e informacionit duke e kthyer atë në dije për të gjithë pjesëmarrësit. Ishte një ngjarje që përfshinte tema nga fusha të ndryshme, studentë me profile të ndryshme si dhe një staf vlerësues mjaft profesional që bëri që mesazhi i kësaj konference të transmetohet tek të gjithë studentët pjesëmarrës. Pra, këtë Konferencë Verore e rrethonin informacioni mjaft i pasur, bashkëpunimi i studentëve me profesorët si dhe krijimi i rrjeteve të reja të shoqërisë që bënë procesimin dhe vlerësimin e informacionit duke e kthyer atë në dije e cila ishte gjëja më e rëndësishme e kësaj Konferencë Verore.

DISKUTOHET STRATEGJIA E TURIZMIT NË KOSOVË

KOSOVA ËSHTË INTERESANTE PËR TURISTËT E HUAJ, DUHET STRATEGJI ADEKUATE PËR TËRHEQJEN E TYRE

Drejtori i kompanisë “Eurokoha”, Remzi Ejupi, kritikoi qasjen ndaj turizmit, por edhe ndaj zhvillimit ekonomik, duke thënë se në këtë drejtim problemi qëndron në mungesën e vizionit, konceptit, ideve e strategjive

3 dhjetor 2015. - Organizuar nga UBT dhe Shoqata Austriake-Kosovare, në kampusin inovativ të UBT-së, sot i zhvilloi punimet konferenca “Dita Austriake-Kosovare e Strategjisë së Turizmit 2015”, në të cilën, ekspertët të turizmit paraqitën gjendjen e tanishme të turizmit në vendin tonë dhe strategjinë për vitin 2016.

Larissa Olenicoff është nga Kalifornia dhe është koordinatore në qendrën e turizmit, ekonomisë dhe inovacionit në UBT. Ajo ka blogje të ndryshme dhe viziton vendet e Kosovës dhe të rajonit, duke i postuar fotot nëpër rrjetet sociale, që njerëzit anembanë botës të kuptojnë se çfarë vendesh ka në Kosovë.

Ajo vuri theksin te përgatitja profesionale e njerëzve që merren me turizëm. «Nuk mund të kemi turizëm pa njerëz të kualifikuar në këto fusha. Kërkesa ime sa i përket zhvillimit të ekonomisë do të ishte që TVSH-ja të zbritet në 10 për qind», tha ajo, duke u shprehur se UBT ka ndihmuar dhe mund të ndihmojë shumë në strategjinë për turizmin.

“Kam shumë dashuri për Kosovën, sepse ka shumë gjëra të

mira, madje as diaspora nuk i di ato vende”, tha ajo, duke shtuar se turizmi është produkt dhe duhet të tregtohet në mënyrë të duhur.

Arkitektja Florina Jerliu, në paraqitjen e saj në konferencë, e vuri theksin te mundësitë e mëdha që ofron qyteti i Prishtinës në fushën e turizmit.

Ajo tha se Prishtina është kryeqyteti dhe është atraktiv, ndaj kushdo që vjen në Kosovë e zgjedh pikërisht Prishtinën për ta vizituar.

Ajo veçoi qendrën e qytetit, por edhe periferinë dhe vendbanimet përreth, ku ka gjurmë të lashtësisë, miniera, objekte të vjetra fetare, shtëpi të vjetra tradicionale dhe shumëçka për t'u parë e eksploruar.

Zonja Jerliu gjithashtu dha një varg idesh për mënyrën se si duhet të mbrohet trashëgimia dhe të gjitha objektet atraktive, që t'u prezantohen vizitorëve të huaj.

Drejtori i kompanisë “Eurokoha”, Remzi Ejupi, kritikoi qasjen ndaj turizmit, por edhe ndaj zhvillimit ekonomik, duke thënë se në këtë drejtim problemi qëndron në mungesën e vizionit, konceptit, ideve e strategjive.



Ai tha se, sipas statistikave, ka një interesim të të huajve për ta vizituar vendin tonë, por ata më shumë vijnë për biznes sesa për turizëm dhe mysafirët më të shpeshtë janë nga Shqipëria, Gjermania, Italia e vende të tjera.

Z.Ejupi tërhoqi një paralele të interesimit të turistëve të huaj për vizitë në Maqedoni, një vend që, gjithashtu si Kosova, nuk ka dalje në det. Duke pasur një strategji tjetër të qasjes ndaj turistëve, ai tha se në Maqedoni, në periudhën janar-korrik, 500 mijë të huaj

kanë qëndruar nëpër objektet hoteliere, ndërsa në Kosovë për një vit nuk realizohen më shumë se 100 mijë qëndrime.

Ai tha se Kosova duhet t'i shfrytëzojë mundësitë që ofron turizmi malor, ku ka shumë qendra në Kosovë që mund të jenë shumë atraktive për të huajt.

Günther Dress, ekspert i çështjeve të turizmit nga Gjermania, vlerësoi ndër të tjera se nuk është me rëndësi vetëm të kesh vende e monumente interesante, por është shumë e rëndësishme që

ato të ruhen dhe të jenë atraktive për turistët e huaj.

Ai përcolli përvojat e tij nga vizitat në Kosovë, por edhe në vendet e rajonit, dhe theksoi elementin e njerëzve mikpritës, që janë një nga elementet kryesore të zhvillimit të turizmit.

Z.Dress gjithashtu disa lloje të turizmit që mund të jenë joshëse për të huaj, si turizmi kulturor, turizmi malor, çiklizmi, ngjarjet e ndryshme atraktive e të tjera.

ALBINA ZENELI

NË UBT I ZHVILLOI PUNIMET KONFERENCA “DITA AUSTRIAKE-KOSOVARE E ARKITEKTURËS 2015”

PO TË REALIZOHESHIN PLANET, NË PRISHTINË DO TË KISHTE HAPËSIRË PËR 2.5 MILIONË BANORË

Duke kritikuar mënyrën e zgjerimit të kryeqytetit, Liburn Aliu mori një shembull të një analize që do të publikohet së shpejti, e cila tregon se po të realizohej si duhet Plani zhvillimor urban i qytetit, në Prishtinë do të kishte hapësirë dhe kushte komode banimi për 2.5 milionë banorë

4 nëntor 2015. - Në vargun e konferencave që trajtojnë tema me interes për studentët, mësimdhënësit, ekspertët, institucionet lokale dhe qendrore të Republikës së Kosovës dhe institucionet dhe universitetet nga Austria dhe shtete të ndryshme të Evropës, UBT dhe Shoqata Austriake-Kosovare organizuan konferencën mbi Arkitekturën në Kosovë. Në konferencë morën pjesë përfaqësues nga Qeveria e Republikës së Kosovës, përfaqësues të pushtetit lokal, të asociacioneve profesionale të arkitekturës nga vendi dhe rajoni, si dhe ekspertë të arkitekturës dhe studentë e të interesuar të tjerë. Drejtori i Urbanizmit në komunën e Prishtinës, Liburn Aliu trajtoi një varg çështjesh që ndërlidhen me arkitekturën dhe urbanizmin në kryeqytet. Aliu tha se Prishtina ka qenë qytet i cili i ka

paraprirë ndryshimeve dhe vendi i një dinamike të madhe, rinia e së cilës ka qenë përherë ajo që nuk është pajtuar me realitetin që e ka rrethuar, që ka qenë i hidhur, prandaj e ka ndryshuar atë.

Prishtina do të jetë vend ku iniciohen dhe bëhen ndryshimet, por ndryshimet për të cilat po flasim sot kanë të bëjnë me një aspekt tjetër, aspektin urban, tha Aliu, duke shtuar se sfida sot në qytetin e Prishtinës është mënyra se si është zhvilluar dhe si është zgjeruar Prishtina. Zhvillimi dhe zgjerimi i saj sidomos në vitet e pasluftës është mënyrë e cila ka qenë në favor të profitit, jo profitit qytetar, por profitit të kompanive të ndryshme, të bizneseve të ndryshme, të biznesmenëve të ndryshëm, tregtarëve të tokave... Profiti i tyre ka qenë në plan të parë e jo interesi qytetar. Duke kritikuar mënyrën

e zgjerimit të kryeqytetit, z.Aliu mori një shembull të një analize që do të publikohet së shpejti, e cila tregon se po të realizohej si duhet Plani zhvillimor urban i qytetit, në Prishtinë do të kishte hapësirë dhe kushte komode banimi për 2.5 milionë banorë. Por, ai tha se kanë ndodhur një varg veprimesh jo të mira, përfshirë transaksionet e mëdha të tokave, privatizimin e tyre, me fokus interesat e pronarëve e jo interesat e qytetarëve.

Në këtë kontekst, ai përmendi se një nga problemet kryesore me të cilin ballafaqohet Prishtina është shpronësimi i tokave private për të ndërtuar rrugë, që të shumtën e herëve kushton dhjetëra herë më shumë sesa vetë vlera në para e rrugës apo projekteve të tjera që ndërtohen për të mirën e qytetarëve.

Për pasojë, po kështu, do të ketë shumë më pak hapësira për qytetarët e shumë më pak gjelbërim, tha ai. Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi përkujtoi se shkolla e parë e arkitekturës në UBT është organizuar në bashkëpunim me partnerët nga Austria

dhe ka qenë një kontribut mjaft i madh. Bashkë me austriakët në Fakultetin e Planifikimit Urban për herë të parë pas luftës kemi organizuar studimet master në planifikimin urban në Kosovë, fushë në të cilën është dashur të punohet shumë, por kjo ka qenë e mundur me një bashkëpunim me profesorët austriakë.

Ai theksoi se në fushën e arkitekturës dhe të planifikimit urban në Prishtinë dhe në gjithë vendin ka shumë për të bërë.

Z.Hajrizi gjithashtu përmendi edhe çështje të tjera, siç janë objektet e trashëgimisë kulturore, inventarizimi dhe digjitalizimi i tyre, fushë në të cilën shumë gjëra janë të hapura dhe nuk janë finalizuar. Ai tha se edhe çështja e kompetencave është një problem në vendin tonë, ku njerëz jokompetentë marrin rolin e profesionistëve në fushat ku nuk janë të tillë. Në vijim, zonja Caroline Jaeger Klein bëri një prezantim për Trashëgiminë Kulturore të Kosovës dhe përpjekjet e saj dhe të studentëve për të ndihmuar në ruajtjen dhe propagimin e kësaj trashëgimie.


Dekani i Arkitekturës në UBT, dr. Lulzim Beqiri elaboroi rolin e universiteteve në krijimin dhe edukimin e arkitektëve të rinj, duke theksuar se profesorët dhe arkitektët e certifikuar kanë edhe më shumë përgjegjësi për të përcjellë gjithë dijen komplekse të kësaj fushe te studentët.

Ai tha se në gjendjen aktuale në vend, në një shoqëri në tranzicion edhe puna e arkitektëve, sikur edhe shumë profesionistëve të tjerë, has në barriera dhe vështirësi të mëdha.

Në konferencë ka folur edhe Eljesa Surdulli, kryetar i Asociacionit të Arkitekturës së Kosovës, i cili elaboroi punën e këtij asociacioni, aktivitetet në planin vendor dhe ndërkombëtar.

Në konferencë u paraqitën edhe folës të tjerë, që trajtuan aspekte të ndryshme të temës së shtruar, ndërsa u zhvillua edhe një debat i frytshëm.

Konferenca zgjoi interesim shumë të madh të studentëve të Arkitekturës në UBT dhe studentëve e të interesuarve të tjerë.



Akademia Ekzekutive për Zhvillim Profesional në kuadër të Kolegjit UBT-së ka si qëllim ofrimin e mundësive tek studentët dhe personat e tjerë për ngritjen e kapaciteteve të tyre profesionale në fushat e Teknologjisë Informative dhe të Komunikimit, Menaxhimit të Projekteve, Burimeve e njerëzore etj. Akademia për Zhvillim Profesional është qendra më e avancuar për ofrimin e trajnimeve profesionale dhe e pajisur me të gjitha pajisjet e nevojshme për realizimin e trajnimeve dhe certifikimeve me sukses. Laboratorët e Teknologjisë Informative në kuadër të Akademisë ofrojnë mundësinë e kryerjes së detyrave praktike me pajisjet e fundit dhe më bashkëkohore të Teknologjisë Informative dhe të komunikimit. Sallat e trajnimeve janë të pajisuara me të gjitha elementet që mundësojnë organizimin e trajnimeve atraktive të kuptueshme si dhe mundësinë e diskutimeve të përbashkëta.

Teknologji Informative dhe Komunikim CISCO Networking Academy

- IT Essentials: PC Hardware and Software
- CCNA 1: Introduction to Networks
- CCNA 2: Routing and Switching Essentials
- CCNA 3: Scaling Networks
- CCNA 4: Connecting Networks
- Cisco: Introduction to Cyber Security

European Computer Driving License (ECDL)

Software Engineering

Programing Languages

- Visual Basic, C#, MVC
- Web Programing (PHP and MySQL)
- Database Programming (MS SQL, Oracle)

Web Development Trainings

- Wordpress Training
- Joomla Training
- E-commerce and SEO Development
- Prestashop, Drupal etj
- HTML5 and CSS
- C# and MS SQL
- Mobile APP Development

Microsoft Windows Server 2012

- Installing and Configuring Win Server 2012
- Active Directory and Domain Controller Win Server 2012
- Microsoft Exchange Server 2012

Computing Simulation

Computer Design and Animation

Customer Relationship Management (CRM)

Enterprise Resource Planning (ERP)

Models, Optimization and Simulation

Menaxhim

- Menaxhimi i Burimeve Njerëzore
- Administrim Biznesi
- Menaxhimi i Kualitetit
- (ISO 9001:2000)
- Menaxhimi Strategjik
- Ngritja (Themelimi) e ndërmarrjes
- Menaxhimi i Produktit
- Ndërtimi i Brendit
- Inxhinieringu Industrial
- Menaxhimi i Projekteve
- Menaxhimi i Proceeseve
- Menaxhimi i Zinxhirit të Furnizimit
- E-Biznes
- Transport dhe Logjistikë
- Sisteme Fleksibile të Prodhimit
- Prodhimi mbështetës

- Prodhim, Planifikim dhe Skedulim
- Menaxhimi i Ndryshimeve
- Menaxhimi i Rrezikut
- Menaxhimi i Ankesave
- Menaxhimi i Kohës
- Ndërmarrësi dhe Biznis plan
- Menaxhimi i Sistemeve Informative
- Prokurimi
- Menaxhimi i Konfliktit
- Përgjegjësia Sociale e Korporatës
- Menaxhimi i Ngjarjeve
- Sistemet HACCP
- Fuzionimi dhe Bashkimi
- Planifikimi i resurseve të manufakturës
- Planifikimi i Materialeve të Kërkueshme(MRP)
- Shkathtësi negociimi
- Menaxhmenti i Logjistikës

Financa

- Raportim Financiar i Korporatës
- Tregtia e Jashtme/Doganat
- Analiza e Kostove
- Kontabiliteti dhe Menaxhimi Financave
- Vendimmarrja Financiare
- Institucionet Financiar edhe Tregjet

Marketing dhe Shitje:

- Marketing dhe Shitje
- Planifikimi i Burimeve të Shpërndarjes
- Mjetet e IT për Marketing
- Menaxhimi i Lojalitetit
- Merchandising
- Modeli i Optimizimit të çmimeve
- Zhvillimi i Produkteve dhe Brendimi
- Menaxhimi i Shitjes
- Shitja Efikase dhe Teknikat e Shitjes
- Menaxhimi i Ankesave të Konsumatorëve

Shkathtësi kryesore të këshillimit:

- Menaxhimi Personal
- Komunikimi
- Punë te suksesshme grupore
- Grupimi dhe Krijimi i Grupeve
- Periodizimi
- Kodi i Etikës së Këshilltarit
- Zgjidhja e Konfliktit
- Negocimi i Kontratës
- Menaxhimi i Marrëdhënieve me Klientë
- Shërbime Këshillimi për Marketing
- Menaxhimi i Proceeseve Këshilluese

Gjuhët e huaja:

- Gjuhë angleze
- Gjuhë gjermane
- Gjuhë frënge

Vërejtje e rëndësishme: Gjuhët e huaja, varësisht prej kërkesave të grupit në fokus, mund të mbahen edhe në bazë të kërkesave specifike të grupit për mësimin e terminologjive të ndryshme profesionale për gjuhët përkatëse.

Drejtesia, Shkenca Politike dhe Diplomaci:

- Teknika Negocimi
- Zgjidhja e Konfliktëve
- Aqul Comunnitere e Bashkimit Evropian
- Institucionet e Bashkimit Evropian
- Komunikimi Masiv
- Shkathtësi Diplomatieke
- State Protocol

Mekatronikë dhe Teknologji të tjera

- Mekatronikë(Pneumatikë, Elektro - Pneumatikë, E-Teknika/Programmable Logic Controllers (PLC), Hidraulikë, Elektro-Hidraulikë, Sistemet e Kontrollit Hidraulik, Sensorët
- Design Assembly & Mirëmbajtja e Sistemeve Mekatronike
- CAX-Teknologjitë(CAD/CAM,
- CAQ,CAP dhe CA të tjera)
- CNC - Teknikat
- Robotikë
- Teknikat e Punës/Organizimi Punës
- Mbrojtja e Mjedisit

Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor

- Menaxhimi i Projekteve Konstruktuese
- Projektimme AUTOCAD dhe ARCHICAD
- Materiale Konstruktuese dhe Kontroll Kualiteti
- Menaxhim Urban
- Certifikim për Kualitet
- Marketing në Arkitekturë

Akademia Profesional e Kolegjit UBT trajnimet i organizon në qendra te ndryshme të Kosovës si në: Prishtinë, Kampusi Inovativ në Lipjan, Prizren dhe Ferizaj.

Trajnimet profesionale në disiplina e lart cekura ofrohen në periudha të ndryshme, në bazë të kërkesës së individëve, institucioneve, kompanive dhe korporatave të ndryshme. Një grup profesionistësh vendor dhe ndërkombëtarë, me përgatitje akademike superior dhe përvojë të suksesshme, janë në dispozicionin tuaj për t’ju ofruar një listë të gjerë trajnimesh për një karrierë profesionale të avancuar dhe për sukses të padiskutueshëm të ndërmarrjes apo institucionit tuaj.

Për informata shtesë ne lidhur me trajnimet ju lutem na kontaktoni në:

Akademia Ekzekutive për Zhvillim Profesional
Adresa: Lagjia KALABRIA p.n. 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +381 38 541 400 ext. 111
Email: ictacademy@ubt-uni.net
Website: http://academy.ubt-uni.net

KONFERENCA NDËRKOMBËTARE PËR TURIZMIN

KOSOVA KA POTENCIAL TË MJAFTUESHËM PËR ZHVILLIMIN E TURIZMIT

“Është hartuar Plani zhvillimor në sektorin e turizmit i cili është në fazën finale. Synimi ynë është që deri në vitin 2020, sektori i turizmit të marrë pjesë në GDP me 7-8 %”, tha ministria Hykmete Bajrami, duke shtuar se është filluar me rishikimin e legjislacionit në fuqi, në mënyrë që të krijohet një ambient më i përshtatshëm për sektorin privat



16 shtator - Në vazhdhën e konferencave ndërkombëtare të organizuara në UBT, sot në këtë institucion i ka nisur punimet konferenca “Ditët Austriake-Kosovare të Turizmit 2015”, e organizuar nga Shoqata Austriake-Kosovare, me mbështetjen e projektit PPSE, Odës Ekonomike të Austrisë dhe UBT-së.

Qëllimi i konferencës është promovimi i sektorit të turizmit në Kosovë dhe ofrimi i modelit dhe përvojave austriake në fushën e turizmit, si ndihmesë për zhvillimin ekonomik të Kosovës në rrugën e saj drejt Bashkimit Evropian, si dhe intensifikimi i bashkëpunimit midis Austrisë e Kosovës në fushën e turizmit dhe promovimin e zhvillimit ekonomik në këtë sektor.

Drejtues i konferencës, Gunther Fehlinger, në hapje të punimeve, theksoi rëndësinë që kanë diskutimet në temën e turizmit, duke pasur parasysh potencialin e shtetit të Kosovës në këtë fushë, e cila nuk është e zhvilluar sa duhet dhe ka nevojë për përkrahje nga institucionet, qofshin ato publike apo private.

Rектори UBT-së, prof.dr.Edmond Hajrizi theksoi se UBT, si një institucion i arsimimit të lartë, po bëhet bartës edhe i promovimit të turizmit në Kosovë, prandaj jemi shumë të privilegjuar që po marrim pjesë në këtë aktivitet që për bazë e ka promovimin e vendeve të bukura, të cilat duhet të frekuentohen jo vetëm nga kosovarët por edhe nga qytetarët e vendeve të rajonit e më gjerë.

Kosova është aktualisht e njohur në skenën ndërkombëtar për turizëm natyror, me aktivitete në natyrë - Majat e Ballkanit, në rajonin e Pejës ose në Bjeshkët e Sharrit, trashëgiminë kulturore, monumente fetare të fesë myslimane, katolike dhe ortodokse, si dhe e njohur për kulturën, diversitetin etnik dhe ngjarjet kulturore si Dokufest-i, shtoi ministria Bajrami. Ministria Bajrami, po ashtu theksoi se Qeveria e Kosovës po punon në ngritjen e kapaciteteve njerëzore në fushën e turizmit, në mënyrë që të vazhdohet me ofrimin e shërbimeve cilësore, si dhe hartimin e politikave për promovimin e turizmit vendor.

“Është hartuar Plani zhvillimor në sektorin e turizmit i cili është në fazën finale. Synimi ynë është që deri në vitin 2020, sektori i turizmit të marrë pjesë në GDP me 7-8 %”, tha ministria Hykmete Bajrami, duke shtuar se është filluar me rishikimin e legjislacionit në fuqi, në mënyrë që të krijohet

Ministria po ashtu theksoi se Qeveria e Kosovës e konsideron turizmin si një nga mundësitë për zhvillimin e vendit, i cili ofron kontribut të rëndësishëm në rritjen ekonomike, krijimin e vendeve të punës, zhvillimin rajonal dhe lokal, përmirëson standardin jetësor të qytetarëve të Kosovës dhe integron natyrën, kulturën, historinë, gastronominë dhe mikpritjen tradicionale në mënyrë kreative të bazuar në përvojën ekonomike dhe mënyrat inovative.

“Sipas të dhënave statistikore të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, janë rreth 20,000 persona të punësuar në sektorin e akomodimit dhe ushqimit, që përfaqësojnë mbi 5% të të gjithë personave të punësuar në Kosovë”, tha ministria Bajrami.

Ministria e MTI-së po ashtu ka thënë se turizmi, pa mëdyshje është një sektor i rëndësishëm në Kosovë, i cili jo vetëm krijon shumë shpejtë vende të punës, por është gjithashtu një mundësi për përmirësimin e imazhit të Kosovës si shteti më i ri në Evropë, imazh i ndryshëm nga ai i cili paraqitet në media dhe që korrespondon në mënyrë autentike me karakteristikat specifike dhe asetet unike të Kosovës.

Kosova është aktualisht e njohur në skenën ndërkombëtar për turizëm natyror, me aktivitete në natyrë - Majat e Ballkanit, në rajonin e Pejës ose në Bjeshkët e Sharrit, trashëgiminë kulturore, monumente fetare të fesë myslimane, katolike dhe ortodokse, si dhe e njohur për kulturën, diversitetin etnik dhe ngjarjet kulturore si Dokufest-i, shtoi ministria Bajrami. Ministria Bajrami, po ashtu theksoi se Qeveria e Kosovës po punon në ngritjen e kapaciteteve njerëzore në fushën e turizmit, në mënyrë që të vazhdohet me ofrimin e shërbimeve cilësore, si dhe hartimin e politikave për promovimin e turizmit vendor.

“Është hartuar Plani zhvillimor në sektorin e turizmit i cili është në fazën finale. Synimi ynë është që deri në vitin 2020, sektori i turizmit të marrë pjesë në GDP me 7-8 %”, tha ministria Hykmete Bajrami, duke shtuar se është filluar me rishikimin e legjislacionit në fuqi, në mënyrë që të krijohet

një ambient më i përshtatshëm për sektorin privat.

Ministria e MTI-së, me këtë rast i ka bërë thirrje operatorëve turistik kosovar që të orientojnë lëvizjet turistike dhe krijimin e ofertave, në prurjen e turistëve nga vendet tjera në Kosovë si dhe ofrimin e paketave brenda Kosovës për vendorët, dhe të mos foku-sohen vetëm në ofertat për vizita jashtë vendit.

Ndërsa, Baki Hoti, drejtor i Shoqatës së Turizmit Alternativ të Kosovës u shpreh i gatshëm për bashkëpunim me ndonjë organizatë të promovimit të turizmit nëpër rajon. Turizmi është pasurimi i çdo shteti, dhe ne duhet t'i bashkojmë të gjithë akterët e turizmit në mënyrë që promovimi të ketë sukses, theksoi z. Hoti.

Çështje tjetër që z.Hoti konsideron të rëndësishme është edhe stafi profesional që do të merret me këto punë. Ai tha gjithashtu se duhet të kihet parasysh disa çështje, si definimi i vendeve që janë atraktive, vlerësimi për profesionalitetin e stafit, ciceronët profesionistë që do të orientojnë turistët e shumë çështje të tjera.

Në turizëm duhet punuar bashkërisht në mënyrë që të kemi sukses, tha ai.

Në vazhdim Sigrig Mayer e konsideroi të rëndësishëm promovimin e produkteve vendore, të reja e atraktive, si dhe vendeve turistike.

“Kosova ka shumë vende turistike që të gjithë do të kishin pasur dëshirë t'i vizitojnë, siç janë Graçanica, Malet e Sharrit, Boga në Pejë, Kalaja e Prizrenit, Gjakova, por edhe në sektorin kulturor është i njohur organizimi i Dokufest-it në Prizren”, tha Sigrig Mayer.

Ekrem Hyseni nga GIZ theksoi se turizmi është si një shtyllë kryesore që lidh shumë sektorë të tjerë, duke filluar nga zhvillimi i bujqësisë, pjesën e blegtorisë, të hotelerisë e të transportit. Hyseni tha se turizmi është një akt kryesor që lidh shumë sektorë të tjerë, duke filluar nga zhvillimi i kucës për zhvillimin e shtetit. Ai tha se sektori i turizmit ndikon edhe në rritjen e punësimit, por tërhoqi vërejtjen se Kosovë ka mungesë të kuadrove në sektorët

e turizmit qoftë në atë të hotelerisë po edhe të agjencive turistike.

Visar Kelmendi, ekspert i turizmit në USAID dhe përfaqësues i projektit EMPOWER, një projekt 5-vjeçar i cili zhvillohet në pesë sektorë të ekonomisë së Kosovës, ku hyn edhe turizmi, tha se në kuadër të këtij projekti kanë bërë një analizë dhe kanë vendosur të punojmë në tri rrafshë, në rrafshin e zhvillimit të kapaciteteve njerëzore, në zhvillimin e infrastrukturës fizike si dhe në promovimin e produkteve të turizmit të Kosovës. Ai gjithashtu përmendi edhe pjesën e trajnimeve që po mbahen shumë shpesh, duke ndikuar kështu në ngritjen e kapacitetit në fushën e turizmit.

Kelmendi ndër të tjera theksoi se janë duke punuar në infrastrukturën fizike në bashkëpunim me Federatën e Bjeshkatarëve Alpine të Kosovës dhe gjatë këtyre ditëve janë duke zhvilluar shëtitje në Bjeshkët e Nemuna si dhe në Sharr. “Kemi zhvilluar rreth 90 km shëtitje në bjeshkë, sidomos në ato të Rugovës, tashmë filluam edhe në Sharr dhe ky është lajm i mirë për turizmin në atë pjesë”, tha Kelmendi.

Ndërsa Andreas Wormsev, menaxher i hotelit “Graçanica”, duke folur për veprimtarinë e hoteleve, bëri të ditur se hoteli “Graçanica” është i vetmi i këtij lloji në këtë zonë të Prishtinës që është i hapur për turistët. Ndërkohë, sipas tij, ajo çka mund të ndikojë në rritjen e numrit të turistëve në Kosovë, janë ngjarjet e ndryshme që tërhoqin edhe vëmendjen e turistëve të huaj.

“Organizimi i ngjarjeve me karakter ndërkombëtar siç është Dokufesti sjell edhe vizitorët të huaj dhe e gjithë kjo ndikon drejtpërdrejt pozitivisht në këtë sektor, mirëpo ngjarjet të tilla nuk organizohen shumë në Prishtinë për shkak të fondeve dhe kjo po ashtu po ndikon në numër të vogël të turistëve në këtë pjesë”, tha Wormsev.

Agron Gashi nga “Raiffeisen Bank” tha se të gjitha bankat në këtë drejtim janë duke u munduar të ecin në trend me digitalizimin dhe duke pasur parasysh këtë edhe turizmi global është në hap të drejtë me teknologjinë.

“Viti 2015 rezultoi me 40 për qind të transakcioneve të të hyrave që janë realizuar online në këtë sektor. Një hap i tillë si shembull po merret edhe nga turistët kosovarë”, tha Gashi.

Shkumbin Brestovci nga komuniteti i IT-ve, foli për rolin e teknologjisë informative në shërbim të akt kryesor që ndërlidh të gjitha pjesët e tjera dhe është një shtyllë kyçe për zhvillimin e shtetit. Ai tha se sektori i turizmit ndikon edhe në rritjen e punësimit, por tërhoqi vërejtjen se Kosovë ka mungesë të kuadrove në sektorët

në mënyrë që ajo të jetë më atraktive dhe më e gjithanshme.

Ndërkohë blogerja Larissa Aka, që ka bërë shumë vizita dhe hulumtime në Kosovë dhe që tashmë është vendosur të jetojë në shtetin tonë, theksoi se ka mungesë të informacioneve për njerëzit që duan ta vizitojnë Kosovën, apo ai informacion është i shpërndarë dhe i zorshëm për ta gjetur.

Ajo theksoi nevojën e një pune të përbashkët në sektorin e turizmit, në mënyrë që informatat për ofertën turistike të Kosovës të jenë në një vend, për shembull në një platformë elektronike.

Alban Rafuna, përfaqësues i ueb-faqes BeInKosovo.com, tha se qëllimi kryesor i tyre është të mbledhin informata sa më shumë që është e mundur për komunitetin ndërkombëtar.

“BeInKosovo.com beson se turizmi duhet të jetë një prioritet në Kosovë, klientët e ndërkombëtarët do ta vizitojnë shtetin tonë dhe pikërisht misioni kryesor i yni është të mbledhim informata për ndërkombëtarët, pra ata mund të shohin apo rezervojnë online hotelin”, tha Rafuna.

Skender Thaçi, promar i hotel “Magra”, vlerësoi se shteti i Kosovës duhet të kontribuojë për këtë sektor përmes granteve, të zhvillojë e të promovojë turizmin. Ai gjithashtu apeloj tek mediat që të promovojnë zonat turistike të Kosovës, sepse ka shumë pasuri natyrore. Thaçi bëri të ditur se ekzistojnë katër institucione publike dhe private në vend që merren me edukimin dhe menaxhimin e këtij sektori dhe duhet të përgatiten kuadro për përfaqësimin e turizmit në mënyrë të duhur.

Valbona Dushi, nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, tha se janë duke punuar që turizmi në Kosovë të jetë një departament në vete.

“Kemi marrëveshje të shumta me Shqipërinë, mirëpo vërtet është nevojë që turizmi të jetë sektor në vete”, u shpreh Dushi.

Baki Hoti, kryetar i shoqatës së Turizmit Alternativ, në një fjalë përmblylëse në konferencë, theksoi se për zhvillimin e turizmit duhet një bashkëpunim i të gjitha institucioneve, duke nisur nga Qeveria, ministritë përkatëse, drejtoritë e institucionet e tjera.

Ai gjithashtu theksoi bashkëpunimin ndërkufitar si një element që ndikon në zhvillimin e turizmit, duke qenë të përfshira në paketat turistike të gjitha vendet e rajonit bashkërisht, mes tyre edhe Kosova, për të bërë më atraktive ofertën turistike për turistët e huaj.

Konferenca ndërkombëtare “Ditët Austriake-Kosovare të Turizmit 2015” i zhvilloi punimet e ditës së dytë në hotelin “Magra” në Bogë të Rugovës.

JAVA E NDËRGJEGJËSIMIT TË PUBLIKUT PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE

NË KOSOVË MUNGON INFORMACIONI PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE

21 tetor 2015.- Në kuadër të Javës së ndërgjegjësimit të publikut për ndryshimet klimatike, sot në UBT u organizua ligjërata e hapur në temën “Ndryshimet Klimatike”, e cila ishte e orientuar në çështjen e ndryshimeve klimatike dhe NISMËS Globale për ndryshimet klimatike, e cila ka kohë që është duke u zhvilluar.

Ligjërata u organizua në bashkëpunim me Qendrën Rajonale të Mjedisit – REC, Zyra në Kosovë.

Në këtë temë, mjaft të ndjeshme dhe me interes edhe për vendin tonë, para studentëve dhe të interesuarve të tjerë folën Agron Bektashi dhe Ermira Ajeti nga Qendra Rajonale e Mjedisit, si dhe Halil Berisha, menaxher i mjedisit në “Sharcem”.

Agron Bektashi, duke bërë një prezantim rreth ndryshimeve klimatike, theksoi se në ditët e sotme askush nuk mund të thotë se ndryshimi klimatik nuk është problem i imi, ose diçka tjetër, sepse ky është një problem i të gjithëve.

Ai tha më tej se “Week” është organizatë ndërkombëtare e themeluar në vitin 1990 nga SHBA dhe nga Bashkimi Evropian, që selinë kryesore e ka në Budapest, e cila merret me problemet mjedisore por jo vetëm me mjedis por edhe me çështje ekonomike sociale.



“Në Kosovë punon në mënyrë të suksesshme tash e disa vite. Jemi partnerë me shumë universitete, me shoqëri civile dhe me gjithë ata që ia duan të mirën Kosovës. Sot është një kontribut modest i “Week-ut” një parahyrje e një konference të madhe botërore që do të mbahet në Paris”, theksoi ndër të tjera Bektashi, në hapje të ligjëratisë së mundësuar nga Ambasada e Gjermanisë dhe Ambasada e Francës në Kosovë.

Ndërsa Emira Ajeti tha në vazhdim se kjo është seria e katërt e ligjëratave në universitete të ndryshme, qëllimi i të cilave është

informimi dhe që sa më shumë të flasim për ndryshimet klimatike dhe pasojat që mund t’i kenë drejtpërdrejt në ekonominë e një vendi, konkretisht në Kosovë.

Ajo ftoi studentët që të bëhen vullnetarisht pjesë e punëtorëve, ku do të bëhet një trajnim pesëditor, në të cilën do të ketë edhe punë praktike dhe prezantime, përmes të cilave do të tregohet realiteti i ndryshimit të klimës dhe se çfarë ne mund të bëjmë rreth saj.

Prioriteti kryesor i Kosovës është zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik. Nuk mjafton vetëm zhvillimi ekonomik, por duhet të

keni qëndrueshmëri afatgjatë, që është një problem i gjithë Ballkanit. Fatkeqësisht 30.2 për qind e popullsisë janë të papunë në Kosovë por sipas disa sondazheve dhe informacioneve të reja më shumë se 60 për qind nuk janë të informuar rreth ndryshimeve të klimës dhe se çfarë ka ndodhur në botë dhe cilat janë ato iniciativat globale për ndryshime klimatike. Andaj, mund të konkludojmë së bashku me këtë se Kosovës i mungon vetëdija e publikut dhe informacioni se si ndryshimi i klimës do të ndikojë tek njerëzit, theksoi më tej ajo. Emira Ajeti tha në vazhdim se dy prej sektorëve më të rëndësishëm të ekonomisë janë bujqësia dhe pylltaria, por, në një vend si Kosova, në rast të reshjeve atmosferike, nuk jemi të gatshëm të përballemi me to.

Ajo shtoi se, për fat të keq, Kosova, si dhe gjithë Ballkani, është një vend plot me mohues të ndryshimeve klimatike, madje ka edhe nga ata të cilët hedhin dyshime mbi konsensusin shkencor se ekzistojnë ndryshime. Këto mite zakonisht adresohen prej vet të rinjve, andaj edhe një ndër qëllimet kryesore të këtij projekti është t’i angazhojmë të rinjtë, sepse të rinjtë janë ata të cilat janë më mendjehapur dhe janë të gatshëm për të

ndryshuar, pasi që më të vjetrit i përtojnë ndryshimeve.

Halil Berisha, menaxher i mjedisit në kompaninë “Sharcem”, që merret me prodhimin e çimentos, një industri e cila ka ndikim në ndryshimet klimatike, pasi foli për historikun e kësaj fabrike, që daton nga viti 1936, tha se pas privatizimit nga kompania multiglobale e prodhimit të çimentos “Titan”, kjo kompani ka filluar ndryshimet që efektin më të madh do ta kenë në mjedis.

Sipas Berishës, në këtë drejtim kompania “Sharcem” është e certifikuar sipas standardeve më të larta dhe më të avancuar ndërkombëtare, siç është ISO 14000, për standardizim dhe arritshmëri në aspekte mjedisore.

Ai tha se të gjithë parametra ndotës, që mund të shkaktohen nga kjo industri e çimentos, janë mirë të kontrolluar dhe mjaft mirë të monitoruar, si rezultat i investimeve që janë bërë në këtë fabrikë, ndërsa të gjitha substancat që konsiderohen të dëmshme për mjedisin janë të monitoruara në mënyrë të vazhdueshme.

Pas paraqitjeve të folësve në ligjërata, u zhvillua një debat me interes rreth kësaj teme.

BESART TROSHUPA/
SHERIFE SOKOLI

QENDRA PËR HULUMTIMIN E OPINIONIT E UBT-SË

U PREZANTUA HULUMTIMI MBI AFTËSITË E KËRKUARA NË FUSHËN E TIK-UT NË KOSOVË

24 korrik. - Qendra për Hulumtimin e Opinionit, që vepron në kuadër të UBT-së, ka prezantuar sot rezultatet e hulumtimit “Aftësitë e kërkuara në fushën e TIK-ut në Kosovë”.

Përfaqësues nga Ambasada e Norvegjisë në Kosovë, përfaqësues nga institucionet e vendit dhe përfaqësues nga kompanitë të ndryshme nga fusha e teknologjisë informative dhe mysafirë të tjerë përcollën rezultatet e hulumtimit, qëllimi kryesor i të cilit është hulumtimi i aftësive të kërkuara në fushën e TIK-ut në Kosovë.

Hulumtimi është realizuar në formë të anketimit direkt dhe elektronik. Ai ka përfshirë 60 kompani të ndryshme që merren me teknologji informative në të gjitha rajonet e Kosovës. Qasja përmes anketimit direkt është përzgjedhur si formë e cila do të ofrojë të dhëna direkte nga kompanitë që ofrojnë shërbime në TIK dhe adreson mangësitë e njohurive, të cilat punonjësit e kompanive teknologjike duhet të posedojnë.

Rекторi i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi, i çmoi rezultatet e anketës si shumë me interes për insti-



tucionet shtetërore, ato akademike dhe për kompanitë e teknologjisë informative.

Ai theksoi nevojën që në Kosovë të ketë më shumë bashkëpunim midis institucioneve shtetërore, institucioneve akademike dhe industrisë, me qëllim të zhvillimit sa më të mirë të kësaj fushe, në hap me trendet e zhvillimit ndërkombëtar.

Disa nga treguesit më të rëndësishëm të anketës po i shpalosim në vijim.

Në pyetjen cili është niveli i edukimit të punëtorëve në kompanitë e TIK-ut, anketa ka treguar se 52.13 për qind e të punësuarve janë me nivelin master të edukimit, 36.92 për qind me nivelin baçelor, 6.15 me nivelin e doktoratës dhe vetëm 4.62 për qind janë me shkollë të mesme.

Të pyetur sa i adreson shkathtësitë e nevojshme për punë kurrikula mësimore që aplikohet në edukimin e lartë, 64.91 për qind janë shprehur se i adreson mesatarisht, 22.81 për qind aspak dhe 12.28 për qind plotësisht.

Anketa ka përfshirë edhe një pyetje lidhur me trajnimin e punëtorëve në kompanitë e teknologjisë informative. 75.81 për qind kanë theksuar se trajnimi bëhet brenda kompanisë, 14.52 për qind se ky trajnim bëhet jashtë kompanisë dhe 9.68 për qind kanë theksuar se punëtorët nuk trajnohen fare.

Madje 80.33 për qind deklarojnë se kompania fare nuk është konsultuar me institucionet që ofrojnë trajnime, që do të thotë

se vetëm 19.67 për qind e kanë bërë këtë.

Pyetja tjetër ka të bëjë me mënyrën e përdorur nga ofruesit e arsimit të lartë për të kontaktuar kompanitë. Del se në 40 për qind të rasteve kjo është bërë përmes anketimit, në 33 për qind të rasteve përmes grupeve punuese dhe në 27 për qind të rasteve përmes debatit publik.

Përgjigje shumë interesante ka nxjerrë pyetja në lidhje me shkathtësitë teknike që ju nevojiten kompanive të TIK-ut. Anketa ka nxjerrë se ato çmojnë më së shumti Konfigurimet (16 për qind), vendin e dytë e zë Dizajni (14 për qind) dhe të tretin Certifikimet, si në Cisco, ECDL, Windows (13.33 për qind). Më tutje renditen Web programimi, Administrimi i bazës së të dhënave, Programimi server-klient e të tjera. Ndërsa, kur janë pyetur për gjuhët programuese që janë më të kërkuarat në treg, të anketuarit kanë bërë këtë renditje: Java (25.25 për qind), C++ (21.21 për qind), PHP (19.19 për qind) C# (13.13 për qind) e të tjera, si ASP, C, Python e Perl.

Përgjigje mjaft interesante janë dhënë në pyetjen cilat aftësi kërkojnë më së shumti nga kompanitë e TIK-ut. Del se kompanitë më së shumti çmojnë përvojën e punës në pozita të ngjashme (25 për qind), aftësitë për zgjidhjen e problemeve (14.2 për qind), ndërsa diploma universitare është vetëm në vendin e tretë (11.36 për qind). Kompanitë çmojnë edhe njohjen e gjuhëve (amtare dhe të huaj), trajnimet dhe certifikimet, aftësitë e hulumtimit e të tjera.

Anketa ka përfshirë edhe pyetjen në lidhje me mangësitë e vërejtura te punëtorët e rinj. Në përgjigje dominojnë mangësitë në zgjidhjen e probleme (14.44 për qind), problemet me shkathtësitë e komunikimit (12.78 për qind), mangësitë në njohjen e pajisjeve teknologjike (10 për qind) e të tjera. Pas paraqitjes së rezultateve të anketës, pjesëmarrës nga fusha akademike dhe përfaqësues të kompanive të teknologjisë informative zhvilluan një debat të gjerë lidhur me të gjeturat e anketës dhe gjendjes në të cilën është teknologjia informative sot në Kosovë.

NË BASHKËPUNIM ME MINISTRINË E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

UBT INSTITUCIONI I VETËM I AUTORIZUAR PËR TRAJNIMIN DHE CERTIFIKIMIN E ADMINISTRATORËVE TË NDËRTESAVE NË BASHKËPRONËSI

Ministri dr. Ferid Agani, zyrtarë nga komunat e Kosovës, zyrtarë të tjerë institucionalë, përfaqësues të organizata ndërkombëtare, të shoqatave qeveritare dhe joqeveritare e ekspertë të fushës dhanë kontributin e tyre në konferencë

3 tetor. - Organizuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, është mbajtur konferenca për Administrimin e Ndërtesave në Bashkëpronësi, me qëllim të zbatimit të ligjit 04/L0134.

Ministri dr. Ferid Agani, zyrtarë nga komunat e Kosovës, zyrtarë të tjerë institucionalë, përfaqësues të organizata ndërkombëtare, të shoqatave qeveritare dhe joqeveritare e ekspertë të fushës dhanë kontributin e tyre në konferencë.

Ishte i pranishëm edhe rektori i UBT-së, prof.dr.Edmond Hajrizi dhe përfaqësues të tjerë të këtij institucioni. Të theksojmë këtu se UBT është institucioni i vetëm i autorizuar, i cili do të bëjë trajnimin dhe certifikimin e administratorëve të ndërtesave në bashkëpronësi. Ministri Ferid Agani falënderoi të gjithë pjesëmarrësit,



duke potencuar rëndësinë e zbatimit të këtij ligji që ka për qëllim të ndihmojë lehtësimin e jetës së qytetarëve, ku UBT, si institucion i autorizuar, do të ndihmojë në këtë

proces. Rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi theksoi se UBT si institucion i arsimit të lartë, me përvojë të shumta në fushën e trajnimeve dhe projekteve ndërkombëtare e sidomos nga Austria, do të ndihmojë procesin e trajnimit dhe certifikimit në gjithë territorin e Kosovës, ku do të lehtësojë jetën e qytetarit të Kosovës, duke

bëtare e sidomos nga Austria, do të ndihmojë procesin e trajnimit dhe certifikimit në gjithë territorin e Kosovës, ku do të lehtësojë jetën e qytetarit të Kosovës, duke

ngritur cilësinë dhe sigurinë e të gjithë banorëve.

Dr.Hajrizi tha se UBT është i gatshëm të fillojë menjëherë me fazën e trajnimeve, duke ofruar personel të specializuar për këto trajnime, teknologjinë dhe infrastrukturën e UBT-së në Prishtinë, por edhe në komunat e tjera, si në Ferizaj, Prizren, Gjiilan etj., që do të jenë në shërbim të të gjithë atyre që synojnë të jenë pjesë e programit për trajnim dhe certifikim.

Pjesë e kësaj konference ishte edhe debati i hapur, ku u diskutua rreth ligjit, zbatimit dhe mënyrës së trajnimit dhe certifikimit, debat që zgjoi interesimin e madh të kompanive dhe shoqatave për të bashkëpunuar me UBT-në për ngritjen e kapaciteteve njerëzore profesionale për trajnim dhe certifikim në këtë fushë.

NË KUADËR TË DREJTORISË SË URBANIZMIT, NDËRTIMIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT NË KOMUNËN E PRISHTINËS

STUDENTËT E ARKITEKTURËS NË UBT, HARTUES TË PROJEKTEVE TË RËNDËSISHME PËR PRISHTINËN

Projekti i fundit, në të cilin Ermali dhe Shkumbini kanë treguar sukses të madh, është projekti "Tregu mobil", në të cilin parashihen të ndërtohen 100 pika shitëse mobile nëpër lagjet e Prishtinës

1 tetor. - Ermal Canaj dhe Shkumbin Alihajdaraj, studentë të Fakultetit të Arkitekturës në kuadër të UBT-së, janë të angazhuar, në kuadër të Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit në Komunën e Prishtinës, në cilësinë e praktikantëve së bashku me studentë nga universitetet e tjera.

Që nga fillimi i angazhimit të tyre në Korrik 2015, Ermal Canaj dhe Shkumbin Alihajdaraj janë angazhuar në disa projekte të parapara nga kjo drejtori. Ndër projektet që vlejnë të përmenden janë: Projekti për Restaurimin e Bibliotekës "Hivzi Sylejmani" dhe Bibliotekës së fëmijëve "Hivzi Sylejmani" në Prishtinë. Detyra e tyre në kuadër të këtyre projekteve ishte restaurimi, ndryshimi funksional dhe ruajtja e vlerave arkitektonike dhe të trashëgimisë të këtyre objekteve.

Projekti i fundit, në të cilin Ermali dhe Shkumbini kanë treguar sukses të madh, është projekti "Tregu mobil", në të cilin parashihen të ndërtohen 100 pika shitëse mobile nëpër lagjet e Prishtinës. Në konkursin e brendshëm të Komunës së Prishtinës, në mes të grupeve të studentëve, ideja dhe dizajni i punuar nga Ermal Canaj është përzgjedhur si dizajni fitues



për projektin në fjalë. Më pastaj kjo ide është zhvilluar dhe detajizuar edhe me mbështetjen dhe ndihmën e Shkumbin Alihajdarit, dhe ajo tani është e finalizuar.

Realizimi i këtij projekti dhe ndërtimi i këtyre pikave, të cilat do të mund t'i shohim në lagje të ndryshme të Prishtinës, pritet të bëhet gjatë muajit tetor të këtij viti.

Aktualisht, Ermali dhe Shkumbini, janë të angazhuar në mbikëqyrjen e prodhimit të prototipeve të këtyre stendave, pastaj prodhimin e 100 stendave sa parashihen të operojnë në qytetin e Prishtinës.

Përveç Ermalit dhe Shkumbinit, në Komunë të Prishtinës janë të angazhuar një numër i studentëve të Fakultetit të Arkitekturës nga UBT, të cilët janë pjesë e projekteve konkrete të Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit në Komunën, ku përfshihen: Incizimi dhe projektimi i dollapëve në të gjitha shkollat fillore të Komunës së Prishtinës; Projektimi dhe rregullimi i hapësirave të jashtme të shkollave fillore në Komunës së Prishtinës; Incizimi i gjendjes ekzistuese dhe projektimi i shetitoreve dhe trotareve në qytetin e Prishtinës;

Identifikimi i lokacioneve dhe projektimi i parkingjeve për automjete, përgjatë rrugëve të qytetit të Prishtinës e projekte të tjera.

Në këto dhe shumë projekte tjera, ishin dhe janë të angazhuar studentët: Agim Lutolli, Bujar Statovci, Gent Berisha, Veton Krasniqi, Learta Stavileci, Luiza Hoxha, Gentijana Demaj, Fortuna Haziri, Bardh Abazi, Aurora Jakupi, Azize Popaj, Natyra Poqesta, Hekuran Tërpeza, Gentiana Xhemaili, Veton Krasniqi, Dodona Blakaj, Fiton Zogaj, Gentian Zogaj, Egzona Morina e të tjerë.

Me projektin e zhvilluar në inkubatorin e UBT-së fitojnë grant nga "HELP KOSOVA"

28 shtator – Studentët e UBT-së, Bujar Statovci dhe Gent Berishakanë fituar një grant nga organizata humanitare gjermane "HELP KOSOVA" për zhvillimin e një projekti të tyre, realizimi i të cilit kanisur me ndihmën dhe përkrahjen e inkubatorit të biznesit të UBT-së. Kjo organizatë jep grante për çdo vit, në bashkëpunim me komunat e Kosovës.

Projekti i studentëve të UBT-së synon krijimin e një kompanie e cila do të ofrojë produkte arkitektonike inovative, duke pasur afërsinë e mobilitetit-lëvizjes dhe sistemin e tipit montazh, duke mundësuar krijimin e ndërtimeve "CUBE" shumë funksionale dhe vetëfurnizuese dhe duke aplikuar edhe teknologjitë më të reja në materiale të ndryshme të cilat mundësojnë që ato të jenë eko dhe të vetëmirëmbajtura.

Qëllimi kryesor është të sjellim risi dhe inovacion brenda profesionit tonë dhe furnizimin e tregut vendor dhe rajonal me këto lloj ndërtimesh-produktesh, thonë ata.

Genti dhe Bujari idenë e projektit e kanë krijuar pas hulumtimit të disa sistemeve të reja të ndërtimit dhe të arkitekturës. Pas kësaj, ata aplikuan me idenë e tyre në Inkubatorin e krijuar në UBT, ku ideja e tyre ishte një ndërëdëdë fituese. Atavazhduan të punojnë në Inkubatorin e UBT-së drejt përpilimit të një biznes-plan për idenë e tyre.

KONFERENCA "DITA AUSTRIAKE-KOSOVARE E SHËNDETËSISË"

AUSTRIA E GATSHME TË VAZHDOJË TË NDIHMOJË ZHVILLIMIN E SHËNDETËSISË NË KOSOVË

6 tetor 2015. - Ish-zëvendës-kancelari i Austrisë, diplomati i mirënjohur evropian, i angazhuar shumë rreth çështjes së Kosovës, z. Erhard Busek, që tani është koordinator i Iniciativës për Bashkëpunim Juglindor (SECI), ministri i Shëndetësisë në Qeverinë e Republikës së Kosovës, z. Imet Rrahmani, përfaqësues të qeverisë dhe institucioneve të tjera, si dhe profesionistë të tjerë, dhanë sot kontributin e tyre në konferencën "Dita Austriake-Kosovare e Shëndetësisë", e organizuar nga UBT, Shoqata Austriake-Kosovare dhe Rrjeti i Kujdesit Shëndetësor Austriak për Kosovën.

Qëllimi i konferencës ishte diskutimi i gjendjes së sektorit të shëndetësisë në vendin tonë, problematikat që e përcjellin atë dhe rruga përpara për ngritjen e shëndetësisë në Kosovë në një nivel më të lartë, duke marrë për bazë përvojat austriake në këtë fushë, si ndër më pozitivet dhe ndër më të zhvilluarat në Evropë.

"Më lejoni që në emrin tim dhe në emër të UBT-së t'ju uroj mirëseardhje. Siç e dini, ne kemi disa bashkëpunime me organizatën austriake dhe mundësisht të marrim edhe modele austriake dhe të lidhim relacione me këtë rast edhe në fushën e shëndetësisë, që është një temë me rëndësi për Kosovën. Po mundohemi që këtë temë ta trajtojmë në mënyrë direkte dhe indirekte, me çështjet që lidhen me menaxhimin, teknologjinë dhe statistikën, dhe duke u futur sa më shumë afër klimës së shëndetësisë inovative", theksoi ndër të tjera në hapje të konferencës rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi.

Ministri i Shëndetësisë në Qeverinë e Republikës së Kosovës, z. Imet Rrahmani, theksoi se investimi në edukim dhe në shëndetësi sigurisht se është investim për një të ardhme të sigurt.



"Me vendosjen e shëndetësisë si një nga prioritetet kryesore të saja, Qeveria, përkatësisht Ministria e Shëndetësisë angazhohet në zbatimin e reformës përmbajtësore dhe gjithëpërfshirëse në sektorin e shëndetësisë bazuar në Strategjinë sektoriale shëndetësore 2015-2020 dhe moton e Bashkësisë Evropiane në sektorin e shëndetësisë "Politikat shëndetësore – në të gjitha politikat", tha ministri Rrahmani.

Ministri Rrahmani tha se MSH sot gjendet në një fazë të rëndësishme të zbatimit të reformës së sistemit shëndetësor, e cila reformë synim kryesor ka sigurimin e qasjes universale në shërbime cilësore shëndetësore për të gjithë qytetarët dhe banorët e vendit si dhe eliminimin e pabarazive gjatë shfrytëzimit të shërbimeve shëndetësore. "Kjo do të arrihet me funksionalizimin më të mirë të sistemit shëndetësor, ngritjen e efikasitetit të institucioneve shëndetësore në të gjitha nivelet,

përmirësimin e infrastrukturës së hapësirave dhe mjeteve të funksionimit, funksionalizimin e sigurimeve shëndetësore si dhe zhvillimin e kapaciteteve menaxheriale në kuptim të rritjes së përgjegjësisë, transparencës dhe llogaridhënies së strukturave menaxheriale", tha ai.

Më pas Ministri ka elaboruar aspekte që lidhen me themelimin dhe funksionalizimin e Fondit Publik të Sigurimeve Shëndetësore; Implementimin dhe Funksionalizimin e plotë të Sistemit të Informimit Shëndetësor (SISH); Funksionalizimin e plotë të Odave të Profesionistëve Shëndetësorë dhe çështje të tjera me interes për reformën në shëndetësi.

Në vijim, Erhard Busek, koordinator i Iniciativës për Bashkëpunim Juglindor (SECI), theksoi se duhet bërë intervenime të nevojshme në përmirësimin e kushteve në institucionet shëndetësore, në preventivën shëndetësore, edukimin shëndetësor dhe fusha të tjera



të shëndetësisë, duke theksuar se takimi si ky i Ditës së Shëndetësisë Austriako-Kosovare vendos kornizat e një bashkëpunimi akademik, që ka për qëllim krijimin e një partneriteti, këmbimin e përvojave me qëllim të ngritjes së cilësisë së shërbimeve, edukimit shëndetësor dhe menaxhimit shëndetësor.

Z. Busek paraqiti një varg përvojash nga Austria, shtet në të cilin është bërë një përpjekje dhe angazhim i madh që nga fundi i Luftës së Dytë Botërore, por që rezultatet kanë arritur shumë më vonë. Ai porositi kosovarët që të krenohen me atë që kanë arritur e jo të krijojnë ndjenjën e mungesës së asaj që nuk e kanë.

Ju duhet të vazhdoni të punoni që të arrini nivele të larta, edhe në fushën e shëndetësisë, sa më shpejt që është e mundur, theksoi Busek, duke shtuar se në këtë rrugë Kosova do të ketë përkrahjen e vazhdueshme të Austrisë.

Dekani i Mjekësisë në UP, dr. Sali Ahmeti, përkujtoi ndihmën e madhe të Austrisë për Kosovën në fushën e shëndetësisë.

"Përkrahja e qeverisë austriake për sistemin e edukimit në Koso-

vë ka filluar që nga vitet '90 me ç'rast ka filluar një përkrahje konkrete për Fakultetin e Mjekësisë, studentëve të të cilit iu mundësua vizita në Austri, që ishte fundamentale për këtë fakultet", tha dr. Ahmeti.

"Çdo ndihmë është e mirëseardhur dhe nuk duhet të harrohet sidomos ndihma që na është ofruar në këtë kohë. Një falënderim të veçantë për Universitetin e Vjenës edhe shtetin austriak, që ndihmuan me shumë gjëra, me pajisje laboratorike në atë kohë, që ka qenë shumë e rëndësishme. Përmes kësaj zyre janë përkrahur studentë për kryerjen e doktoratës në Austri. Përvojat e marra atje janë përvoja të veçanta për ne", tha dekani Ahmeti.

Në konferencë folën edhe përfaqësues të tjerë të institucioneve, duke trajtuar aspekte të ndryshme të zhvillimit të sektorit të shëndetësisë në Kosovë, si dhe u zhvillua një debat mjaft me rëndësi për këtë fushë.

BESART TROSHUPA,
SHERIFE SOKOLI

Dr. Lulzim Beqiri mori pjesë në konferencën prezantuese të ofertës së universiteteve gjermane në kuadër të Projektit Erasmus +

29 shtator – Dekani i Arkitekturës në UBT, dr. Lulzim Beqiri mori pjesë në konferencën e organizuar në kuadër të Projektit Erasmus+, organizuar nga DAAD (German Academic Exchange Service), në fokus të së cilës ishte prezantimi i projekteve të universiteteve Gjermane dhe mundësia e lidhjes-rrjetëzimit me universitetet e Ballkanit Perëndimor.

Në konferencë morën pjesë përfaqësues nga DAAD, universitetet nga Gjermania, Kosova, Shqipëria, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia dhe Mali i Zi.

Në konferencë u prezantuan përparësitë e aplikimit në Erasmus+ dhe disa prej elementeve apo fokuseve që duhet të kihen parasysh gjatë aplikimit.



Universitetet nga Gjermania prezantuan 21 projekte për ngritjen e kapaciteteve (capacity building) dhe mundësitë që çdo universitet i Ballkanit të jetë partner në fushat si: shkëmbimi

i studentëve, shkëmbimi i stafit, projektet e përbashkëta, hulumtimet e përbashkëta, krijimi i drejtimeve të përbashkëta, mundësitë e studimit në të gjitha nivelet në Gjermani e të tjera.

Juridiku në UBT, programi me punësim shumë të lartë të studentëve

UBT vazhdon edhe më tej të ruajë primatin e institucionit me shkallën më të lartë të punësimit të studentëve të saj.

Një nga drejtimet që mund të mburret me shkallën shumë të lartë të punësimit të studentëve në UBT është drejtimi i Juridikut. Pothuaj të gjithë studentët që kanë studiuar në këtë drejtim apo edhe që vazhdojnë edhe më tutje studimet janë të punësuar në institucione dhe kompani publike e private.

E gjithë kjo është arritur përmes programit adekuat të studimeve, angazhimit të pareshtur të profesorëve dhe të studentëve, punës praktike dhe angazhimit në detyra specifike, përmes Qendrës së Karrierës në UBT, të cilat atyre u kanë mundësuar të përgatiten në shkallë shumë të lartë dhe të jenë konkurrentë e të kërkuar nga tregu i punës.

KONFERENCA PËR INDUSTRIJË 2015



NË VEND SE TË IMPORTOJMË, DUHET TA ZHVILLOJMË EKONOMINË E VENDIT TONË

“Në vend se të importojmë ne duhet të zhvillojmë ekonominë e vendit tonë. Ajo që jemi duke u munduar ta bëjmë është pikërisht koncepti i cilësisë. Që nga viti 2002 kemi mbajtur aktivitete për cilësinë, ndërsa sot gjithçka është e vendosur, vetëm që duhet të punojmë në këtë drejtim”, tha rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi

7 tetor 2015. - Shoqata Austriake në Kosovë dhe UBT, në bashkëpunim me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë të Kosovës organizuan sot konferencën “Dita Austriake-Kosovare e Industrisë 2015”, me qëllim që të promovojnë sektorin e industrisë në Kosovë, duke u bazuar në modelin austriak.

Me këtë rast, në fjalën hyrëse rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, ndër të tjera theksoi se përgjegjësia e UBT-së mbi këtë forum është të përcjellë njohuritë e reja të kësaj natyre si dhe të ketë cilësi në ofrimin e këtyre shërbimeve.

“Forumi që kemi sot është mundësi e shkëlqyer për t’i shkëmbyer përvojat tona. Por, cila është përgjegjësia e UBT-së? Përgjegjësia e UBT-së është të përcjellë njohuritë e reja të kësaj natyre. Ne nuk mund të prodhojmë njohuri të reja individualisht, mirëpo duke falënduar partnerët për bashkëpunimin ideja po zgjerohet. Në vend se të importojmë ne duhet të zhvillojmë ekonominë e vendit tonë. Ajo që jemi duke u munduar ta bëjmë është pikërisht koncepti i cilësisë. Që nga viti 2002 kemi mbajtur aktivitete për cilësinë, ndërsa sot gjithçka është e vendosur, vetëm që duhet të punojmë në këtë drejtim”, tha rektori Hajrizi.

David Ungar, organizuesi i ComSult në Vjenë, njëkohësisht specialist i teknologjisë, pohoi se çështjeve kryesore që duhet t’i përmbahet Kosova si vend që synon ta zhvillojë këtë sektor janë arsimit cilësor si dhe inovacioni (krijimtaria, ndërmarrësia, etj.) Sipas Ungar, lokacioni për të bërë biznes duhet të ketë potencial dhe shumë investitorë nuk janë në dijeni se Kosova ka një lokacion industrial. Ndërkohë që theksoi se infrastruktura e cila dhe përbush kushtet e të bërit biznes, luan rol të rëndësishëm.

“Gjatë këtij procesi një gjë është e rëndësishme, digjitalizimi apo modernizimi. Në këtë mënyrë suksesshëm mund të fillohet edhe me promovimin e kësaj fushe. Duhet t’i promovoni lokacionet në Kosovë dhe kjo është mënyra më e mirë për të joshur investimet. Gjithashtu, nëse keni infrastrukturën e duhur ky është një imazh që tërheq investimet. 60 për qind e pyetjeve të menaxherëve biznesorë në botë, janë për infrastrukturën. Pra, infrastruktura është faktori kryesor i lokacionit dhe kjo i bën të joshur shumë investitorë”, është shprehur Ungar.

Derisa Jan Peter Olters, menaxher i Bankës Botërore në Kosovë, tha se objektivi i industrisë në Kosovë është që të flitet më pak për potencialin, ndërsa rëndësi t’i kushtohet mundësive. Sipas tij, industria është një fushë që paraqet sfida të ndryshme.

“Kosova ka përmbajtje të ulët kapitale, zbrazëtitat e produktivitetit ende reflektohen. Fokusi më i mirë dhe më efikas është rritja e cilësisë, më pas rritja e produktivitetit. Duhet të flitet më pak për potencialin e më shumë për mundësinë, sepse është sfida kjo fushë e ndërkohë trendet e tanishme mbështeten në rritjen industriale”, është shprehur Olters.

Emmanuel Mitsou, përfaqësues nga Sharrcem (kompani që merret me prodhimin e çimentos në Kosovë), para së gjithash tha se kjo fushë ka nevojë për parakushte në mënyrë që të zhvillohet suksesshëm. Ky sektor, sipas tij, nuk ndodhet rastësisht andaj i gjithë potenciali mbështet edhe tek të rinjtë që edhe shihen si mundësi.

“Duhet të dimë që potenciali shihet tek të rinjtë e vendit. Është e vërtetë që ka shumë problem dhe nevojitet një plan, por industria nuk ndodhet rastësisht, e kjo fushë ka nevojë për parakushte që të zh-

villohet. Kur mundohemi ta shohim Kosovën si lokacion biznesi, duhet të shohim edhe modelin e saj. Mjedisi i biznesit duhet të fillohet me hapa të theksuar, por jo të mendohet për korniza apo ligje të mëdha. Pra, fillimisht duhet të mendohet për skema të mëdha”, tha Mitsou.

Kostas Rizopoulos, përfaqësues i Ferronikelit (kompani ndërkombëtare e specializuar në eksplorim, miniera dhe prodhimin e hekur-nikelit), duke folur për investimet që janë bërë në këtë kompani, pohoi se kemi investuar njëqind milionë dollarë për të filluar punën dhe ndër vite kemi arritur që të rrisim potencialin tonë. Duke folur për mundësitë e të bërit biznes në Kosovë, Rizopoulos tha se ky vend duhet të përmirësojë qasjen dhe të respektojë komunitetin e biznesit

“Ne kemi investuar shumë para, rreth 100 milionë dollarë dhe kemi arritur që me burime vendore të arrijmë të kemi produkte të cilësisë së lartë, produkte këto që po shiten në shumë vende të botës. Bizneset si Ferronikeli duhet të japin punësim, GDP të lartë dhe më pas duket të jetë një storie e suksesit duke promovuar Kosovën në biznesbërje. Sigurisht që ky vend duhet ta respektojë komunitetin e biznesit”, theksoi shprehur Rizopoulos.

Në konferencë u paraqitën edhe folës të tjerë dhe në debatin e zhvilluar u theksuan një varg elementesh që lidhen me fushën e industrisë, që nga mënyra e organizimit, përkrahja profesionale dhe në mënyra të tjera e deri te konkurrueshmëria me kompanitë botërore, një nivel që duhet të arrihet, për të siguruar prezencën e produkteve nga Kosova në tregjet ndërkombëtare.

EDONA JERLIU, DRIN JAKURTI

NË BASHKËPUNIM ME SHOQATËN AUSTRIAKE-KOSOVARE

NË UBT I ZHVILLOI PUNIMET KONFERENCA “DITA AUSTRIAKE-KOSOVARE E ENERGJISË 2015”



18 nëntor 2015. - Në vazhdenë e konferencave të organizuara nga UBT dhe Shoqata Austriake-Kosovare, sot në Kampusin Inovativ të UBT-së i zhvilloi punimet konferenca e radhës, e cila për temë kishte energjinë.

Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi ka paraqitur në konferencë gjendjen energjetike në Kosovë, me theks të veçantë kontributin që po jep UBT, me programe të veçanta studimi dhe me ekspertë të fushës së energjisë, vendorë e ndërkombëtarë për të dhënë kontributin në qasjen e re ndaj energjisë, që vazhdon të mbetet një nga pikat më problematike të gjendjes së përgjithshme e

sidomos të zhvillimit ekonomik të Kosovës.

Besa Gashi-Zogaj, zëvendës-ministre e Zhvillimit Ekonomik, Arben Gjuka, drejtor i KEK-ut, Afrim Ajvazi nga Autoriteti Rregullator i Energjisë, përfaqësues nga Banka Botërore, nga shoqatat për energjinë e ripërtërishme, përfaqësues të kompanive të mëdha dhe ekspertë të fushës së energjisë, përmes prezantimeve dhe debateve dhanë një pasqyrë të plotë të gjendjes energjetike në vendin tonë, përpjekjet për futjen të funksion të energjisë alternative, gjendjen e stabilimenteve të tashme të prodhimit të energjisë dhe planet për të ardhmen energjetike të vendit.

UBT ME PROGRAME INOVATIVE

30 korrik. - UBT, si një institucion lider në arsimin e lartë privat në Kosovë, vazhdon të ofrojë programe inovative për studentët, siç e ka bërë këtë që nga themelimi i tij.

Krahas programeve të tjera, me të cilat studentët dhe kandidatët e rinj për studime tashmë janë të njoftuar dhe e dinë vlerën e tyre, UBT nga ky vit akademik ofron edhe programe të reja, inovative dhe atraktive, për studime.

Kështu, UBT, në drejtimin e studimeve Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, ofron drejtimet: Financa, Banka dhe Sigurime;

Kontabilitet, Auditim dhe Tatime; Menaxhment, Ndërmarrësi dhe Inovacion; Biznes ndërkombëtar.

Një program të ri UBT e ofron edhe për studentët e Juridikut/LLM: E drejta biznesore biznesore ndërkombëtare dhe evropiane.

Këto drejtime u mundësojnë studentëve të fitojnë njohuri në fusha të reja, gjithnjë atraktive dhe në ndërlidhje me kërkesat e tregut të punës dhe përgatitjes sa më profesionale të studentëve për vazhdim studimesh në nivele më të larta dhe për karrierë të suksesshme.

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

UBT BËHET PARTNER AKADEMIK I COMPTIA



1 tetor - UBT është akredituar si Partner Akademik i vetëm në rajon

i ofruesit më të madh të certifikimeve në fushën e Teknologjisë së Informacionit CompTIA. Nga ky certifikim studentët e UBT-së dhe të tjerët do të kenë mundësinë të përfitojnë certifikime dhe trajnime të njohura ndërkombëtarisht në fushën e TI-së.

CompTIA si ofruesi kryesor i provimeve dhe certifikimeve në fushën e TI-së, ofron trajnimet dhe certifikimet në Përkrahje Teknike për PC, Rrjete Kompjuterike, Serverë, Linux, Siguri të Sistemeve etj.

CompTIA është e njohur për të siguruar certifikatat e industrisë standarde, që vërtetojnë aftësitë themelore të kandidatit. Programet e certifikimit të CompTIA sigurojnë një bazë të fortë për zhvillim të mëtutjeshëm profesional.

Kompanitë e njohura, si Cisco, HP, IBM, Microsoft dhe Novell, njohin certifikatat e CompTIA si zgjedhje për programet e tyre.

Zyrat qendrore të CompTIA gjenden në Chicago, USA.

NË UBT U SHËNUA DITA NDËRKOMBËTARE E SISTEMEVE TË GJEONFORMACIONIT



UBT BËHET ANËTAR I SAP UNIVERSITY ALLIANCE

15 tetor 2015. - Në kuadër të anëtarësimeve në institucione dhe organizata ndërkombëtare, UBT është bërë anëtare e SAP University Alliances, një institucion lider në tregun e softuerit të aplikuar për ndërmarrje.

Trajnimet edhe edukimi i bazuar në SAP University Alliances do të

përfshihen në programet akademike të UBT-së në semestrin dimëror 2015/2016. Ato ofrohen nga Qendra Universitare e Kompetencës së SAP. Zgjerimi i programit SAP do të përputhet me kërkesat e tregut lokal dhe rajonal. Nisur nga kjo, UBT fton organizatat lokale dhe industrinë potenciale për të

diskutuar strategjitë SAP të lidhura me kërkesat e tyre.

Duke qenë lider në tregun e softuerit të aplikuar për ndërmarrje, SAP ndihmon organizatat të gjenerojnë mundësi të reja për inovacion dhe rritje, të ecin para konkurrencës dhe një varg mundësish të tjera.

NË UBT FILLUAN TRAJNIMET DHE CERTIFIKIMET NË FUSHËN E TEKNOLOGJISË INFORMATIVE



Qendra Ekzekutive për Zhvillim Profesional në UBT ka filluar me organizimin e trajnimeve dhe certifikimeve profesionale në fushën e Teknologjisë Informative, për pjesëmarrje në të cilat kanë shprehur interesim një numër i konsiderueshëm i studentëve.

UBT si Qendër e Autorizuar për trajnimet e Cisco Networking Academy gjatë nëntorit organizoi grupet e para në trajnimin IT Essentials: PC Hardware and Software dhe do të vazhdojë me trajnimet e radhës në Linux Essentials dhe Windows Server 2012.

Gjithashtu UBT, përmes Qendrës së Trajnimeve, ofron edhe certifikimet profesionale në të gjitha fushat e Teknologjisë Informative, siç janë: Software dhe Hardware, Siguri Kibernetike, Rrjete Kompjuterike, Serverë, Menaxhimi të projekteve të TI-së etj.

20 nëntor 2015. - Në kuadër të "Javës së ndërgjegjësimit për gjeografinë" (Geography Awareness Week), UBT shënoi Ditën Ndërkombëtare të Sistemeve të Gjeoinformacionit e njohur si GIS Day. Gjatë këtij aktiviteti ditor, UBT në bashkëpunim me kompaninë ATI-Kos për studentët nga Fakulteti i Sistemeve të Informacionit, Arkitekturës, Energjisë Eficiente dhe Shkencave Kompjuterike, organizuan një workshop/mapathon përmes të cilit studentët u njoftuan mbi rëndësinë e gjeoinformacionit, teknikat e përdorimit të hartave, shfrytëzimin e hartave në ueb-faqe, përdorimin e

platformave dhe veglave me kod të hapur për menaxhimin e hartave elektronike, si dhe format për dhënie e kontributit tonë në plotësimin e hartave elektronike në Kosovë dhe gjetiu. Një fjalë rasti në konferencë, mbajti edhe Rectori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi theksoi se UBT ka një program të plotë të akredituar mbi për studimet Master mbi GIS si dhe duke pasur parasysh edhe programin e studimeve bachelor mbi Sistemet e Informacioneve, UBT ofron një cikël të plotë për studentët që dëshirojnë të studiojnë sistemet e informacionit, respektivisht të gjeoinformacionit.

NË UBT U PREZANTUA PROJEKTI "GRATË NË PUNËT ONLINE"

Në kampusin inovativ të UBT-së sot është bërë prezantimi i projektit "Gratë në punët online".

Projekti i zhvilluar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik e Kosovës, me përkrahjen e Bankës Botërore, do t'ju mundësojë femrave të moshës 18-34 vjeç, që janë në proces të përfundimit të studimeve ose tashmë i kanë përfunduar studimet

që të jenë pjesë e trajnimit i cili ka për qëllim që të rrisë pjesëmarrjen e grave në punët online.

Programi do të zgjasë gjashtë muaj dhe synon posaçërisht përfshirjen e grave të zonave të Lipjanit dhe të Gjakovës.

MASHT LICENCOI DEGËN E UBT-SË NË FERIZAJ



7 shtator. - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) ka nxjerrë vendim për licencimin e degës së UBT-së në Ferizaj.

Sipas vendimit të kësaj ministrie, Dega e UBT-së në Ferizaj licencohet për pesë vitet e ardhshme akademike: 2015/2016,

2016/2017, 2017/2018, 2018/2019 dhe 2019/2020.

Programet e studimeve që ofrohen në këtë degë janë të akredituara nga Agjencia e Kosovës për Akreditim.

PAS PËRFUNDIMIT TË STUDIMEVE NË JURIDIK

DRIN GRAZHDANI, NGA UBT NË LEIDEN UNIVERSITY



21 gusht. - Drin Grazhdani, pas përfundimit të studimeve në Juridik në UBT tani i vazhdon studimet në Leiden University, në Holandë, në universitetin më të vjetër në këtë vend, të themeluar më 1575.

Në një intervistë për "UBT News", Grazhdani thotë se angazhimi i tij do të ishte i pavlerë pa përkrahjen e UBT-së.

UBT News: Ju keni përfunduar studimet në UBT. Ndonjë përshtypje?

Drin Grazhdani: Kujtimet e mia në UBT si student lidhen me afërsinë e madhe me profesorët dhe stafin e UBT-së. Përkrahja e tyre nuk mund të zëvendësohet. Ata janë arsyeja e suksesit tim dhe eksperiencës time të mirë në UBT.

UBT News: Keni qenë student i dalluar në UBT, sa ju ka ndihmuar kjo në zhvillimin e mëtejshëm?

Drin Grazhdani: Studimet e mia në UBT më dhuruan dijen dhe eksperiencën e duhur që unë të jem i gatshëm të vazhdoj studimet në një ndër universitetet më të mira në botë. Besoj se UBT-ja që nga formimi është zhvilluar në hapa tepër të shpejtë, duke bërë që unë dhe shumë studentë të tjerë të pranohemi në universitetet më të mira në botë.

UBT News: Në çfarë mënyre ua ka hapur dyert UBT-ja?

Drin Grazhdani: UBT-ja më ka ndihmuar në të gjitha aspektet. Së pari më ka formuar si student që të jem i gatshëm për tregun

e punës, për vazhdimin e studimeve, dhe për ballafaqimet në jetë që ne si studentë dhe individë mund t'i kemi.

UBT News: A keni hasur në ndonjë vështirësi gjatë kohës sa ishit student?

Drin Grazhdani: Vështirësitë kanë qenë të ndryshme, duke marrë parasysh synimet e mia, por stafi i UBT-së dhe profesorët ishin ata të cilët më shtynë përpara drejt kalimit të këtyre sfidave dhe vështirësive. **UBT News: Jeni pranuar në Leiden University, në Holandë, si e përshkruani atë moment?**

Drin Grazhdani: Pranimi im në Leiden University ishte një ndër momentet më të mira dhe të lumtura në jetën time. Ëndrra ime ishte që të studioj në një ndër universitetet më të mira në botë. Por ajo që më bëri edhe më të lumtur është pranimi në program të "avancuar" që ka dallim nga magistraturat e rregullta që Universiteti i Leidenit ofron, duke më bërë studentin më të ri në moshë të pranuar në këtë drejtim. Në Programin Master i Avancuar në të Drejtën ndërkombëtare civile dhe komerciale pranohen vetëm studentë apo individë të cilët kanë eksperiencë të madhe në fushën e drejtësisë. Sakrificat e mia dhe puna e madhe më bëri që ëndrrën time ta arrij në këtë moshë kaq të re. Po ashtu jam shumë krenar që studioj në një universitet ku Albert Einstein ka dhënë mësim.

UBT News: A mendoni se vetëm falë angazhimit tuaj keni arritur këtu ku jeni apo është dhe fakulteti?

Drin Grazhdani: Angazhimi im do të ishte i pavlerë pa përkrahjen e UBT-së. Fakulteti është në gjendje t'i dhurojë të gjitha vetëm e vetëm që ëndrrat e studentëve të bëhen realitet. Unë besoj se nuk jam i vetmi që kam pasur këtë eksperiencë duke marrë parasysh se ka edhe studentë të tjerë të cilët kanë kaluar në të njëjtën rrugë.

UBT News: Sipas Drinit, cilat komponenta e bëjnë një student të suksesshëm?

Drin Grazhdani: Unë besoj që janë shumë tipare të cilat e bëjnë një student të dalluar dhe të suksesshëm. Disiplina, puna e madhe, sakrificat, vizioni i duhur, mosdëshpërimi nga dështimet e mundshme e bëjnë një student dhe individ të jetë i suksesshëm.

UBT News: Porosia juaj për studentët e UBT-së?

Drin Grazhdani: Porosia ime për studentët e UBT-së është që t'i ndjekin ëndrrat e tyre pa marrë parasysh sfidat të cilat mund të vijnë në rrugën drejt suksesit. UBT ofron edukim universitar tepër profesional, por nëse nuk angazhohemi atëherë askush nuk mund ta bëjë atë për ne. Besoj se edukimi është çelësi ynë drejt një të ardhmeje më të mirë. Sidoqoftë unë jam i gatshëm t'i këshilloj dhe të ndihmoj çdo student të UBT-së, prandaj shpresoj që studentët të mos hezitojnë të më kontaktojnë.

STUDENTI BRIKEND RAMA VAZHDON STUDIMET MASTER NË NORVEGJI NE GJOVIK UNIVERSITY COLLEGE

27 korrik. - Studenti i UBT-së, Brikend Rama, do të vazhdojë studimet në nivelin master në Universitetin Gjovik në Norvegji. Studimet do t'i vazhdojë në Shkencat e Aplikuara kompjuterike (Applied Computer Science) në kuadër të fakultetit të Shkencave Kompjuterike.

Brikendi ka përfunduar studimet në nivelin bachelor në UBT, ndërsa semestrin e fundit e ka përfunduar në Universitetin Gjovik.

UBT dhe Universiteti Gjovik kanë tash disa vjet marrëveshje bashkëpunimi për mobilitet të stafit dhe të studentëve dhe për projekte të përbashkëta.



STUDENTI I UBT-SË MUHAMED RETKOCERI VIJON STUDIMET NË ILLINOIS INSTITUTE OF TECHNOLOGY

27 korrik. - Studenti i UBT-së, Muhamed Retkoceri, pas fitores së garës së NASA-s me projektin "Natev Explorer", dhe rangimi si finalist në kategorinë Diploma e Vitit në ndarjen e Çmimeve nga Albanian ICT Awards në Tiranë, ka shënuar edhe një sukses të dalluar.

Përmes programit Transformational Leadership Program - Scholarships and Partnerships të USAID-it, ai ka fituar bursë për vazhdimin e studimeve në Illinois Institute of Technology në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në fushën e inxhinierisë softuerike.

Kompania JUB nga Sllovenia prezantohet para studentëve të UBT-së

26 tetor 2015. - Një numër i madh arkitektësh, inxhinierë të ndërtimtarisë dhe studentë të vitit të II-të dhe të III-të drejtimi Arkitekturë kanë marrë pjesë në prezantimin e kompanisë sllovene JUB, të organizuar në kampusin e UBT-së dhe të udhëhequr nga profesori në UBT, Edmond Tafarshiku, njëherit anëtar edhe i JUB Akademisë në Slloveni.

Të pranishmit u njoftuan me projekte të ndryshme nga eficientia e energjisë, fizika e ndërtimit, vlerat (lambda) - për materiale që më së shpeshti përdoren në sistemin termoizolues të fasadës, përçueshmëria ter-

mike - kalkulimi i vlerës U. Pastaj për sistemi termoizolues JUBI-ZOL - sistemi më i dëshmuar në rajon për ruajtjen e energjisë me garanci prej 10 deri 25 vite, si dhe mënyrën e vënies në veprim të këtij sistemi.

Gjithashtu u njoftuan edhe me shtresat përfundimtare - dekorative të fasadës, NANO Fasada (në sistemin nanoteknologji), si dhe me një varg produktesh të tjera të kompanisë JUB.

Kompania JUB nga Sllovenia është themeluar në vitin 1875 dhe sivjet kremton 140-vjetorin e themelimit. Është ndër firmat më me renome në Evropë për

prodhimin e produkteve finale-përfundimtare në ndërtimtarinë, prej ngjyrave ekologjike të brendshme, sistemeve termoizoluese të fasadës dhe zgjidhjet energjetike, produktet ekologjike për mbrojtjen e drurit si dhe sistemin për hidroizolim dhe sipërfaqeve.

Në këtë kompani funksionon JUB Akademia, e cila në mënyrë të vazhdueshme mban trajnime me arkitektë, inxhinierë, studentë dhe punëkryes, për aftësimin teorik dhe praktik të vënies së adekuate në punë të këtyre produkteve - detajeve përfundimtare në ndërtesat e banimit dhe ato publike.



SUKSESET E PROFESORËVE DHE STUDENTËVE TË UBT-SË

PROFESORI NË UBT, VISAR KRELANI DOKTORON NË POLITEKNIKUN E MILANOS



24 korrik. - Dr.Visar Krelani, mësimdhënës në UBT, ka mbrojtur temën dhe ka marrë titullin doktor shkence, në Politeknikun e Milanos.

Ai ka doktoruar në temën "Afërsia vetëshëruuese e kompoziteve të çimentos" ("Self-Healing Capacity of Cementitious Composites"), e cila është realizuar falë një bashkëpunimi ndërkombëtar ndërmjet Politeknikut të Milanos në Itali dhe Universitetit Federal të Rio de Janeiros në Brazil.

Politekniku i Milanos, një institucion me renome të lartë në botë, këtë vit është konfirmuar në vendin e 13-të në botë në drejtimin e Inxhinierisë së Ndërtimit, ku ka doktoruar Dr.Krelani.

Kërkimet e realizuara gjatë doktorimit ai i ka paraqitur në disa konferenca, si në SHBA, në Kanada, në Belgjikë, në Brazil, në Itali etj. Gjithashtu, ai do të vazhdojë edhe më tutje kërkimet në këtë fushë.

Dr.Visar Krelani është profesor i rregullt në Departamentin e Ndërtimtarisë dhe Infrastrukturës në UBT. Semestrin e kaluar ai ka ligjësuar lëndën Materialet në Arkitekturë në Departamentin e Arkitekturës.

Arben Çitaku e mbrojtë temën Master në MBE

27 korrik. - Arben Çitaku, duke paraqitur temën "Ligji i Prokurimit Publik të Kosovës: Analizë

krahasuese, para komisionit të përbërë nga dr.Ibrahim Krasniqi, dr. Ylber Limani e dr. Nehat Ramadani, mori titullin master në MBE.

Tema e Masterit trajtoi një varg çështjesh interesante të ndërlidhura me ligjin e prokurimit, zhvillimin, ndryshimet, si dhe efektet e këtij ligji në ekonominë kosovare. Hulumtimi kishte një karakter metodologjik krahasimor, duke bërë analizë krahasimore të ligjit të prokurimit publik të shteteve të regionit. Rezultatet e hulumtit japin një pasqyrë reale dhe një metodë praktike për zbatimin e këtij ligji. Kjo metodë mund të jetë kontributdhënëse për palët e interesit si dhe një kontribut i rëndësishëm në përshpejtimin e njohurive në këtë fushë.

Armir Morina e mbrojtë temën Master në MBE

27 korrik. - Studenti i UBT-së, Armir Morina ka marrë titullin master në MBE, pas paraqitjes dhe mbrojtjes së temës "Menaxhimi i transportit hekurudhor: Kosova krahasuar me regjionin", para komisionit të përbërë nga dr.Ibrahim Krasniqi, dr. Ylber Limani e dr.Nehat Ramadani.

Tema e Masterit trajtoi rolin e transportit hekurudhor në ekonominë e vendeve të ndryshme, duke u fokusuar më tutje në rastin e regionit dhe duke e specifikuar transportin hekurudhor të Kosovës. Rezultatet e hulumtit

tregojnë se, përkundër disa përpjekjeve me anë të ndryshimit të disa rregulloreve, ende nuk ka ndonjë produktivitet nga shfrytëzimi i hekurudhës për transportin e mallrave dhe të njerëzve.

Duke e marrë parasysh se transporti është një ndër sistemet më komplekse dhe një ndër shtyllat për zhvillim ekonomik të shumë vendeve, ky hulumtim sjell disa rekomandime të fuqishme që do të duhej përfillur hekurudha e Kosovës, menaxhmenti dhe qeveria, në mënyrë që, krahas planit për zhvillimit strategjik, të zhvillohet edhe sistemi hekurudhor i cili propozohet të mund të luajë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit.

Kushtrim Klaiqi e mbrojtë temën Master në MBE

27 korrik. - "Mbledhja e të hyrave publike" është tema të cilën e paraqiti Kushtrim Klaiqi, i cili fitoi titullin master në MBE në UBT.

Mentor i temës ishte Bernard Dosti, ndërsa në komision ishin dr.Ylber Limani e dr.Nehat Ramadani.

Tema e Masterit vlerësohet të jetë një kontribut në lëmin e auditimit, kontabilitetit dhe tatimeve. Punimi hulumtues kishte për qëllim që të sjellë praktikën e vlerësimit për të deklaruar detyrimet tatimore për të gjitha llojet e obligimeve.

Shumica e legjislacionit bazë është prezantuar duke shtruar problematikën në formë të pyetjeve dhe përgjigjeve. Gjithnjë duke qenë i njohur me shumicën e problematikave më të shpeshta në jetën praktike (të përditshme). krizave financiare. Rezultatet e dala nga ky hulumtim janë rekomandimet e fuqishme që i jepen institucioneve përgjegjëse, bizneseve dhe individëve mbi rëndësinë e njohjes së nevojës për të mos u shmangur tatimeve.

Nebahate Maçastena e mbrojtë temën Master në MBE

27 korrik. - Kandidatja Nebahate Maçastena e ka fituar titullin master në MBE, duke e mbrojtur temën "Ndikimi i reputacionit të OJQ-ve në vendimmarrjen e donatorëve".

Mentor i temës ishte prof. dr.Edmond Hajrizi, ndërsa në komision ishin dr.Ylber Limani e dr.Nehat Ramadani.

Hulumtimi i bërë në këtë temë trajton arsyen e ekzistimit të OJQ-ve, ndikimin e tyre në ekonomi, relacionin e tyre me bizneset, rrjetin e OJQ-ve si dhe aspektet e tjera menaxheriale, siç është marketingu dhe roli i tij në aktualizimin dhe vendosjen e raporteve të duhura në mes të OJQ-ve dhe donatorëve.

Si rezultat i punimit del që realizuesit e aktiviteteve të marketingut dhe ato aktivitetet duhet përmirësuar në mënyrë që ato të e paraqesin vlerat e OJQ-ve.

Violeta Alidema e mbrojtë temën Master në MBE

Kandidatja Violeta Alidema nga Fakulteti Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në UBT mbrojtë temën "Ndikimi i Konventës PanEuro Meditarane në Ekonominë Kosovare", me të cili mori titullin Master. Mentor i temës së saj ishte Dr. Ylber Limani.

Autorja trajtoi ndikimin e Konventës Pan Euro Meditarane, e cila ka të bëjë me tregtinë e lirë dhe luan një rol të rëndësishëm në ekonominë e Kosovës. Konventa Pan Euro Meditarane është një marrëveshje shumë e rëndësishme dhe tregues i rëndësishëm nëse do të unifikohen rregullat e origjinës në të gjitha vendet, dhe Kosova do të jetë përfituese e kësaj marrëveshjeje. Në temë është bërë një studim i

hollësishëm i mundësive të realizimit të kësaj konvente dhe të rreziqeve nëse ajo nuk realizohet.

Studenti Pleurat Konjufca e mbrojtë temën Master në MBE

"Financimi i biznesit në Kosovë: Ndikimi i bankave komerciale në zhvillimin e NVM-ve në Kosovë" është tema me të cilën studenti Pleurat Konjufca fitoi titullin Master në Fakultetin e Menaxhmentit, Biznesit dhe Ekonomisë në UBT. Qëllimi i këtij punimi ishte sqarimi dhe kuptimi i ndikimit të bankave komerciale në zhvillimin e biznesit të vogël dhe të mesëm në Kosovë. Hulumtimi vë në pah vështirësitë që kanë bizneset kosovare në financim si dhe jep një pasqyrë për mundësitë që kanë bankat komerciale në tejkalimin e këtyre vështirësive. Në përfundim të hulumtit janë nxjerrë konkluzione dhe rekomandime të dobishme për bizneset dhe për bankat komerciale.

Shemsi Ahmeti e mbrojtë temën Master në MBE

Në Fakultetin për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi kandidati Shemsi Ahmeti mbrojtë temën master, me titull "The Impact Of Innovations The Value Chain Of the Organizations". Mentor i temës ishte Dr.Sc.Ylber Limani.

Tema trajtoi rëndësinë e inovacioneve, rolin dhe rëndësinë e zinxhirit të vlerës për organizatat, mënyrën se si organizatat apo ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në Kosovë mund të veprojnë dhe të risin vlerën e zinxhirit të tyre në mënyrë që të kenë një impakt apo një reaksion kthyes në inovacione dhe anasjelltas.

ULPIANA EMRA



**MENAXHMENT, BIZNES
DHE EKONOMI**

KONFERENCA "DITA AUSTRIAKE-KOSOVARE E TREGUT TË PUNËS 2015"

PËRGATITJA E KUADROVE NË HARMONI ME KËRKESAT E TREGUT TË PUNËS RRIT SHKALLËN E PUNËSIMIT DHE UL KËRKESAT PËR LARGIM NGA VENDI

10 dhjetor 2015. - Dëshira e qytetarëve për t'u larguar nga Kosova ka shënuar një rritje të dukshme, që nga shpallja e pavarësisë e deri sot. Të dhënat e një anketimi tregojnë se, nëse atëherë dëshironin të largoheshin rreth 24 për qind e qytetarëve, sot kjo përqindje është rreth 37 për qind.

Kjo e dhënë, së bashku me të dhënë se çdo vit tregut të punës në Kosovë i shtohen rreth 36 mijë të rinj, prej të cilëve vetëm rreth tetë mijë mund të gjejnë vende pune dolën gjatë debateve në konferencën "Dita Austriake-Kosovare e Tregut të punës 2015", e organizuar nga UBT dhe Shoqata Austriake-Kosovare.

Konferenca në të cilën folën Andrew Russel, përfaqësues i UNDP-së në Kosovë, prof.dr.Edmond Hajrizi, rektor i UBT-së, Mimoza Nagavci nga WIFI Shqipëria, Donika Emini nga Qendra Kosovare për Studimet e Sigurisë, Leon Malazogu nga Instituti D4D, Armend Muja, profesor në UBT, Besian Bicurri nga IOM-i dhe folës të tjerë, nxori ndër të tjera si konkluzion se zvogëlimi i shkallës së papunësisë në Kosovë, si edhe krijimi i kuadrove adekuatë për tregun e punës në vend mund të bëhet



vetëm me atëherë kur profilet që zgjedhin për të studiuar të rinjtë i përgjigjen kërkesave të tregut e jo dëshirave shumë herë të paarsyeshme të familjarëve apo të vetë studentëve për të zgjedhur për të studiuar një drejtim në të cilin numri i të diplomuarve që presin punë është shumë i madh.

Përfaqësuesi i UNDP-së në Kosovë, z.Russel paraqiti një varg të dhënash nga puna e organizatës që ai drejton, aktivitetin e shumënduarshëm në Kosovë dhe të dhëna të ndryshme, si për lëvizjet e popul-

lisë, ashtu edhe për mundësitë e qytetarëve për punë.

Rektori UBT-së theksoi një varg përparësish dhe elementesh që e bëjnë atraktiv edukimin e nivelit akademik në Kosovë. Ai tha se UBT, si shkolla më e lartë e teknologjisë në Kosovë dhe në rajon, kujdeset në vazhdimësi që studentëve t'u ofrojë programe akademike, të cilat ata i përgatisin për të qenë konkurrues dhe dominues në tregun e punës.

Ndërsa Mimoza Nagavci nga WIFI Shqipëria, që funksionon

në bashkëpunim të ngushtë me institucionin me emër të njëjtë në Austri, përcolli përvojat e punës, sidomos në Shqipëri, nga viti 2000 e deri sot. Me theks të veçantë ajo përmendi trajnimet dhe certifikimet e ndryshme të ofruara në profesione specifike, siç është profesioni i salduesit, që ka dalë të jetë një profesion mjaft atraktiv, madje dhe për femra.

Përfaqësuesi nga IOM-i, Besian Bicurri theksoi një të dhënë interesante, sipas së cilës vetëm 40 për qind e emigrantëve në gjithë botën vijnë nga vendet e varfra, ndërsa 60 për qind janë nga vendet e zhvilluara, njerëz që ndërrojnë vendbanim, në kërkim të një jete tjetër.

Ai gjithashtu theksoi përfitimet që ka Kosova nga mjetet që vijnë nga kosovarët që ndodhen jashtë vendit, të cilët dërgojnë rreth 500 milionë euro, në transfere të ndryshme, pa llogaritur mjetet që i dërgojnë drejtpërdrejt në familje, që i bie se mjetet e dërguara janë shumë më shumë se të dhënat zyrtare.

Profesori në UBT, Armend Muja paraqiti një varg të dhënash lidhur me qëndrimet e qytetarëve të vendit tonë rreth largimit nga Kosova për një jetë më të mirë në shtete

të tjera. Ai theksoi se përqindja e atyre që duan të ikin është shumë e madhe dhe i çuditshëm është fakti se nuk duan të ikin vetëm ata që janë të papunë, por në shumë raste edhe ata që kanë një punë, për të cilën madje edhe janë të paguar mirë.

Z. Muja theksoi se, megjithëse ka pasur një rritje ekonomike, në Kosovë nuk janë krijuar vende të reja puna dhe kjo ka ndikuar që hendeku mes të varfërve dhe të pasurve të thellohet edhe më tej. Duke folur në temën e papunësisë, ai theksoi se zyrtarisht shkalla e papunësisë në Kosovë është 32 për qind, porse shkalla e papunësisë mes të rinjve është shumë e lartë dhe shkon deri në 60 për qind.

Por, tërhoqi vërejtjen ai, papunësia lidhet shumë me shkallën e arsimimit, që i bie se shkalla e papunësisë te të pashkolluarit është shumë më e lartë dhe kjo përqindje bie tek qytetarët me shkollim më të lartë. Ai gjithashtu tërhoqi vëmendjen se shkollimi duhet të shkojë paralel me nevojat e ekonomisë, duke mos krijuar kuadro në profilet për të cilat nuk ka treg të punës, por për profilet për të cilat ende ka kërkesë të shtuar të tregut të punës.

STUDENTI I UBT-SË, ATDHE BUJA NË PROGRAMIN TRAJNUES PESËMUJOR NË JAPONI



Atdhe Buja, student në UBT në nivelin master, po merr pjesë në një program trajnues pesëmuor në Japoni.

Trajnimi është ofruar në kuadër të programit zhvillimi i asistencës nga qeveria japoneze, në JICA Okinawa International Center të Japonisë. Trajnimi ka të bëjë me CIO "ICT for the improvement of government capacity and services: information system, security, and strategy (C)", i ofruar për Qeverinë e Republikës së Kosovës, respektivisht Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit. Në këtë program marrin pjesë përfaqësues nga shtetet si Namibia, Botsuana, Ruanda,

Iraku, Kosova, Palau e të tjerë. Ky program është i dizajnuar për qeveritë dhe për organizatat qeveritare që përdorin ICT për ofrimin e shërbimeve. Ky trajnim synon të arrijë që secili pjesëmarrës të jetë i aftë në udhëheqjen, zhvillimin e strategjisë së TIK-ut dhe zgjerimit të biznes proceseve. Gjatë këtij trajnimi zhvillohen edhe aktivitetet të tjera si festivali ndërkombëtar, prezantimet e kulturës së shteteve pjesëmarrëse.

Republika e Kosovës është duke u përfaqësuar denjësisht nga z. Buja, i cili ka prezantuar vendin në të gjitha këto aktivite.

NË UBT U MBAJT KONFERENCA "SUNDIMI I LIGJIT NË DRITËN E RAPORTIT TË PROGRESIT 2015"

AMBIENTI JURIDIK PËRMIRËSOHET ME PËRGATITJE TË MIRËFILLTË AKADEMIKE



Organizuar nga UBT dhe Shoqata Austriako-Kosovare, në kampusin inovativ të UBT-së i zhvilloi punimet konferenca "Sundimi i Ligjit në dritën e Raportit të Progresit 2015", e cila mbledhi numër të konsiderueshëm të pjesëmarrësve nga fusha e praktikës gjyqësore, jetës politike dhe shoqërisë civile.

Konferenca u hap nga dekani i Fakultetit Juridik, Dr. Ardian Emiri, i cili falënderoi të pranishmit për bashkëpunimin dhe i siguroi për përpjekjet e stafit të UBT-së për përgatitje superiore të studentëve të drejtësisë, me qëllim që ata të shërbejnë në fushën e drejtësisë.

Kryetari i Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës, Enver

Peci theksoi gjatë diskutimit të tij një varg sfidash me të cilat përballat gjyqësori në vendin tonë, duke nënvizuar si një nga sfidat më të dukshme numrin e vogël të gjyqtarëve në gjykatat e rregullta.

Ai gjithashtu theksoi përkushtimin e Këshillit Gjyqësor për përmirësimin e imazhit të gjyqësorit në Republikën e Kosovës.

Ndërsa, avokati i popullit, Hilmi Jashari paraqiti aspekte të punës së institucionit që ai drejton dhe që ndërlidhen në masë të madhe me drejtësinë.

Z. Jashari gjithashtu theksoi se studentët duhet të fitojnë përgatitje të mirëfilltë akademike,

me qëllim të përmirësimit të ambientit juridik për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Ilir Deda, deputet i Parlamentit të Republikës së Kosovës, ndër të tjera, inkurajoi studentët për aktivizëm politik e social, me qëllim të krijimit të një mjedisi të barabartë për të gjithë.

Në anën tjetër, Vjosa Osmani, po ashtu deputete e Parlamentit të Republikës së Kosovës, foli para studentëve për rëndësinë e shtetit ligjor dhe mekanizmat proceduralë e kontrollues të Parlamentit karshi Qeverisë edhe vet Gjyqësorit.

Dafina Buqaj, këshilltare e lartë e Ministrit të Drejtësisë, Hajredin Kuçi, foli për punën e Ministrisë së Drejtësisë në çështjet e organizimit të sistemit prokurorial dhe gjyqësor, si dhe rolin aktiv të Ministrisë në përmirësimin e legjislacionit ekzistues si dhe sponsorimin e ligjeve të reja me qëllim të përmbushjes së standardeve evropiane. Ndërsa avokati Taulant Hodaj paraqiti para të pranishmëve shpjegime nga fusha e praktikës gjyqësore dhe theksoi rëndësinë e përmirësimit të procedurave gjyqësore në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

FLASIN STUDENTËT E VITIT TË PARË, DREJTIMI MEDIA DHE KOMUNIKIM


UBT – NJË MUNDËSI E MADHE PËR DIJE DHE KARRIERË NË GAZETARI



Alban Hoxha



Gresa Rexhepi



Adona Kullashi



Endrit Gashi



Besarta Breznica



Fortesa Doqi



Qemajl Gashi



Shpetim Reçica



Rinesa Bytyçi



Leotrim Canaj

Që UBT është institucion i nivelit të lartë të arsimit është vërtetuar edhe nga të rinjtë që i janë bashkuar këtij tempulli të dijes që e mban piedestalin e të parit në rajon.

Nga 10 studentët e anketuar të drejtimit Media dhe Komunikim në UBT, kemi kuptuar që arsyeja pse ata kanë zgjedhur të studiojnë në UBT ka qenë cilësia dhe imazhi pozitiv që ka krijuar ndër vite ky institucion.

Besarta Breznica, studente e vitit të parë në drejtimin Media dhe Komunikim, ka thënë për “UBT News” se tash kanë kaluar dy muaj dhe është tejet e kënaqur me sjelljen e gjithë stafit të UBT-së, me njohuritë e profesorëve dhe me kushtet që më ofron ky fakultet.

“Menjëherë pasi përfundova shkollën e mesme u gjenda në shumë udhëkryqe dhe shumë pyetje më vinin në mend. Ku do të vazhdoja studimet? Cili universitet do t’i plotësonte kushtet për mësim? Ku do të kisha hapësirë të mjaftueshme për ta dëshmuar veten?”

Pas disa ditë hulumtimesh në të gjitha Institucionit e Arsimit të Lartë e vetmja që iu përgjigj të gjitha pyetjeve të mia dhe ishte e gatshme t’i ofronte të gjitha gjërat që unë kërkoja ishte UBT. Vendosa që të aplikoja dhe të shikoja se si zhvillohet procesi mësimor, sa janë të gatshëm të më përgjigjen në kërkesat e mia. Tash kanë kaluar dy muaj dhe unë jam tejet e kënaqur me sjelljen e gjithë stafit të UBT-së, me njohuritë e profesorëve dhe me kushtet që më ofron ky fakultet. Në këto tri vite studime që do t’i kaloj në UBT pres të marrë njohuri të mëdha në drejtimin të cilin e kam zgjedhur dhe të jem e aftë praktikisht për të punuar në gjërat që më kërkohet”, thotë Besarta.

Për disa nga ta bashkëpunimi i UBT-së me universitetet ndërkombëtare ka një rëndësi të madhe.

“Ka shumë arsye pse unë e kam zgjedhur UBT-në, duke filluar nga cilësia që ka ky institucion, pastaj nga mundësitë e shumta që i ofron për punë praktike dhe një ndër arsyet kryesore është sepse UBT të ofron mundësi për t’i vazhduar studimet jashtë vendit, ngase ka marrëveshje me shumë universitete të ndryshme botërore”, shprehet studentja e vitit të parë Fortesa Doqi.

E pyetur çka pret nga studime në UBT, ajo përgjigjet: “Unë si studente shumë ambicioze dhe e gatshme që profesionin e gazetarisë ta perfeksionoj në piedestalin më të lartë, pres që nga studimet bazike t’i mësoj elementet bazë që duhet t’i dijë një gazetar, të mësoj dhe të praktikoj njëkohësisht punën, mënyrën dhe zhvillimin e gazetarisë ndër vite. Dhe të gjitha këto shpresoj që t’i arrij në bashkëpunim të ngushtë me kolegë dhe profesorë në mënyrën më të mirë të mundshme. Dhe pas përfundimit të studimeve të dal një gazetar e përgatitur mirë në profesionin tim”.

“Gazetaria ka qenë gjithmonë një profesion që më ka pëlqyer qysh në fëmijëri. Që në shkollë fillore, duke u motivuar edhe nga mësuesja e gjuhës shqipe, fillova të mendoj seriozisht për gazetarinë. Pas përfundimit të shkollës së mesme, fillova të merrem shumë me shkrime dhe me portale të ndryshme, ku filloi të më “flinte në shpirt” të shkruarit për ngjarje të ndryshme, të qenit në rrjedhë me ndodhitë, raportimi për to dhe njoftimin e njerëzve rreth tyre. UBT mendoj se i ofron të gjitha kushtet e nevojshme që ne të arrijmë qëllimin tonë, të qenit gazetar i vërtetë, prandaj zgjedha që të studioj këtu.

Në UBT ke më shumë hapësirë për ta treguar veten, ke më shumë bashkëpunim me profesorët dhe të ofrohen më shumë metoda për t’u mësuar për të shkruar, raportuar dhe hulumtuar”, shprehet ndërkaq studenti Endrit Gashi.

“Nga këto tri vite studim pres që unë të arrij rezultate të mira akademike në UBT, të avancoj më shumë drejt profesionalizmit gazetaresk dhe të përcaktohem për një fushë të veçantë të gazetarisë, në të cilën do të punoj pas përfundimit të shkollimit në UBT. Besoj që përpara kemi shumë sfida, por të cilat me përkushtim do të arrijmë t’i tejkalojmë dhe t’i përfundojmë ashtu siç duhet”, thotë ai.

Sipas studentëve të këtij drejtimi ajo çka e bën që UBT të dallohet nga institucionet e tjera është stafi i kualifikuar dhe gatishmëria e profesorëve që në çdo kohë të zhvillojnë orë shtesë për të ofruar sa më shumë dije për studentët.

“Në UBT pres që të marr njohuri akoma më shumë se këto që i posedoj tani dhe besoj shumë se do t’i kem sepse të ardhmen time ia kam besuar UBT-së me profesorë të shkëlqyer. E di që pas përfundimit të studimeve unë do të jem në vendin ku e meritoj”, thotë studentja Gresa Rexhepi.

Duke shpjeguar dilemat që kishte para fillimit të studimeve, ajo thotë se dilemat u hoqën kur e zgjedhi UBT-në. “Unë e zgjedha UBT-në, sepse është një leadership i mundësive të reja. Të ofron kushte të cilat janë shumë bashkëkohore”, thotë ajo.

“Unë zgjedha gazetarinë sepse më pëlqen të shkruaj, më pëlqen të hulumtoj, madje më pëlqen edhe të flas shumë. Më së shumti kam dëshirë të shkruaj për realitetin, për ngjarjet që ndodhin në vendin tonë, e që çdo ditë e më tepër bëhen me misterioze e më

interesante. UBT-n e zgjedha pavarësisht dy herë. Është njëri ndër institucionet e arsimit të lartë më të mira në vendin tonë. Ka plot perspektivë, aktivitete, dhe të jep shumë mundësi që në të ardhmen të jesh një student i suksesshëm”, thotë studentja Rinesa Bytyçi. Ajo pret që të marrë dije, përvojë, por edhe nota të mira gjatë studimeve.

Për “UBT News” ka folur edhe studentja Adona Kullashi.

“Zgjedha UBT-në dhe nuk u zhgënjeha, sepse këtu i gjeta të gjitha, duke përfshirë stafin profesional, frymën studentore, kolegialitetin e përsosur, pasurimin e bibliotekës me literaturë të bollshme dhe infrastrukturën moderne”, thotë ajo dhe shton se në UBT punohet në grupe apo në mënyrë të pavarur, për t’u ofruar siguri dhe vetëbesim për të qenë të gatshëm të përballemi me sfidat e kohës menjëherë pas viteve të studimit.

Duke u bazuar në ligjërime dhe në aftësimin tonë nga ana e profesorëve, me profesionalizmin që do ta fitoj në UBT, unë besoj se për këto tri vite studimi do t’i marr hapat e parë të jetës së pavarur, me shpresën e punësimit në vend adekuat, shprehet Kullashi.

Ndërsa studenti Shpetim Reçica thotë se përkrahja dhe angazhimi i gjithë stafit të UBT-së i jep vullnetin pozitiv për vazhdimin e studimeve. “Vlerësimet korrekte pa dallime, trajtimet e temave të nevojshme edhe jashtë planprogramit ditor, gatishmëria e profesorëve për të qenë të hapur me ne për debat edhe pas ligjëratave. Këto gjëra më bëjnë të ndihem i privilegjuar që gjendem këtu dhe besoj që do të jenë tri vite mjaft të bukura të cilat do ti kujtoj me shumë nostalgji”, thotë ai.

Studenti Alban Hoxha thotë se që t’i drejtohet UBT-së e kanë bin-

dur programi studimor, mundësia për praktikë profesionale me kushte evropiane dhe serioziteti i madh që ofron UBT.

I pyetur çka pret nga studimet në UBT ai është shprehur: “Me të vërtetë pres shumë nga ky drejtim, pres që të bëhem gazetar profesionist, gjithnjë me përkushtimin më të madh ndaj këtij drejtimi. Falë UBT-së do të kem mundësi të arta që të bëhem gazetar profesionist, sepse këtë profesion vërtet e dua. Kam besim të madh që në fund do të arrij të pasuroj aftësitë e mia si një gazetar i gatshëm për një karrierë profesionale gjatë përvojës së fituar nga praktika dhe ligjërimi i një modeli të moderuar dhe evropian”.

Një mik i tij i ka përfunduar studimet në UBT dhe ka shënuar suksese të mëdha në karrierë dhe kjo e ka bindur Qemajl Gashin që të nisë studimet në UBT.

Nga studimet ai pret shumë përkushtim nga vetja si student i drejtimit të gazetarisë, ngase ky fakultet ka cilësi të madhe të mësimdhënies dhe pasi ta përfundoj pres që të punësohem në ndonjë medium dhe të tregoj shumë sukses.

Duke folur rreth motive pse zgjedhi UBT-në për të studiuar, Leotrim Canaj shprehet: “Mua më pëlqen të studioj, sepse marr njohuri me të cilat do ta ndërtoj të ardhmen time dhe qëllimet e mia. Të marrësh njohuri do të thotë të bëhesh njeri i ditur, i përgjegjshëm, i aftë për të kaluar çdo sfidë, të bëhesh një njeri me kulturë. Për këtë arsye u drejtova në dyert ku isha i bindur se po zgjedhja një vend studimi ku këto të gjitha mund t’i përbushë dhe normalisht që programi i UBT-së më bindi që ta zgjedhë atë”.

ANKETOI: A.ZENELI

SHËNIME

RRJETET SOCIALE: LIDERËT DHE PUBLIKU

SAFET ZEJNULLAHU

Rrjetet sociale, Facebook, Twitter e të tjera, në kohën moderne, janë bërë një mjet i ri dhe i thjeshtë i komunikimit midis njerëzve. Asgjë e keqe në këtë mes. Por, kur këto rrjete sociale bëhen mjet kryesor i komunikimit midis zyrtarëve dhe udhëheqësve shtetërorë dhe medias, midis udhëheqësve dhe qytetarëve – këtu çështja ndryshon rrënjësisht.

Liderët më të mëdhenj botërorë i shfrytëzojnë rrjetet sociale për komunikim të drejtpërdrejtë me publikun. Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Barak Obama, ta zëmë, ka rreth 65.5 milionë ndjekës në llogarinë e tij në Twitter, Papa Françesku rreth 20 milionë ndjekës, kryeministri britanik, Kamerun, më i ndjekuri në Evropë, ka mbi tre milionë ndjekës.

Në Republikën e Kosovës, zyrtarët shtetërorë, shumica prej tyre, përdorin rrjetet sociale si mjet komunikimi. Presidentja, kryeministri, ministri i jashtëm, ish-presidentë e zyrtarë më të ulët shërbehen në punën e tyre me rrjete sociale. Por, ky komunikim i tyre ka nxjerrë shumë probleme, që nga llogaritë false e deri te keqpërdorimi i rrjeteve sociale për goditje të ulëta.

Përdorimi i rrjeteve sociale nga politikanët ngre shumë pikëpyetje: Kur duhet të komunikohet me publikun përmes tyre? A duhet kaluar edhe komunikimi zyrtar në rrjetet sociale? Cili është vendi/roli i mediave në këtë formë komunikimi? Kush duhet t'i menaxhojë ato? Çfarë të bëhet me komentet e qytetarëve ndaj postimeve të politikanëve?...

E sotmja dhe e ardhmja e komunikimit zyrtarë shtetërorë-qytetarë janë rrjetet sociale. Por, sot, defektet në këtë komunikim janë shumë të mëdha.

Facebook-u dhe zyrtariteti

Thamë se Barak Obama ka mbi 65.5 milionë ndjekës në Twitter (3 nëntor 2015). Por, çka publikon ai në llogarinë e tij në Twitter? Foto-grafi dhe mesazhe të shkurtra nga aktivitetet e përditshme si president i shtetit më të fuqishëm në botë. Me kaq shumë ndjekës, ky lloj komunikimi mund të quhet efektiv dhe i dobishëm. Por, prapë Obama ka një ueb-faqe zyrtare si President i SHBA-së ku publikohen në detaje aktivitetet, takimet e rëndësishme. Publikohen qëndrimet zyrtare të institucionit që ai drejton. Domethënë, zyrtariteti mbetet te ueb-faqja zyrtare.

Edhe Papa Françesku, edhe kryeministri britanik Kamerun ndajnë përmes këtij kanali të komunikimit momente të veçanta, së pari me ndjekësit e tyre, pastaj me gjithë opinionin. Por, edhe këta, qëndrimet zyrtare i paraqesin në kanalet zyrtare të komunikimit, pjesë e institucioneve që u takojnë dhe të cilat menaxhohen nga stafe profesioniste të përbëra nga ekspertë të teknologjisë informative dhe gazetarë profesionistë.

Faqe në facebook dhe në Twitter kanë edhe shumica e politikanëve në Kosovë. Më aktiv i në këtë fushë

është ministri i jashtëm, Hashim Thaçi. Në fillim të nëntorit 2015 ai ka 273.928 miq në Facebook. Por, njëkohësisht, mijëra miq kanë edhe shumë llogari të tjera në këtë rrjet social, që janë në emër të tij, por që nuk menaxhohen nga ai.

Z.Thaçi është më transparent, për faktin se publiku e di kush ia mirëmban llogarinë në Facebook. Zëvendësi i tij në ministri, madje është dalluar nga mediat ndërkombëtare si një nga prijatarët e diplomacisë digjitale në rajon.

Facebook-u dhe falsiteti

Mjaft aktive në rrjetet sociale është edhe Presidentja Jahjaga. Në fillim të nëntorit 2015 ajo i ka 118.485 miq në Facebook. Në llogarinë e saj ajo preferon të publikojë të gjitha njoftimet nga aktivitetet që kryen, të cilat paraprakisht publikohen edhe në ueb-faqen zyrtare.

Por, në Facebook ka me dhjetëra llogari, me emër e me fotografi të Presidentes, por të cilat nuk menaxhohen prej saj.

E në këtë fushë, rasti më eklatant është ai i ministrit të Drejtësisë, Hajredin Kuçi. Jo moti, mediat patën cituar një deklaratë të tij të marrë nga Facebook-u. Por, në fakt, doli se ministri Kuçi nuk ka fare llogari në këtë rrjet social. Megjithatë, edhe këto ditë, mund të shohim se ka së paku 14 llogari në Facebook në emër të tij, ku publikohen fotografi të ndryshme të ministrit tek përshëndet qytetarët me "Si jeni sot" apo "Ju përshëndes të gjithëve sot" ose kur ai uron për ndonjë sukses në politikë apo në sport!

Madje, në këto llogari të rreme ka njerëz që përpiqen të komunikojnë me ministrin për halle të ndryshme të tyre. Një prej tyre shprehet shumë i nevrikosur me ministrin pse i paska shkruar me dhjetëra herë e ai nuk ia paska kthyer përgjigje!

Facebook-u dhe profesionaliteti

I cituar me një deklaratë në Facebook ishte edhe ish-Presidenti Fatmir Sejdiu. Mediat online e botuan një tekst, sipas të cilit, z.Sejdiu u bën thirrje të gjithë banorëve të Kosovës që të lartohen prej saj.

"Ish-presidenti i Kosovës, Fatmir Sejdiu përmes një postimi në rrjetin social Facebook u ka bërë thirrje të rinjve të vendit që të dalin ilegalisht jashtë vendit për një jetë më të mirë, pasi që siç thotë ai, vendi po kontrollohet nga partitë mafiozo-politike.

Sejdiu i cili aktualisht jeton në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, po ashtu ka shkruar se shpreson që mos të kthehet kurrë në Kosovë, vend ky i udhëhequr nga këto parti.

Lexoni postimin e plotë të Sejdiut:

"Shpresoj që nuk do të kthehem kurrë në Kosovë sidomos në ato vende ku vendi kontrollohet nga partitë MAFIOZE politike që tash e shumë vite kanë marrë kontroll në shtetin tonë. Popull i dashur, shumë më mirë e keni të vazhdoni në mërgim në rrugët ilegale se të rinin në një shtet të cilin as ju nuk e dini se a do të bëhet mirë apo jo. Por kjo është një pyetje që të gjithë që janë me pozita të larta në Shtetin e Kosovës ose kanë qenë e dinë dhe po ju them që edhe 20 vite Kosova nuk ka me pas të ardhme por do të vazhdoj

si tani por do ketë disa vjet që do të jete edhe më keq. Mashtrimi i madh i liberalizimit të vizave u jep vullnet popullit që të presin edhe pak por sipas informatave që kam unë edhe 8 vjet minimum nuk mund të bëhet aplikimi për liberalizim të vizave nga Shteti i Kosovës mos pritni kot. Bëj thirrje të gjithë Shqiptarëve të Kosovës të cilët janë në kushte jo të mira dhe ju nevojitet shpresë, vazhdoni në mërgim e mos pritni për ndryshime nga partitë Mafiozo-Politike nuk keni me pa asnjëherë ndryshime po ju garantoj me fjalën time".

Ky është një lajm (i përcjellë këtu pa ndërhyrje), që ngre shumë pikëpyetje mbi përdorimin e drejtë të rrjeteve sociale në Kosovë. Edhe më keq, ngre shumë dyshime mbi profesionalitetin e portaleve të lajmeve, që, deshëm apo nuk deshëm, po bëhen dita-ditës burim kryesor i informimit.

Të gjithë ata që janë prezentë në media dhe në politikë, me një lexim krejt sipërfaqësor, do ta kuptonin se ky nuk është një tekst i dr.Sejdiut. Si përmbajtje – assesi, por edhe si stil i të shkruarit.

Asnjëra nga portalet që e publikoi këtë tekst nuk e mori mundimin ta kontaktojë ish-presidentin dhe për ta pyetur lidhur me këtë postim. E morën si lajm të vërtetë. Vetëm kur dr.Sejdiu reagoi dhe shpjegoi se llogaria e tij në Facebook ishte sulmuar dhe ishte marrë në menaxhim nga persona të panjohur, portalet e bënë edhe këtë lajm. Por, nuk e bënë atë që duhej bërë. Nuk e hoqën nga qarkullimi lajmin e parë. Atë të rremin.

Në vrap për lajme sa më të shpejta, këto portale e huqën në këtë rast, sikur edhe në shumë raste të tjera, parimin bazë që, për lajm të plotë, gjithsesi duhet të kesh brenda tekstit të dy palët.

Po sjell një shembull të përkushtimit për të qenë të saktë në lajm, edhe pse koha kur është zhvilluar ngjarja dhe lajmi ka lejuar mundësinë që fare të mos kërkohet ajo që në gazetari njihet si "ana tjetër".

Më 31 mars 1999 nuk kishte Facebook. Vetëm pak familje kishin internet nëpër shtëpitë e banesat e tyre, që të mund të dërgonin e-maile. Në këtë ditë, në një lagje të Prishtinës ishte shpërndarë një njoftim në një letër të formatit A4, të printuar me ngjyra. Në të u bëhej thirrje banorëve të Prishtinës që sa më parë të largoheshin nga qyteti dhe të nise-shin për në Maqedoni. Sipas letrës, porosinë e jepnin Ushtria Çlirimtare e Kosovës (e shkruar në krye të faqes) dhe Presidenti i Kosovës, dr.Ibrahim Rugova (emri i tij i shkruar në fund të faqes, pasi i mbaronte porosia).

Edhe pse ishte shumë e qartë se një gjë të tillë nuk mund ta thoshte UÇK, që po zhvillonte luftë jashtë Prishtinës, as dr.Ibrahim Rugova që ndodhej në shtëpinë e tij dhe që u zu peng po ato ditë, autori i këtij punimi dhe këshilltari për media i z.Rugova, publicisti Xhemal Mustafa, gjetën mënyrë për ta siguruar atë letër dhe për pyetur dr.Rugovën për veprimin e mëtejme.

Të njëjtën natë, në Televizionin Shqiptar u transmetua lajmi i përcjellë me vështirësi deri atje se fjala

ishte për një manipulim të pastër të serbëve, që edhe ashtu po e zbraznin qytetin, por që njëkohësisht dëshironin të përlulnin edhe UÇK-në edhe dr. Rugovën.

Ishte kohë kur për një veprim të tillë shkonte koka. Por, gazetarët nuk janë gazetarë nëse për profesionin nuk bëjnë edhe sakrifica të kësaj natyre.

Facebook-u dhe gjuha

Përmendëm faktin se udhëheqësit politikë i kanë kthyer rrjetet sociale në formë parësore të komunikimit me publikun. Por, shumë prej tyre, gjithsesi në faqet zyrtare që menaxhohen prej tyre, nuk përfillin rregullat elementare të komunikimit. Derisa ata janë zyrtarë, derisa edhe komunikimin në rrjete sociale e kanë ngritur në nivel të komunikimit zyrtar – është elementare që të respektohen rregullat e drejtshkrimit të shqipes, me të 36 shkronjat që i ka alfabeti i kësaj gjuhe.

Këtu huqjet janë të mëdha, shpesh të pafalshme.

Anash drejtshkrimit. Politikanët kosovarë rrjetet sociale gjithnjë e më shumë i kanë kthyer në arenë qërimi hesapsh politikë, duke përdorur një fjalor tepër banal, të padenjë edhe për shfryrjet më të ulëta.

Kryeministri i vendit aktualisht e ka të mbyllur llogarinë e tij në Facebook. Në një postim të tij të fundit në këtë faqe, ai lëshoi një akuzë të rëndë ndaj një udhëheqësi të opozitës aktuale, duke e rënduar me një akuzë për të cilën ai madje ishte shpallur i pafajshëm edhe nga gjykata ndërkombëtare për krime lufte.

Ky akt u quajt i ulët, i padenjë e me të gjitha epitetet e mundshme. Shfaqësimi se llogaria është sulmuar nuk ndezi, pasi nuk mundi të vërtetohej. Doli se dikush nga bashkëpunëtorët "ishte ngutur" me atë postim dhe llogaria u mbyll.

Të tjerë deputetë të Kuvendit të Kosovës debatuan në fillim të muajit nëntor në nivel sharjesh të të gjithë anëtarëve të familjes. Madje e ftuan njëri-tjetrin në mejdan. Urojmë të mos ndodhë gjë, pasi dimë se, si në Kosovë ashtu edhe në vendet e rajonit, shumë sherre, madje edhe krime të rënda, janë nisur si sherre të vogla në Facebook.

E ndërsa te kryeministri doli që kishte gabuar dikush nga bashkëpunëtorët e tij, del qartë se për llogaritë zyrtare të udhëheqësve shtetërorë nuk kujdesen ata vetë, por njerëzit e tyre të afërt.

Ngrihet çështja: Sa janë ata profesionistë? Për të mirëmbajtur një ueb-faqe zyrtare të një institucione, që pasqyron aktivitetet e politikanëve, janë të angazhuar disa gazetarë, fotoreporterë e kameramanë, si dhe ekspertë të teknologjisë informative. Te llogaritë në rrjete sociale kjo nuk ndodhë. Për to kujdesen një ose dy veta, ndaj dhe ndodhin probleme të tilla.

Një segment i veçantë janë edhe komentet e qytetarëve në njoftimet e postuara në ueb-faqe.

Pasi Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në Strasburg, më 15 qershor 2015, vendosi të sanksionojë komentet fyese në portalet online, lajmet në Facebook janë kthyer në

një vend për shfryrje të shumicës së përdoruesve të tyre.

Jemi dëshmitarë të faktit se komente të tilla, të denja për shenjë 18+ rinë fare pak të postuara në llogarinë në Facebook të politikanëve, është e qartë se personat që i mirëmbajnë ato përkujdesen që t'i fshijnë ato sa më shpejt që të jetë e mundur. I bie që llogaria në rrjetet sociale e një politikani kërkon përkujdesje 24-orëshe. Pikërisht për këtë, ne aty kryesisht lexojmë vetëm komente pozitive. Negativet, ndërkaq, i gjejmë me bollëk dhe të pacensuruara në llogaritë false.

Facebook-u dhe mediat

Nëse nga komunikimi në rrjetet sociale kanë përfituar politikanët, duke iu drejtuar drejtpërdrejt qytetarëve, dhe qytetarët – duke e marrë në origjinal dhe shpejt porosinë e politikanit, janë mediat ato që në këtë mes mund të quhen humbëse. Së paku përkohësisht, derisa të gjejmë mënyrën e pozicionimit të ri në këtë situatë kur lexuesi, që kishte burim parësor median, po informohet drejtpërdrejt nga politikanin.

Media në Kosovë, pa e studiuar mirë situatën, ka zgjedhur që të përdorë si burim lajmi të gjitha postimet në Facebook të politikanëve dhe zyrtarëve. Të shumtën duke i përdorur si burim kryesor.

Por, kjo ka shkaktuar një problem serioz për median, e cila tashmë është një hap larg zyrtarëve, pa pasur mundësi të mësojë më shumë, pa pasur mundësi të takojë fizikisht zyrtarët. Distanca fizike dhe përdorimi i postimeve në rrjete sociale e dëmton në masë të madhe median serioze, e cila edhe ashtu po e humb betejën me portalet online, te të cilat plotënia e lajmit dhe hulumtimi nuk janë terme shumë të pranishme.

Përmbyllje

Në trajtesën e deritashme ne përdorëm termin komunikim, për ta pasqyruar raportin e zyrtarëve me qytetarët. Por, në fakt, kësaj më shumë i shkon shprehja e "njoftimit të njëanshëm" sesa ajo e komunikimit. Është shumë e qartë se zyrtarët shtetërorë nuk i përdorin rrjetet sociale për të bashkëbiseduar me qytetarët – përdorin ato vetëm për t'i njoftuar për çka janë duke bërë dhe çfarë aktivitetesh kanë zhvilluar.

Realisht, zyrtarët marrin rolin e medias, duke i përdorur rrjetet sociale si media dhe duke i anashkaluar mediat.

E ardhmja në komunikimin zyrtar-qytetar, është e qartë, i takon rrjeteve sociale. Të parët - zyrtarët - duhet ta ngritin raportin me qytetarin nga niveli i tanishëm i njoftimit në nivel të komunikimit. Të dytët - qytetarët – duhet ta kuptojnë se rrjetet sociale i afrojnë më shumë me zyrtarët dhe kjo është një mundësi e krijuar nga zhvillimi i teknologjisë, në të mirë të të gjithëve.

Të dyja palët duhet të heqin dorë nga veset dhe fjalët e këqija dhe ta kuptojnë se rrjetet sociale janë vetëm një mjet komunikimi që nuk i duron as sharjet e as nuk duhet të përdoret për goditje të ulëta ndaj kundërshtarëve politikë.

TË SHKRUAJMË ÇFARË SHOHIM, APO TË SHOHIM ÇFARË SHKRUAJMË?

DR. FERID SELIMI

I
Çdo shkrim, (si në mediet e shkruara, ashtu edhe në ato elektronike) së pari duhet të jetë i interesit të përgjithshëm, e më pas, përjasje individuale.

Në medie, mbase del e kundërta, së pari si përjasje individuale, e më pas i interesit të përgjithshëm, sepse, zakonisht, artikullshkruesit shkruajnë, e mediet botojnë ose transmetojnë atë, çfarë shohin, për çfarë flitet, dhe, atë që ndjejnë, (gazetarët dhe mediet).

E nganjëherë, do të thotë jo rralë, shikimi, përflijtet dhe ndjenjat mund të jenë të rrejshme.

Artikullshkruesit, gjatë të shkruarit, shpesh, nuk e mendojnë, ose nuk e çajnë kokën, çfarë i shtyn të shkruajnë:

-Realiteti i krijuar: të cilin duan ta përmbajnë ose ta ndryshojnë?

-Situata: për momentin të shpëtojnë ose të heqin qafe redaktorët e pronarët e medievet?

-Përflijtet: t'i ndalin ose t'i shtojnë fjalët e njerëzve? (që konsiderohen lexues, shikues, a dëgjues të atyre medievet).

-Ndjenjat: të lirohen nga stresi ose nga përgjegjësia e gazetarit? apo,

-Përmbushja e normës: Të marrin atë, që u takon në fund të muajit?

Kur këto të qartësohen, e duhet qartësuar në shkrim, atëherë, mund të thuhet, që, artikulli është shkruar:

-pa ndonjë ngarkesë emocionale dhe materiale;

-për një realitet, a një situatë;

-për të zbardhur një të vërtetë; dhe,

-për të informuar publikun, drejt e mbarë;

E, që, artikullin, a shkrimin e çojnë drejt pikës së fundit:

-të ndal përflijtet e mundshme.

II

Dhe, ja pyetjet që vijnë për artikullshkruesit dhe mediet:

Çfarë të vërtete ose të pavërtete duan të nxjerrin?

e
Çfarë të vërtete ose të pavërtete nxjerrin?

Çfarë duan të shfaqin e çfarë duan të fshehin?

e
Çfarë shfaqin e çfarë fshehin?

Çfarë duan të publikojnë e çfarë nuk duan të publikojnë?

e
Çfarë publikojnë e çfarë nuk publikojnë?

Ose,

A i kanë të gjitha të dhënat për ata artikuj që i publikojnë?

A e fshehin ndonjë të dhënë?

A e shpikin vetë ndonjë të dhënë?

A nxjerrin diçka nga konteksti i të dhënave?

A ka prej atyre të dhënave, që u duken jo aq të rëndësishme për shkrimin që bëjnë? dhe,

A u pëlqejnë të dhënat e grumbulluara?

Që të gjithë këto elemente, që do të rrumbullakonin shkrimin, e që nuk gjejnë hapësirë të duhur në shkrim, me vetëdije ose pa të, bëjnë që shkrimi të mos rrumbullakohet, por të mbetet i mangët.

Prandaj, çdo shkrim i tillë, del, që, së pari të jetë përjasje individuale, e më pas i interesit të përgjithshëm, ose edhe aspak i interesit të përgjithshëm.

Gazetarët skllëvër apo...

A janë gazetarët, skllëvër të ngjarjeve, të shkrimeve, e publi-

kimeve të tjera, apo janë skllëvër të medievet, e të padronëve të tyre?

Nëse gazetarët nuk janë skllëvër të shkrimeve, e as të medievet e padronëve të tyre, atëherë vijon pyetja e radhës:

A janë shkrimet e publikimet e tjera, skllëvër të gazetarëve?

Ose, nëse janë njëherësh, skllëvër të shkrimeve e publikimeve të tjera, edhe skllëvër të medievet e padronëve të tyre, çfarë në të vërtetë pasqyrojnë shkrimet dhe publikimet e tyre?

Janë këto çështje, që duhet shqyrtuar.

Kujdes: Nuk është njëjtë çfarë pasqyrohet, e çfarë duhet pasqyruar.

Sikur që: Nuk është njëjtë të mendohet, të vepohet, e të shkruhet ndryshe, me atë, që do të duhej të mendohet, vepohet, e të shkruhet ndryshe. Në mes të "është" dhe "duhet" ka një distancë kohore.

"Është" paraqet realitetin e krijuar.

"Duhet" paraqet realitetin e pretenduar.

Me të parën (është) pasqyrojmë.

Me të dytën (duhet) pretendojmë të pasqyrojmë.

Çfarë paraqesin foljet "është" dhe "duhet"

E para, që do të thotë: "është" paraqet atë, që shohim, atë, që dëgjojmë, atë, që prekim.

E dyta, që do të thotë: "duhet" paraqet atë, që do të mund të shihnim, të dëgjonim, a të prek-nim. Edhe më thjeshtë "është" e shohim, e ndjemë, e prekim, e shijojmë. Do të thotë e kemi.

Ndërsa "duhet" paraqet atë, që do të mund ta shihnim, do të mund ta preknim, do të mund ta shijonim, e që nënkupton, se nuk e kemi, prandaj e dëshirojmë, që

do të thotë presim, që në një të ardhme, mundësisht ta kishim.

Dhe, ja dilema tjetër:

Artikullshkruesit:

"Duan" të shohin, dhe të paraqesin atë, që është?

"S'duan" të shohin, e as të paraqesin atë, që është?

"Duan" të shohin e të paraqesin atë, që duan vetë, ata, redaktorët, ose pronarët e medievet? apo

"Duan" të shohin, dhe të paraqesin atë, që, lexuesit, dëgjuesit, a shikuesit duan!

Absurd...

Një shkrim, që e ka aktualitetin, i ka të gjitha elementet, që do ta bënin të lexueshëm, të kuptueshëm e të botueshëm, por, që nuk do t'i pëlqente redaktorit, ose pronarit të medievet, shkrim që do t'i prishte punë atyre të dyve, nuk ia vlen barra qiranë të merrej mund e të shkruhet!..

Përpjekje për zgjidhjen e dilemës:

(Të shkruajmë çfarë shohim, apo të shohim çfarë shkruajmë?)

I

Po të ishin gjallë disa nga pleqnarët e vjetër të Kosovës, do të radhitnin të gjithë fëmijët e të rinjtë në një skaj të odës, dhe, pasi të përsërisnin të katër këto pikat:

(- "Duan" të shohin, dhe të paraqesin atë, që është?

- "S'duan" të shohin, e as të paraqesin atë, që është?

- "Duan" të shohin e të paraqesin atë, që duan vetë, ata, redaktorët, ose pronarët e medievet? apo

- "Duan" të shohin, dhe të paraqesin atë, që, lexuesit, dëgjuesit, a shikuesit duan!)

Do të thoshin: "Merreni të parën, e tre të tjerat, flakni tutje".

Por, pleqnarët e vjetër, si Ramadan Shabani, Xhemajl Obria, Sali Hoxha, Sylejman Qarri, e të tjerë, kanë vdekur moti.

Prandaj, ju mbetet juve, që shkruani. Juve, që mëtoni të bëheni gazetarë e të përcillni ngjarjet e t'i paraqisni ato para publikut, të vendosni, se cilën do ta merrni, e cilën do ta flakni tutje.

II

Dhe kthehemi sërish në fillim të kësaj përjasjeje analitike.

E thashë, që në krye të përjasjes, që, "çdo shkrim, (si në mediet e shkruara, ashtu edhe në ato elektronike) së pari duhet të jetë i interesit të përgjithshëm, e më pas, përjasje individuale".

Vini re!

Në shënimin e parë e kam përdorur foljen "duhet".

Ajo, që unë mendoj, e që në shumë shkrime, artikullshkruesit, botuesit e pronarët e medievet nuk i përmbahen.

Më pas, shënova, që, "në medie del e kundërta, së pari është përjasje individuale, e më pas i interesit të përgjithshëm".

Në shënimin e dytë, siç po e vëreni edhe ju, kam përdor foljen ndihmëse "është".

Dhe, kam theksuar: "sepse, zakonisht, artikullshkruesit shkruajnë, e mediet botojnë ose transmetojnë atë, çfarë shohin, për çfarë flitet, dhe, atë që ndjejnë, (gazetarët, botuesit, dhe pronarët e medievet)". E pra, absurdi... që, "Një shkrim, që e ka aktualitetin, i ka të gjitha elementet, që do ta bënin të lexueshëm, të kuptueshëm e të botueshëm, por, që nuk do t'i pëlqente redaktorit, ose pronarit të medievet, shkrim që do t'i prishte punë atyre të dyve, nuk ia vlen barra qiranë të merrej mund e të shkruhet!?" hyn në kuadër të shënimit të dytë.

Kaq!

STUDENTËT E MEDIAS NË UBT VIZITUAN RTV 21 DHE GAZETËN "ZËRI"

Studentët e medias në UBT, në kuadër të aktiviteteve të tyre studimore dhe përvojave e njohurive që fitojnë brenda UBT-së, kanë realizuar dy vizita në dy medime qendrore, RTV 21 dhe gazetën "Zëri". Studentët janë ndarë të kënaqur nga përvoja që kanë fituar rreth punës që bëjnë këto dy medime.

Studentët e medias në UBT, të shoqëruar nga profesori Musa Sabedini kanë realizuar vizita profesionale për të parë pjesën praktike në RTV 21 dhe në gazetën "Zëri". Rreth 60 student të vitit të parë në ambientet e RTV21 janë pritur nga Esad Dujaka, redaktor në këtë medium, i cili u ka shpjeguar

studentëve tërë procedurën rreth mbledhjes së lajmeve, përgatitjes së tyre deri tek ana finale.

Dujaka u tha studentëve se gazetaria është një profesion shumë i dashur, por që kërkon përkushtim, guxim dhe profesionalizëm. "Tërë jetën e kam kaluar në gazetari dhe kënaqësi është të kryesh punën me nder e ndërgjegje", tha Dujaka.

Edhe Agim Binaku, njëri nga përgjegjësit e RTV 21, tha para studentëve se ky medium me shumë profesionalizëm arrin të informojë dhe të jetë pjesë mediale shumë e rëndësishme e zhvillimeve në vend.

Kurse në ambientet e gazetës "Zëri" studentët janë pritur nga

Lavdim Hamidi, Milaim Shefkiu e Enis Velii. Lavdim Hamidi, zëvendëskryeredaktor, ka folur para studentëve për konceptin e gazetës, derisa ka shtuar se gazetaria hulumtuese dhe temat kundër krimin e korrupsionit janë prioriteti i kësaj gazete. Studentët janë njohur edhe me ecurinë e punës së gazetës që nga fillimi e deri në finale. Studentët ndërkaq kanë bërë pyetje të shumta rreth anës profesionale që zhvillojnë këto dy medime.

Studentja Besarta Breznica tha se është ndarë e kënaqur nga vizita në këto dy medime. "Vërtet për mua ishte një befasi e këndshme, sepse pashë drejtpërdrejt tërë procedurën



e realizimit të lajmeve dhe u njoha edhe me punën që bëjnë gazetatat. Tani po bindem se ia ka vlejtur që të jem pjesë e UBT-së". Xheneta Velii, studente, tha se praktika nëpër medime është shumë e dobishme për ta. "Kjo na ndihmon shumë sepse

në radhë të parë e njohim punën praktike dhe mësojmë edhe nga përvoja e gazetarëve profesionist. Të vizitosh RTV 21 dhe gazetën "Zëri" qysh në vitin e parë vërtet kjo për ne është shumë e dobishme", u shpreh ajo. /rajonipress/

NDËRMJET IDENTITETEVE DHE (MOS) KOMUNIKIMIT

GJYLJE REXHA

“Ti je nga Mali i Zi, që tani është shtet i pavarur, por ende ke një pasaportë të një shteti që tani nuk ekziston si i tillë. Në certifikatën tënde të lindjes figuron një shtet krejt tjetër, që po ashtu i takon të kaluarës. Nga kontratat e punës shoh se jeton në një vend, që synon të bëhet shtet”.

Konstatimet e përfaqësuesit diplomatik të një shteti evropian në sportelin e ambasadës së vendit prej të cilit kërkoja vizë, nuk ishin thjeshtë kërkesa të domosdoshme protokollare. Dosjes time të përzier me emra territoresh u mundova t’i ofroja përgjigjen disi shfajësuese: “Kështu është kur jeton në Ballkan! Krijojmë shpesh shtete të reja”.

Synimit tim për shfajësim, diplomati nga përtej xhamit, iu përgjigj me shfajësimin e tij, me gjuhën e zgjedhur diplomatike: “po mundohem të kuptoj dhe mësoj për Ballkanin”.

Përtej përzierjes që shkaktonin dokumentet e mia, një identitet tjetër, ai që ndodhej tek dokumentet për profesionin tim, më lehtësonte marrjen e vizës dhe më bënte të vlerësuar në vendin e diplomatit të interesuar për Ballkanin.

Vite më vonë kokëçarjet dhe përzierjet me dokumente janë reduktuar. Vendet të cilave u përkas janë konsoliduar si entitete shtetërore, megjithëse të brishta

e ndonjëherë të kontestuara. Në rrëfimin personal vazhdojnë të më shoqërojnë ngatërresat për mënyrën se si ma thonë e ma shkruajnë emrin në entitetet tanimë shtetërore.

Shpesh emri më bëhet edhe përshkruesi më i saktë i “kufijve” të dallueshmërisë brenda përkatësisë së tërësishme amtare gjuhësore.

Vet koncepti i përkatësisë në tërësinë e tij është zgjeruar dhe vështirësuar. Shtresat përcaktuese për identitetet janë shtuar dhe mbivendosur.

Amin Maalouf me librat e tij për identitetin më bëhet shumë i afërt me pyetjen e tij thelbësore për përkatësinë. “Ajo që më bën mua të këtillë siç jam është fakti se jam ndërmjet dy shteteve, dy ose tri gjuhëve dhe disa traditave kulturore. Është pikërisht kjo që definon identitetin tim. A do të ekzistojë në mënyrë më autentike, në qoftë se do të prisja një pjesë timen?”

Në botën vazhdimisht në ndryshim dhe lëvizje, përgjigja në pyetjen e Maalouf-it, është prerazi “jo”, por kjo “jo” kërkon pranimin personal të gjendjes në të cilën duhet përballuar vështirësitë e komunikimit me të tjerët.

Njerëzit vazhdimisht identifikohen me: simbole, territore, etni, religjione, shtresa shoqërore, gjini, moshë, grupe profesionale, politike etj. etj. Secili identifikim korrespondon me krijimin e një co-

pëze identitare, që kërkon vendin e saj në strukturën e përgjithshme të identitetit.

Tërësia në këtë rast, nënkupton domosdoshmërinë e pranimin se përmbajtja është e larmishme dhe e krijuar gradualisht. Nuk bëhet fjalë për një identitet të vetëm, por për shumësi identitetesh të cilat na bëjnë ata që jemi. Sa herë hyjmë në komunikim me të tjerët ne shprehim identitetet e veçanta, apo disa identitete njëkohësisht.

Komunikimi bëhet mjete përmes të cilit ne manifestojmë identitetet tona tek të tjerët, por edhe përmes të cilit ne arrijmë të kuptojmë veten dhe identitetin tonë.

Në rrethe të ngushta dhe mjedise me kompaktësi identitare, procesi është më i lehtë. “Unë” identifikohet me “ne” në grupin më të afërt: familjen, vendlindjen, grupin profesional, fenë e trashëguar, kombësinë me të lindur etj.

Problemet fillojnë kur rrethanat ndryshojnë si rrjedhojë e humbjes së kompaktësisë së mjedisit, përballjes së individit dhe grupit me grupe të tjera, apo lëvizjes së individit me disa identitete të mirëpërcaktuara drejt një grupi me identitete të ndryshme nga të tijat.

Në këto raste, individit hyn në procesin e vështirë dykahësh të ruajtjes së identiteteve të mëherëshme dhe krijimit të identiteteve të reja, që formësohen gjatë procesit të ndërveprimit me të tjerët. Iden-

titet nuk janë diçka statike dhe të pandryshueshme. Ato iu nënshtrohen ndikimeve të jashtme dhe situatave të cilat ndikojnë në krijimin e identiteteve të reja tek i njëjti person.

Ashtu si thonë studiuesit e komunikimit ndërkulturor Judith N. Martin dhe Thomas K. Nakayama: “nuk ka një identitet të vendosur, të lehtë për t’u kuptuar, që është “ju”.

“Kemi identitete të shumëfishta, të cilat janë dinamike dhe komplekse dhe që mund të kuptohen vetëm në lidhje me kontekstet dhe kulturat në të cilat jetojmë”, vlerësojnë ata duke theksuar rëndësinë e kontekstit shoqëror dhe kulturor në krijimin e identiteteve të reja.

Në mjedise të përziera kulturore, ballafaqimi ndërmjet identiteteve ndikon që pjesëtarët e grupeve, sidomos kur janë në pakicë, të kërkojnë më shumë shenja dalluese dhe t’i mbrojnë më me ngulm vlerat e tyre të veçanta identifikuese në raport me të tjerët. Dallimet polarizohen duke vënë përball konceptit të fuqizuar “ne” konceptin “ata”, për grupin që përfaqëson identitet të ndryshëm nga ai që e konsiderojmë “ne”.

Ky proces nënkupton domosdoshmërinë e pranimin të ekzistencës së tjetrit, koekzistencën me të dallueshmin nga ne dhe vullnetin për të hapur veten në procesin e vështirë të pranimin të tjetrit. Në këtë proces, vet identiteti ynë pëson ndryshime, në lidhshmëri me

njohjen, kohën dhe komunikimin me tjetrin.

Niveli i këtyre ndryshimeve është faktor përcaktues në arritjen tonë individuale për t’u përgjigjur në pyetjet thelbësore: sa jemi të gatshëm të realizojmë veten duke pranuar të ndryshmin dhe të dallueshmin?

A jemi aq të ngritur sa brenda proceseve të domosdoshme të integritimit në çdo mjedis të ri të ruajmë të veçantat e formësuara si bartës të disa identiteteve? Përgjigjet asnjëherë nuk janë të lehta. Identitetet, aq sa mund të jenë vras-tare – siç i shtjellon Malouf, mund të jenë edhe afruese.

Në “përzierjen” e identiteteve ngatërrohem shpesh në përcaktimin e asaj që quhet “unë”, cili është grupi më i afërt me të cilin ndjehem “ne” dhe kush janë “ata” përball të cilëve jam “unë” dhe “ne”. Përgjigjet shpesh duket se ngatërrohen në sprovat kur përkatësinë në një grup e vë përball përkatësisë së njëkohshme në një grup tjetër të kundërt.

Por, përgjigjet qartësohen dhe sprovat lehtësohen sa herë njëri identitet plotëson tjetrin dhe përkatësia tejkalon përjashkrimin. Të jesh pjesë dhe të kuptosh se ke disa identitete, t’u përkasësh disa shteteve, të jesh në lëvizje nga një grup në tjetrin dhe të kesh aftësi të pranimin të realiteteve multikulturore, mund të jetë pasuri në tërësinë e asaj që identifikojmë si “unë” dhe “ne”.

FLET SHKUMBIN ALIHAJDARAJ, STUDENT I UBT-SË, PËRFITUES I KONKURSIT NGA KOMUNA E PRISHTINËS

QENDRA PËR KARRIERË NË UBT OFRON MUNDËSI SHUMË TË MËDHA

Bisedë me studentin, projekti i të cilit u zgjodh fitues në konkursin e brendshëm të Komunës së Prishtinës për projektimin e një tezge që do të përdoret nga fermerët e Prishtinës. “Tregu” është tezga që Shkumbini së bashku me kolegun e tij Ermal Canaj e projektuan dhe u shpallën fitues

UBT News: Na thoni diçka për kohën e studimeve në UBT?

Alihajdaraj: Si çdo student edhe unë kam pasur momentet e mia të mira të studimeve. Njëra ndër to ishte vizita në tetë shtete të Evropës, që na krijoi mundësinë të shijojmë arkitekturën e bukur të vendeve perëndimore. Gjatë këtyre dy javëve patëm momente shumë të mira, të cilat gjithmonë do të mbeten në memorien tonë. Një vizite tjetër e rëndësishme gjatë kohës së studimeve është edhe vizita te znj. Englantina Gjermani, ministre e Planifikimit dhe e Zhvillimit Urban të Shqipërisë, ku u njohëm me strategjinë e tyre dhe biseduam për mundësinë e bashkëpunimit që ndoshta mund të behën mes UBT-së dhe Ministrisë. Ndërsa, në UBT nostalgjitë janë të shumta që ende kanë mbetur në mendjen



time mësimet, projektet, punimet seminarike, prezantimet e shumëçka tjetër.

UBT News: Në çka ju ka ndihmuar UBT-ja?

Alihajdaraj: UBT-ja si institucion i nivelit të lartë të arsimit më dha mundësinë në zhvillimin e aftësive individuale. Mësova gjëra të reja dhe metoda se si të qasemi në treg. Është ndjenjë e mirë të jesh pjesë e UBT-së, duke pasur parasysh rëndësinë që ka ky institucion në tregun e punës në Kosovë. Jam

falënderues për të gjitha ndihmesat që m’i ka dhënë. Falë UBT-së, unë jam këtu ku jam tani.

UBT News: Si erdhi ideja e projektit me të cilin e keni fituar çmimin?

Alihajdaraj: Kur e kemi marrë detyrën kanë qenë disa kufizime, duke filluar nga dimensionet që do të ketë, pastaj hapësirat shfrytëzuese dhe ekspozuese, pesha dhe qëndrueshmëria.

Bazuar në këto pika fillimisht, Ermali propozoi një dizajn duke

vazhduar më tutje së bashku në projektimin e tij deri te forma e tanishme. Duke llogaritur pjesën e projektimit arritëm të një projekt përfundimtar që më vonë edhe u zgjodh fituesi në mesin e projekteve konkurruese. Puna vazhdoi edhe pas zgjedhjes si tezga që do të ndërtohet ku arritëm të ballafaqohemi me shumë sfida që përmban tregu punues.

Projekti filloi si një sfidë, pastaj u shpallën fitues dhe e gjithë kjo është një vullnet për punën tonë

në vazhdim në kontributin për zhvillimin e gjendjes sociale në vend.

UBT News: Si e pritët çmimin?

Alihajdaraj: Fillimisht ishte e pabesueshme që të jemi fitues. Ne morëm pjesë vetëm që ta shprehnim dijen tonë në këtë fushë. Me vendimin e komisionit u shpallëm fitues. Kemi marrë njëkohësisht edhe lëvdata, ishte ndjenjë e mirë e të qenit i vlerësuar mbi punën që bën, duke pasur parasysh që projekti ka një qëllim në dobi të vendit. Do të mbetet një vullnet për punën tonë në hapat e mëtejshëm.

UBT News: Porosia juaj për studentët aktual të UBT-së?

Alihajdaraj: Porosia ime për studentët e UBT-së është që të shfrytëzojnë sa më shumë mundësitë që ofron ky institucion, sepse hap shumë dyer të suksesit. Ta shfrytëzojnë në maksimum Qendrën për Karrierë, e cila mundëson qasje fleksibile për intership, punë praktike e shumë mënyra të tjera për të demonstruar punën që bëhet me profesorët tanë. Puna është çelësi i suksesit, andaj secili student duhet të përkushtohet gjatë viteve të studimeve sepse është kohë e cila nëse trajtohet mirë hap rrugë për një karrierë të suksesshme.

A.ZENELI

University of Warsaw



Bachelor and Master Degree in International Relations

Apply for Scholarship!

Teaching and Research Areas

- International Politics
- International Political Economy
- Culture and Multiculturalism
- Diplomacy and Foreign Policy
- International Law and Institutions
- Security and Strategic Studies
- European Integration
- International Relations Theory
- Emerging Markets
- International Business



University of Warsaw (UW)

Is known as one of the leading academic and research center in Poland. The high level of scientific research, its connection with the education of students and the diversity and attractiveness of our teaching determines the position of the University in the country and worldwide.

UW Highlights:

- Founded in 1816
- In the top 4% World-Class Universities
- Ranked no.1 in Poland
- Ranked by QS Topuniversities, The times THEWUR,
- Top 500 in Shanghai Group
- One of the most modern library in Central Europe

Institute of International Relations:

- Established in 1976
- Worldwide research cooperation
- Visiting Professors from all over the World
- Active in national and international research
- Bachelor, Master level and PhD degrees in English
- Worldwide student exchange programme

Fees & Financing:

Bachelor: 1300 € / Year

Master: 2000 € / Year

The Scholarship is only for applicants with Kosovan, Albanian, Macedonian, or Montenegrin citizenship & main residence in one of these countries.

Come to UBT and get European degree

TOP EDUCATION FOR TOP STUDENTS



Email: warsaw@ubt-uni.net
Email: ismn@uw.edu.pl
Institute of Warsaw
www.ism.uw.edu.p

Danube University Krems



Master of Business Administration - MBA

Specializations with MBA Program

- Aviation
- Business Performance Management
- Corporate Responsibility & Business Ethics
- E-Mobility Management
- Energy & Carbon Management
- Finance
- International Business
- Marketing & Sales
- Strategic Management & Organizational Change
- Enterprise Project Management

Apply for Scholarship!

Fees & Financing

Tuition fee: Euro 21,900

Please note our **Scholarships** with a subsidized tuition fee: Euro 10,950

The Scholarship is only for applicants with Kosovan, Albanian, Macedonian, or Montenegrin citizenship & main residence in one of these countries.

Danube University



Danube University Krems has specialized in postgraduate academic studies and offers exclusive courses in the fields of health and medicine, communication and globalization, business and law, education and media as well as of arts, culture and building. Being a European model project, Danube University Krems combines high quality in education, research and consulting with excellent customer orientation and service. More than 5,000 students from 80 countries are enrolled in over 150 academic courses.

Department for Management and Business

We believe strongly in a long life learning that prepares and enables you to become a responsible business leader in a fast changing world. We place strong emphasis on learning-by-doing approach, and strive for creating an innovative environment that enables you to have a high caliber education and training. As we are well located in Central Europe, you will enjoy a multicultural and international faculty and student body. The Danube Business School provides an environment where East meets West with strong links to the business community and relationships with partners from both Eastern as well as Western European countries.

Top 10 Reasons to Join a Danube MBA

- An integrative and applied approach to learning
- Long expertise in postgraduate education
- Customized high standard programs
- High calibre and international faculty
- Flexibility for both full-time and part-time students
- Campus located in the picturesque Wachau region
- International student body
- International study trips
- Individualized quality service
- More than 2000 alumni

Top University Education for Top Students!

TOP EDUCATION FOR TOP STUDENTS



Email: dukmba@ubt-uni.net
Email: michaela.moser@donau-uni.ac.at
Tel: +43 (0)2732 893 2126
Web: www.donau-uni.ac.at

Vienna University of Technology



CONTINUING
EDUCATION
CENTER



Msc Engineering Management Your key to the top engineering league



CONTENTS

Business • Engineering Informatics • Production • Master's Thesis

MODALITIES

3 semesters, part-time, 14 weekend tracks, in English,

FEES & FINANCING

Tuition fee: Euro 22,000

Please note our **KAMM Scholarships** with a subsidized tuition fee: Euro 13,000

The KAMM Scholarship is only for applicants with Kosovan, Albanian, Macedonian, or Montenegrin citizenship & main residence in one of these countries.

HIGHLIGHTS

- 17 years experience
- Master of Science Degree of Vienna University of Technology
- Executive program
- International Faculty - Universities and Industry
- International Participants - Worldwide
- Top international faculty from Europe and USA
- Part time - 14 weekend modules (Thursday to Sunday)
- According to the Bologna Convention
- Contents modernized continuously
- Evening lectures of distinguished guest speakers
- Company visits
- Sustainable Learning Environment – with your tablet at the university (included in the price)
- Alumni Club related to IEEE
- Regularly Club meetings for Networking
- From our graduates approximately 2/3 are in (high) management positions, 1/3 founded a company



Top University Education for Top Students!

Our mission is "technology for people". Through our research we "develop scientific excellence", through our teaching we "enhance comprehensive competence".

Vienna University of Technology
Continuing Education Center
Operngasse 11 • A-1040 Vienna
T +43(0)1/58801-41701 • engineering@tuwien.ac.at
Email: engineering@ubt-uni.net
http://engineering.tuwien.ac.at



ANGLISHTJA NË MEDIAT E SHKRUARA TË KOSOVËS

GANIMET KLAIQI

Zhvillimi i hovshëm i teknologjisë informative, i përhapur tashmë edhe tek ne, në secilën shtëpi, ka efektuar në fushën e komunikimit. Në botë s'ndodh asgjë pa u përhapur lajmi shpejt. Ajo është shndërruar në një fshat të vogël. Krahas kësaj 'ka ngritur krye' edhe huazimi i fjalëve të huaja, si në shqipe, e cila edhe ashtu është e stërmbushur me greqizma, latinizma, turqizma, sllavizma, ndërkombëtarizma etj. Sot, po mbushet me anglezizma. Anglishten e flet bota dhe shqipja s'është përjashtim, por shtrohet pyetja se a ka nevojë që të bëhemi përtacë, që të presim të pasurohemi vetëm me fjalë të huaja. Qasja, për më tepër është problem gjuhëtarësh, por roli i medias në komunikim çon edhe tek gazetarët. Duhet të përfshihen këtu fjalët e reja (neologjizmat), të cilat futen në gjuhë si pasojë e zhvillimit të teknologjisë informative dhe fushave të tjera.

Anglezizmat, në kohën e re tërheqin paralele me ndërkombëtarizmat e shekullit të 20-të. Pos folësve të anglishtes, që ndikojnë në futjen e fjalëve angleze në shqip, rol të madh kanë edhe mediat informative, saktësisht gazetarët. Ata, si përçues të denjë të leksikut tek publiku, mund ta ruajnë gjuhën e tyre. Do të luanin rol edhe studiuesit e teknologjisë e të biznesit, të arkitekturës, të ndërtimtarisë, të shkencave politike. Por, sikur është bërë modë që këta të fundit të jenë më të pamëshirshmit. Ka kohë që Kosova nuk bën asgjë që administrata të mos mbushet me fjalë të huaja, paçka që mundësitë janë të mira.

ANGLEZIZMAT NË MEDIA

Njohësit e gjuhëve theksojnë njohuritë lidhen me pasurinë e gjuhës nga potenciali i vet dhe nga huazimet. Gjuha e pastër e një kombi e bën më të fortë atë.

Lobim, play off, draft-im, lider, handicap-handikap janë midis qindra fjalëve që vitet e fundit kanë hyrë nga anglishtja në shqipe, kryesisht nëpërmjet medias. Merren për ekonomizim, emocion, apo superioritet të folësit: nga aspekti politik e administrativ; kulturor, shkencor, social, ekonomik etj. Mediat, përdoren si mjet, kurse fjalët hyjnë nëpërmjet bilingëve, atyre që kanë përfutur njohuri administrative në universitete të ndryshme të botës. Gjëja për t'u kritikuar në këtë mes është se po dëmtohen edhe fjalët shqipe me barasvlerë me ato që merren,

si: Draft (ang. 1. repart ushtarak, 2. plan, projekt, skicë, projektligj); Agenda - (rend dite, rendi i mbledhjes) në shqip agjendë; Asset - vlerë, cilësi e shquar; Compliment - uroj, përgëzoj; Background - sfondi, plani II, shembull ai njeri e ka backgroundin e mirë, kuptohet se e ka sfondin, historikun, tërë

“Fjala e huaj në gjuhë është si dhia ndër dhen” – N.Frashëri

“Gjuha është pasqyra më e qartë e një kombi dhe e kulturës së tij” – E. Çabej

Janë futur edhe fjalë, të barasvlerëshme me fjalët që gjuha shqipe i kishte historikisht dhe të cilat janë me burim të pastër shqip, si:

abstrakt – zvs. Përmbledhje, rezymë –fjalë që sot përdoret edhe në qarqet më të larta akademike. Nuk ka konferencë shkencore, apo punim shkencor që të mos e ketë këtë fjalë. Madje, konferencat zakonisht paraprihen me një 'Libër abstrakesh'.

akses - akses; zvs. hyrshmëri, (kam akses) - Është bërë përditshmëri. Bëhet për superioritet të një bashkëbisesdusi ndaj tjetrit.

audit (auditoj – auditim – audities) – zvs. kontroll (kontrolloj, kontrollues) – Fjalë që një të riu që i përcjell mediat, më shpesh do t'i ngjasojë se është e shqipes.

bekgraund - veprimtaria; përvoja – Përdoret rëndom nga gazetarët dhe redaksitë, kur duan ta plotësojnë shkrimin me informacione rreth çështjeve të caktuara

bodigard – trupprojë – Përdorimi i kësaj fjalë është disi e kombinuar, varësisht gazetarit

çat (çatoj – çatim) (spec.) – çat (çatoj – çatim); zvs. ndërëbisëdë (ndërëbisëdoj – ndërëbisëdim) – Ende përdoret me theks të anglishtes, pavarësisht që Këshilli ndërakademik për gjuhën shqipe ka gjetur shprehje, ani pse nuk e ka konkretizuar sa duhet.

draft (draftoj - draftim) (spec.) - projekt (projektoj - projektim); projekt-ide, paraprojekt – Fjalë që në administratën kosovare është shndërruar në normë, ndërsa është lënë anash fjala e përshtatshme shqipe, që edhe ashtu është huazim.

emejl (spec.) - emejl; zvs. postë elektronike - Ka një përzierje në

përdorimin e kësaj fjale. Varet nga vëmendja e përdoruesit.

fizibël (fizibilitet) (spec.) – zvs. i bëshëm, i sendërtueshëm, i realizueshëm (bëshmëri, sendërti / sendërtueshmëri, realizueshmëri) – Nuk është se përdorimi shqip i fjalës krijon ndonjë mungesë ekonomizimi gjuhësor. Problemi qëndron tek përtacia.

holl – holl; zvs. Parasallë (korridor) – Një fjalë që përdoret nga mediat pa asnjë arsye. Që të dy shprehjet në shqip janë përdorur për një kohë të gjatë

impakt – ndikim; Fjala e huaj po e zëvendëson këtë të shqipes pa asnjë nevojë. Emri ndikim në rastin konkret, është i ndërtuar mirë edhe me fjalëformimin ligjor të shqipes, teksa fjale “impakt”, e anglishtes ende nuk ka hyrë në kategorinë e fjalëformimit, sikur që ndodh me disa fjalë të tjera të kësaj natyre. Kjo fjalë fjalëformohet vetëm nga mosnjohësit e gjuhës, të cilët po ashtu shpesh i dëgjojmë dhe i shohim në radio apo televizion.

input (spec.) – input; zvs. futjet - Si fjala “impakt”, edhe kjo nuk ka krijuar ende fjalëformim. Kjo nënkupton që është në proces të huazimit, pavarësisht që leksiku i shqipes nuk duket se ka nevojë për të.

Me natyrë të njëjtë janë edhe fjalët: lider - udhëheqës; logo - parullë; market treg; online - në linjë; pasëord – fjalëkalim; profit – fitim; resurs - burim; staf – Personel; stres - tronditje; superstar - superyll; shopping –tregti; shou - shfaqje; spektakël; trendi - modë; uikend – fundjavë; trajning – stërvitje etj. Fjalë pa zëvendësime në shqipe

Duke qenë që, jo vetëm shqiptarët në Ballkan, por edhe popujt e tjerë nuk janë treguar të zotë për të themeluar gjëra të reja në fusha të ndryshme, si ta zëmë në teknologji informative, shumë nga fjalët kanë mbetur nga burimi, saktësisht nga prodhuesit e elementeve të reja brenda jetës shoqërore.

Fajlet: bajt, bar, biftek, biznes, bojkot, bos, bumerang, bunker, bus, buxhet, celular, dixhej, Giga-bajt, kompaktdisk, mikroprocesor, modem, panel, skaner etj, janë të tilla që e kanë pasuruar shqipen. Kështu, pra, fjala Lobim – (Lobby) grup ndikues, s'mund të zëvendësohet lehtë. Si do të ishte fjalia “Lobimi për pavarësinë e Kosovës është duke ngecur”?

Sikur të thuhej “Ndikimi i qeveritarëve të Kosovës për njohjen e shtetit të Kosovës nga shtetet tjera nuk është i mjaftueshëm” nuk na e jep ngjyrimin e nevojshëm emocional.

Në 5 gazeta ditore: “Koha Ditore”, “Zëri”, “Kosova Sot”, Epoka e re” dhe “Bota sot”, brenda një dite, kam gjetur 140 anglezizma. Nëse mesatarja e secilës fjalë del të jetë përdorur 7 herë, atëherë janë përdorur 980 fjalë të huaja.

PËR HUAZIMET

Hugo Shushar thekson se “s'ka gjuhë krejtësisht të pastër”, ndërkaq Leonard Blumfildi dallon dy lloj huazimesh: huazimi intim dhe huazimi kulturor”. Huazimi intim ndodh kur folësit jetojnë në një bashkësi politike topografike, ndërsa huazimi kulturor shfaqet kur folësit jetojnë në bashkësi të ndryshme politike dhe topografike. Prurësit e elementeve të gjuhës - ata që huazojnë janë bilingët, intelektualët, turistët etj. dhe se huazimi lidhet me rrethana politike, ekonomike, shoqërore. “Është gjuha prestigjioze ajo që jep”, ka theksuar gjuhëtari kroat, Rudolf Filipoviq. Studiuesi kosovar, Vesel Nuhui thekson se “disa folës huazojnë fjalë të huaja për të treguar se janë të ngritur nga aspekti intelektual, se njohin një gjuhë të huaj. Kjo ndodh veçanërisht kur ajo gjuhë e huaj ka prestigj të lartë në atë vend ose në botë”.

Elementi i gjuhës dhënëse në gjuhën marrëse është përkufizuar model, derisa elementi i huazuar dhe i përdorur nga gjuha marrëse quhet replikë. Rruga nga gjuha dhënëse në gjuhën marrëse (nga modeli në replikë) kalon nëpër tri stadi: transferi – gjuha marrëse e përdor fjalën e huaj të paasimiluar; interferenca - fjala e marrë flitet me theksin e gjuhës marrëse; ntegrimi (huazimi) –fjala e huaj është integruar në gjuhën e marrësit dhe nuk ndihet më si fjalë e huaj.

Eduard Sapir, thekson se gjuhët, kulturat ndërëndikohen nga miqësia, armiqësia dhe se “s'ka gjuhë a dialekt të izoluar, edhe fiset ndërëndikohen”. Arsyet e huazimit shpjegohen me faktin se hyjnë koncepte të reja, si internet, klikoj, email; për prestigj kulturor, për ikje nga kakofonia, për stilistikë komike etj. Fjala klik-oj. Klik është huazim nga anglishtja click (kërcas - fjalë me prejardhje nga onomatopeja), ndërsa oj është prapashtesë e shqipes, sipas modelit të foljeve këndoj, punoj, etj...). Në kohën e sotme të komunikimit shumë intensiv, me a pa dashje duhet përdorur elemente të huaja gjuhësore. Aq më tepër në kohën kur bota shqiptare në përgjithësi ka krijuar marrëdhënie të mira me popujt e tjerë, zhvillimi i të cilëve në aspektin ekonomik, industrial, shkencor, politik e në fusha të tjera është më përpara.

Gjuhëtari, Einar Haugen, nuk pajtohet me përcaktimin e të huazuarit. “Në shikim të parë

termi ‘të huazuar’ mund të duket se është gati i pavend për procesin që dëshirojmë ta analizojmë si ‘përzierje’. Metafora e implikuar këtu është vërtet absurde, meqë të huazuarit është bërë pa pëlqimin e huadhënësit ose edhe pa vetëdijen e tij, ndërsa huazuesi s'ka kurrfarë obligimi që ta kthejë huan. Njeriu mund ta quajë këtë edhe vjedhje, po të mos ishte që pronari nuk privohet nga asgjë dhe nuk e ndien nevojën për ta marrë atë mall rishtas. Ky proces do të mund të quhej përvetësim, meqë folësi vërtet përvetëson elemente nga një gjuhë tjetër”, ka spikatur Haugen. Eduart Sapir, ndërkaq, kur ka trajtuar ndikimet e një gjuhë në tjetrën ka konstatuar: “Gjuhët, si kulturat, rrallë i mjaftojnë vetvetes. Nevoja për marrëdhënie i sjellë folësit e një gjuhe në kontakt të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me ata të gjuhës fqinje ose me gjuhën e folësve që kanë kulturë mbizotëruese”.

Në Kosovë, me intervenimin e NATO-s, në krye me SHBA-në, për ta nxjerrë nga pushtimi atë, dhe më pas administruar nga UNMIK-u, BE-ja e EULEX-i, ka ndikuar që gjuhës shqipe t'i bashkohen edhe shumë fjalë. Meqë gjuhë zyrtare është anglishtja, shumica e fjalëve i përkasin fushës administrative ose politike.

Teza e ngritur s'është krejt puritane. Ka për qëllim që aty ku është e mundshme, së paku mediat, të mos e deformojmë gjënë më të shtrenjtë, që e nxjerr dallimin tonë thelbësor nga të tjerët. Secili popull, për shkak të gjuhës, traditave e kulturës është një petale më shumë në lulet shumëngjyrëshe. Ndaj, ruajtja e asaj luleje të bukur është obligim yni kombëtar, po aq sa është edhe interes ndërkombëtar. Njerëzit e fshehin injorancën duke provuar që nëpërmjet përdorimit të pak fjalëve të huaja, të tregojnë se janë të dijshëm. Në mediat e shkruara, lektorët a redaktorët gjuhësorë i kushtojnë kujdes të mjaftueshëm përdorimit të gjuhës autoktone, mirëpo kjo nuk ndodh në mediat audivive.

Gjuha e një kombi s'është vetëm pasuri e tij, është thjesht pjesë e thesarit botëror. Ajo duhet ruajtur e kultivuar nga të gjithë: nga ata që marrin edhe ata që japin. Si do të mund të sendërtohej indoevrpianishtja, sikur të mos ruheshin gjuhët origjinale, nga të cilat janë nxjerrë elementet e përbashkëta brenda një trungu. Gjuhët, prandaj i bashkojnë njerëzit. Duket që ndajnë për shkak të moskuptimit, por kthimi prapa çon tek një gjuhë. Se gjuhët janë prodhim i një familjeje.

Top Education for Top Students



- 14 vite Lider i Arsimit të Lartë - I vetmi i certifikuar për ekselencë (EFQM)
- I certifikuar sipas standardit ISO 9001:2008 për cilësi
- Përfitues për herë të katërt nga Kosova i Programit Evropian ERASMUS MUNDUS
- Përfitues i Programit për bursa AEP, Albach
- Përfaqëson Kosovën në Organizata Evropiane dhe Botërore
- Kampion Evropian në Robotikë
- Kampusi i parë për Shkencë dhe Inovacion

Zgjedh më të mirin ...

... që të bëhesh më i miri!

Come to UBT and Go International...

Kolegji UBT - Bartës privat i Arsimit të Lartë i akredituar nga Agjencia e Akreditimit e Kosovës dhe licencuar nga MASHT.

PROGRAMET E AKREDITUARA

- MENAXHMENT, BIZNES DHE EKONOMI (Baçelor dhe Master)

- Financa, Banka dhe Sigurime
- Kontabilitet, Auditim dhe Tatime
- Manaxhment, Ndërmarrësi dhe Inovacion
- Marketing dhe Shitje
- Biznes ndërkombëtar
- Logjistika dhe Menaxhimi i Prokurimit

- SHKENCA KOMPJUTERIKE DHE INXHINIERI (Baçelor dhe Master)

- Rrjeta dhe Telekomunikacion
- Softuer dhe Sisteme Inxhinierie
- Baza e të Dhënave dhe Sistemet e Informacionit
- Dizajn dhe Multimedia
- Mekatronikë dhe Robotikë

- MENAXHMENT I MEKATRONIKËS

(Baçelor dhe Master - I vetmi i akredituar në vend)

(Elektroteknika, Elektronika, Teknologjia e Informacionit Prodhimtaria Industriale, Dizajni Industrial Ndërmarrësi dhe Menaxhment)

- SISTEMET E INFORMACIONIT (Baçelor dhe Master)

- Sistemet e Informacionit për Biznes
- Sistemet e Informacionit - GIS (Geo Information Systems)
- Sistemet e Informacionit të Librarive dhe Menaxhimi i Dijes
- Statistika, Përpunimi i të dhënave dhe simulim
- Siguria e Informacionit dhe Privatësia

- ARKITEKTURË DHE

PLANIFIKIM HAPËSINOR (Baçelor dhe Master)

(I vetmi privat i akredituar në vend)

- INXHINIERI NDËRTIMORE (NDËRTIMTARI)

DHE INFRASTRUKTURË (Baçelor)

(I vetmi privat i akredituar në vend)

REGJISTRIMI

Dokumentet e nevojshme për regjistrim:

- Diploma, dëftesat e notave, certifikata e lindjes, kopja e letërnjoftimit dhe dy fotografi

Gjuha e studimeve: Gjuha Shqipe dhe Gjuha Angleze si dhe mundësia e studimit në gjuhë të tjera

Mënyra e studimit:

UBT organizon ligjëratat të rregullta dhe me korrespondencë, si dhe ofron mundësinë e studimit në distancë.

Për të punësuarit ofrohen ligjëratat pas orarit të punës dhe gjatë fundjavës

Që sukcesi juaj të jetë i garantuar, UBT ofron për secilin studentë:

- Orientim profesional, kurse përgatitore, praktika profesionale, vizita studimore dhe certifikime ndërkombëtare
- Nga një kompjuter gjatë studimeve dhe sistem online
- Liçensa falas për software
- 100% Internship në kompanitë dhe institucionet me prestigjioze vendore dhe ndërkombëtare
- Libraria me numrin më të madh të titujve dhe qasja online në libraritë më të mëdha elektronike
- Praktika dhe Eksperimente në Laboratorët bashkëkohorë.
- Trajtime: CISCO, Microsoft, AutoCad, ECDL, Projekt, etj.
- Certifikime për kontabilist në bashkëpunim me SCAAK

Financat dhe pagesat:

- Çmimi i studimeve për një vit akademik Baçelor është **1200 €**, për nivelin Master është **1500 €** me mundësi pagese deri në **12 kështe**.

Për të gjithë **nxënësit e dalluar** UBT ofron përkrahje financiare

UBT ofron zbritje deri në 30% edhe për këto kategori:

- Të punësuarit në Doganat e Kosovës
- Pjesëtarët e FSK-së dhe Policisë së Kosovës
- Të punësuarit në Institucionet Publike të Kosovës
- Familjarët e dëshmorëve dhe veteranëve të luftës
- Studentët që vijnë nga e njëjta familje dhe si grup
- Studentët që paguajnë në fillim të vitit akademik

Lagjja Kalabria p.n., Prishtinë, Tel:038 541400 Mob:044 541400 Email:info@ubt-uni.net Koha e regjistrimit çdo ditë prej orës 09:00 deri në 17:30

Apliko online: www.ubt-uni.net/apliko ose në qendrat për Informim dhe Regjistrim në Ferizaj, Prizren, Gjiilan